

Kryengritje e pambaruar

Ky libër i kushtohet ish-ambasadorit amerikan Robert Frouik i cili vdiq ne 31 janar 2007. Ndihma dhe vizioni I tij për çështjen shqiptare mund të barazohet me idealizmin e luftëtarëve shqiptarë. Robert Frouik është I vetmi diplomat amerikan që u shpall person I padëshirueshëm në Maqedoni, nga një qeveri që vetëquhej demokratike
Ambasadori amerikan Frouik, si një njohës i shkëlqyer i rajonit të Ballkanit dhe humanist i madh, ishte arkitekti kryesor i stabilizimit te situates politike në Shqipëri në fund të vitit 1998.

Ai u tregua një mik i madh i shqiptarëve në Maqedoni në kryengritjen e vitit 2001. Kur mjaft politikanë dhe diplomatë perëndimorë nuk e kishin të qartë se çfarë ndodhte në Maqedoni, Frouik u rreshtua përkrah të drejtave të shqiptarëve të cilët ishin rebeluar ndaj institucioneve qeveritare. Ai hartoi në fillim të muajit maj 2001 atë që u quajt «Plani Frouik». Ky plan më vonë u shndrrua në bërthamën e Marrëveshjes së Ohrit në 13 gusht 2001.

Vdekja e Robert Frouik është një ngjarje e dhimbshme për shqiptarët. Ata humbën një mik, një vizionar dhe një mbështetës të çështjes së tyre, i cili asnjëherë nuk kërkoi shpërblim për mbështetjen që ju dha shqiptarëve.

Koço Danaj

Parahyrje

Kryengritje e pambaruar

Kryengritja e shqiptarëve e vitit 2001 në Maqedoni, është një Kryengritje e Pambaruar. Konkluzioni i sapoparashtruar nuk merr për bazë deklaratat politike të disa ish-drejtuesve të saj, nuk merr për bazë përpjekjet e disa të tjerëve për ta shbërë atë. Konkluzioni i sipërthënë nuk merr për bazë as numurin e deputetëve shqiptarë në Parlamentin maqedonas.(Numuri i deputetëve nuk është tregues i lirisë së një populli. Në të kaluarën, Parlamenti turk dhe ai grek kishin me dhjetra deputetë shqiptarë. Por sot në Turqi dhe Greqi kemi vetëm turq apo grekë me origjinë shqiptare!)

Konkluzioni se kryengritja e vitit 2001 është e pambaruar, bazohet në disa nga fondamentet që kanë të bëjnë me liritë dhe të drejtat e njeriut. Shqiptarët në Maqedoni, edhe sot pas 7 vjetësh nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Ohrit, nuk kanë të drejtë ligjrisht të përdorin Flamurin Kombëtar. Gjykata Kushtetuese e Maqedonisë e anuloi ligjin për përdorimin e tij. Sot shqiptarët në Maqedoni nuk e kanë akoma gjuhën shqipe si gjuhë zyrtare. Sot shqiptarët në Maqedoni nuk kanë asnjë ngjarje madhore të historisë së tyre si festë shtetërore. Ndërsa maqedonasit kanë gjashtë të tilla. 7 vjet pas kryengritjes, pushteti maqedonas vazhdon ti trajtojë shqiptarët si mysafirë, si të ardhur si jo autoktonë në trojet e tyre. Ka më shumë se një dekadë që pushteti maqedonas bisedon me Greqinë për emrin. Por ka më shumë se një dekadë që shqiptarët, askush nuk i ka pyetur, askush nuk i ka konsultuar se si do të jetë emri i shtetit ku ata jetojnë padrejtësisht por edhe përkohësisht.

Shumica e politikanëve shqiptarë të sotëm dhe komandantëve të UCK së djeshme në Kosovë dhe në Maqedoni, kanë qënë antarë apo drejtues të organizatës ilegale me emrin Lëvizja për Kosovën (LPK). LPK shtrihej në të gjithë teritoret shqiptare në ish-Jugosllavi, në Kosovë, në Maqedoni, në Luginë të Preshevës etj. Programi i saj afatmesëm ishte çlirimi i shqiptarëve dhe grumbullimi i tyre në një Republikë të vetme. Ndërsa programi afatgjatë i saj ishte bashkimi me Shqipërinë. LPK, për shkak të dhunës që ushtrohej ndaj saj, vepronte jo vetëm në Kosovë, Maqedoni, por edhe në Perëndim, në atë organizim që emërtohej Dega jashtë vëndit. Shumë prej atyre të cilët sot ose janë deputetë, ose ministra ose kryetarë partish në Kosovë e Maqedoni, një pjesë të jetës së tyre e kanë kaluar në Zvicër dhe në Gjermani në gjirin e LPK. LPK dhe programi i saj ishte në themel të platformës politike dhe ushtarake të UCK. UCK-ja qysh me krijimin e saj dhe deri në fund të luftës, kishte në programin e saj, bashkimin e trojeve shqiptare. Po i sjellim lexuesit dy fakte:

Fjala e UCK-së në varrimin e mësuesit Halit Geci në Llaushë

(Nëntor 1997)

Vëllezër dhe motra

Nëna dhe baballarë, të afërm të vëllait tonë Halit Gecaj

Në emër të Ushtrisë për Çlirimin e Kosovës, u shprehim ngushëllime të sinqerta dhe ju njoftojmë se e ndajmë dhimbjen me ju. Populli shqiptar në trojet e veta, këtu në Kosovën e robëruar, në vite dhe dekada ka provuar mbi supet e veta shtypjen dhe dhunën më cnjerëzore nga pushtuesit serbë. Na u vranë na u burgosën e na u masakruan bijtë dhe bijat më të mira të popullit tonë të pambrojtur.....Po një ditë nga gjiri i këtij populli lindi Ushtria Çlirimtare e Kosovës si e vetmja forcë serioze për realizimin e idealeve dhe aspiratave të popullit tonë për bashkimin tonë kombëtar.....Lufta jonë e shenjtë do të zhvillohet deri në çlirim, deri në bashkimin tonë kombëtar.

Lavdi të rënëve për liri. (Ky fjalim është botuar në Zërin e Kosovës në datën 11 dhjetor 1997). Ata që kanë folur para më shumë se një dekade janë sot figura të njohura të skenës politike shqiptare, Daut Haradinaj dhe Rexhep Selimi).

Gjatë kohës së luftës, luftëtarët e UCK i nënshtroheshin betimit luftarak i cili përfshinte edhe bashkimin kombëtar. Ja teksti i betimit të luftëtarit të UCK-së: «Unë, ushtari i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, betohem se do të luftoj për çlirimin e tokave shqiptare dhe bashkimin e tyre. Do të jem përherë ushtar besnik, luftëtar i denjë i lirisë, vigjilent, guximtar dhe i disiplinuar, i gatshëm që në çdo kohë pa kursyer as jetën time të luftoj për t' i mbrojtur interesat e shenjtë të atdheut. Nëse shkel këtë betim, le të ndëshkohem me ligjet më të ashpëra të luftës dhe nëse tradhetoj, qoftë i humbur gjaku im. Betohem, betohem, betohem.»

Ky tekst ka qënë fillimisht i vlefshëm edhe për UCK e krijuar në Maqedoni deri në komunikatën e saj të gjashtë, kur u fshi ideja e bashkimit kombëtar.

Kemi të bëjmë me një mision të pambaruar. Politikanët aktualë shqiptarë në Kosovë apo Maqedoni të cilët kanë dalë nga radhët e LPK dhe të UCK përpiqen ta shmangin këtë pjesë të pambaruar të misionit të tyre. Ata ose përpiqen ta mbulojnë me pluhurin e harresës, ose ta justifikojnë me nocione të kohës duke formuluar idenë false të bashkimit në Bruksel. Me çfarë kemi të bëjmë? Duket se kemi të bëjmë edhe me paaftësi, edhe me pafuqi. Por edhe me mentalitet otoman. Janë tre dukuri përbashkuese që i kanë shoqëruar politikanët shqiptarë përgjatë një shekulli, qysh prej vitit 1912. Ato janë pafuqi, paaftësi dhe otomanizëm. Dhe i kanë shoqëruar në momentet kyçe të historisë së shqiptarëve. Politikanët djeshëm dhe të sotëm shqiptarë duket se e kanë ndërë dhe e ndjejnë pafuqinë, paaftësinë dhe otomanizmin. Prandaj edhe janë përpjekur ta fshehin, duke nxitur artificialisht luftën me njëri tjetrin apo duke manipuluar me nocionet e kohës. Në librin «Tragjikët e Europës» kam argumentuar se shqiptarët janë ndër të pakët kombe që kanë më shumë «tradhëtarë». Sepse i kanë shpikur politikanët e tyre. Dhe e kanë bërë këtë për të fshehur «Kryengritjen e Pambaruar».

Kryengritja e shqiptarëve në vitet 1911-1912 mbeti një Kryengritje e Pambaruar. Pavarsia e Shqipërisë, u njoh dhe realizua si e tillë, vetëm në një pjesë të teritorit shqiptar. Pjesët e tjera të hapsirës shqiptare mbetën apo u aneksuan nga shtete të tjerë.

Lufta e quajtur nacional-çlirimtare përgjatë luftës së dytë botërore, mbeti një Kryengritje e Pambaruar. U realizua vetëm një pjesë e saj, që kishte të bënte me nocionin «çlirimtare», por mbeti pa u realizuar pjesa që kishte të bënte me nocionin «nacionale». Më shumë se gjysma e nacionit (kombit) mbeti jashtë kufijve të Shqipërisë. Kryengritja e shqiptarëve në Kosovë që mori hov në fillimvitin 1998, mbeti një Kryengritje e Pambaruar. Ajo realizoi vetëm shkëputjen e Kosovës nga Serbia, duke mos realizuar akoma pjesën e dytë të saj, që është bashkimi me Trugun kombëtar.

Të njëjtin fat pësoi edhe Kryengritja e shqiptarëve në Maqedoni. E nisur si çlirim kombëtar ajo përfundoi me liri dhe të drejta për shqiptarët duke pranuar një shtet tjetër si atdhe të shqiptarëve dhe duke u rreshtuar në radhët e para të mbrojtjes së këtij shteti.

Kuvëndi Lezhës në 1444, Kuvëndi i Prizrenit në 1878, Kuvëndi i Vlorës në 1912 dhe Kuvëndi i Bujanit në 1943-44 të cilët artikuluan ose bashkimin e trojeve shqiptare ose kërkesën për bashkim si dhe ideatorët e tyre, mbetën katër kulmet e historisë së kombit shqiptar. Ideatorët e tyre, më europeistët ndër politikanët shqiptarë të të gjithë kohrave janë Skënder Bej Kastrioti, Abdyl Bej Frashëri, Sulejman Agë Vokshi, Ismail Bej Vlora,

Hajdar Beg Dushi. Pesë bejlerë Europeistë!! Këto Kuvënde kanë mbetur vetëm pjesë e historisë. Ndërsa pjesa e realitetit, është «Kryengritja e Pambaruar».

Ndërsa dy nocionet me të cilët politikanët shqiptarë kanë fshehur pafuqinë apo paaftësinë e tyre përballë bashkimit të trojeve shqiptare, kanë qënë internacionalizmi dhe integrimi, dy nocione të gjysmës së dytë të shekullit të 20-të dhe fillim shekullit të 21-të.

Ndërsa partizanët e bashkimit të trojeve shqiptare janë spostuar jo si të tillë, por duke u anatemuar si kundërshtarë të internacionalizmit dhe të integritit sot. Ashpërsia e Anatemës ka qënë në varësi të kohës dhe situatave kur është bërë ajo.

Duket se edhe politikanët aktualë të shqiptarëve që kanë dalë nga radhët e dy UCK-ve në Kosovë dhe në Maqedoni do të ecin në rrugën e të tjerëve. Devijimin nga Platforma e bashkimit kombëtar, që tashmë quhet «Projekti Politik Adem Jashari», devijimi nga Programi politik i organizatës nga e cila dolën, LPK, e cila edhe në korrik 2000, bashkimin kombëtar e pranonte si thelbin e saj; ata, këtë devijim, po e paraqesin dhe do ta paraqesin më shumë në të ardhmen si europeizëm, ndërsa partizanët e bashkimit si nostalgjikë, si njerëz që duan luftë, të prapambetur duke u përpjekur të gjejnë nocione me tingëllim negativ apo manipulativ në popull.(A nuk ju kujtohet parrulla: Bacë, u kry) Kryengritja duhet të përfundojë

Por a duhet të përfundojë kryengritja e pambaruar e shqiptarëve? Kjo është e nevojshme, e domosdoshme për stabilitetin e Maqedonisë, për zgjidhjen e problemit shqiptar, për stabilitetin e Ballkanit.

Përfundimi i saj është një detyrim i madh kombëtar përpara elitës politike, civile dhe sociale shqiptare. Bashkimi Europian është një bashkim kombesh, jo thjesht shtetesh. Elita e kombit shqiptar, nuk mund të ndjehet e qetë në mjedisin europeist teksa kombi, të cilit i përket i ka punët të pambaruara. Kësisoj, përfundimi i Kryengritjes, përbën një detyrim të madh kombëtar.

Përfundimi i «Kryengritjes» nga elita politike shqiptare në trekëndëshin Tiranë-Prishtinë-Tetovë ka një taban të fortë mbështetës historik, por është edhe nocion europeist.

Cili është tabani historik mbështetës?

Përgjatë afër një shekulli, shqiptarët festojnë si Ditë të Pavarsisë së tyre, 28 Nëntorin e vitit 1912. Ndërkaq, kufijtë administrativë u përcaktuan më vonë në Konferencën e Londrës, në korrik 1913, e cila me vendimet e saj, e la përgjysëm Kryengritjen e shqiptarëve. Brënda ndërgjegjes apo nëndërgjegjes, si një mjet ngushëllimi apo si një mjet mos harrimi, si një manevër e mënçur politike apo thjesht si një instikt nacional, nuk ka rëndësi se kush është në krye. Ajo që ka rëndësi, është se brezit të sotëm të elitës intelektuale dhe politike shqiptare i ofrohet jo vetëm mospajtimi me ata që nuk lejuan mbarimin e Kryengritjes shqiptare, por edhe bazamenti politik dhe historik për ta përfunduar atë. Pavarsisht se bashkësia ndërkombëtare nuk e njohu 29 nëntorin 1912 dhe kufijtë e Shqipërisë i caktoi në 29 korrik 1913, shqiptarët kanë festuar dhe vazhdojnë të festojnë vetëm 1912. Eshhtë një mospranim në heshtje, por gjithsesi është i tillë.

Konferenca e Bujanit e fundvitit 1943 dhe fillimvitit 1944 artikuloi të drejtën e shqiptarëve për bashkim kombëtar, pra të drejtën e tyre për ta përfunduar Kryengritjen. Kjo Konferencë dhe Platforma e saj Nacionale, nuk u hodh poshtë nga shqiptarët, ajo u hodh poshtë nga ata që nuk donin të përfundonte Kryengritja e tyre. Ky dokument madhor i rrugës se si përfundon Kryengritja, përsëri është në duart e elitës politike dhe intelektuale të kombit shqiptar si një ndihmesë e rëndësishme drejt përfundimit të Kryengritjes.

Projekti Politik Adem Jashari, i cili përmbante nëpërmjet betimit ushtarake, idenë e përfundimit të Kryengritjes shqiptare, është i freskët, i njohur për të gjithë, qytetarë dhe politikanë. Shprehja: Bacë, u kry, më shumë se sa realitet, është një mbulesë e dobët e pafuqisë për të përfunduar Kryengritjen. Thelbi i Projektit Politik Adem Jashari është bashkimi i trojeve shqiptare.

Pavarsisht ngjyrimeve politike apo nivelit intelektual, pavarsisht dukurivë frenuese, elita politike dhe intelektuale shqiptare e ka pasur brerjen më të madhe të ndërgjegjes, mospërfundimin e Kryengritjes shqiptare. Ajo që në fjalorin sociologjik konsiderohet Ndërgjegja e Vrarë, në momente të caktuara të jetës së një kombi, mund të lindë edhe gurë rubini. Kështu ka ndodhur edhe me elitën politike dhe intelektuale shqiptare të

periudhës së pas viteve 90-të të shekullit të shkuar. Në kulmin e garës për internacionalizëm apo globalizëm apo integrim, ajo formulon Kushtetutën e re të Shqipërisë Pluraliste. Dhe në këtë Kushtetutë, të miratuar me Referendum në vitin 1998, formulohet, fraza rilindase si më poshtë: Ne, Populli i Shqipërisë.....me aspiratën shekullore të popullit shqiptar për identitetin dhe bashkimin kombëtar..... Është produkti 100 vjeçar i Ndërgjegjes së Vrarë. Është një rikthim në Kuvënderin e Vlorës, të Lezhës, të Bujanit, të Prizrenit, është një talisman vizionar që pret vetëm misionarë për tu realizuar. Sanksionimi në Kushtetutën e Shqipërisë i të drejtës për bashkim kombëtar, miratimi i kësaj të drejte me Referendum Popullor, pranimi i saj edhe nga ekspertët ndërkombëtarë të Komisionit të Venecias, përbën themelin mbi të cilin mund dhe ka nevojë të ndërtohet arkitektura e përfundimit të Kryengritjes së shqiptarëve.

Dialog me këdo, dialog për gjithshka

Por me çfarë mjetesh duhet të përfundojë Kryengritja? Më duhet të bëj një sqarim të domosdoshëm për lexuesin. Në trajtesë, nocioni Kryengritje, nuk ka të bëjë me përdorimin e dhunës, me përdorimin e armëve. Nuk ka të bëjë me kuptimin klasik të saj. Por me vetë thelbin e fjalës dhe jo me historikun e saj. Një komb i pabërë ka të drejtë të ngrejë krye. Ndërsa një komb që nuk ngrë krye (Krye-ngritje), ai komb duhet të iki, është i vdekur dhe i vdekuri nuk mund të qëndrojë me të gjallët. Për më tepër kur kemi të bëjmë me kombin shqiptar i cili është i pa bërë, jo vetëm për shkak të pafuqisë së elitave të tij, por edhe për shkak të mosmarrëveshjeve të të tjerëve. Sentenca shekullore e vendosur në ballë të Kushtetutës se: Ne Populli i Shqipërisë.....me aspiratën shekullore të popullit shqiptar për identitetin dhe bashkimin kombëtar.....; është kërkesa kryesore e Krye-ngritjes shqiptare.

Arma kryesore e saj është dialogu. Dialog me këdo, dialog për gjithshka, edhe për thelbin e vetë Kryengritjes, pa vendosur fillimisht për asgjë. Sot shqiptarët nuk kanë më nevojë për Kallashnikovë. Ata e kanë Vizionin në Kushtetutë. Prandaj kanë nevojë për mision dhe misionarë. Dhe duhet ti kenë ata. Dhe do ti kenë ata.

Hyrje

Vlerat duhen ruajtur

Kryengritja e shqiptarëve e vitit 2001 në Maqedoni, përbën një nga ngjarjet më të mëdha të kombit shqiptar. Shpërthimi i saj pas Kryengritjes së Kosovës, sikur donte të deklaronte se çështja shqiptare pavarësisht se ka nuancat e saj në rajone dhe vende të ndryshme, në thelbin e saj është një e vetme. Është çështja e një kombi të ndarë padrejhtësisht para një shekulli. Prandaj kjo kryengritje është një pasuri e madhe për shqiptarët dhe nuk është pasuri për këtë apo atë parti politike. Ajo ishte dhe do të mbetet një vlerë e madhe në Universin e vlerave morale të Shqiptarëve që jetojnë në trojet e tyre në Maqedoni. Vlera edhe mund të analizohet, por kurrsesi të anatemohet, apo më shumë të harrohet. Thelbi i europeizmit qëndron në tërësinë dhe larminë e vlerave të secilit komb dhe jo në harresën e tyre.

Kryengritja e shqiptarëve e vitit 2001 ka veçoritë dhe dallimet e saj, të cilat synojnë të përbejnë thelbin e librit.

Libri është historiko-politik. Gjatë vitit 2001, autori për shkak të detyrës shtetërore dhe për shkak të miqësisë me shumicën e drejtuesve të UCK, e ka ndjekur përgjatë një viti fillimin dhe fundin e kryengritjes së Pambaruar të shqiptarëve.

Përse kryengritja në Maqedoni nuk u shndërrua në konflikt ndëretnik?

Është një pyetje që kërkon përgjigje. Përse kryengritja e shqiptarëve në Maqedoni në vitin 2001, nuk u shndërrua në konflikt të pastër ndëretnik? Duhet harruar apo duhet kujtuar kryengritja e shqiptarëve? Apo duhet harruar ajo dhe duhen kujtuar për të mos u përsëritur më, rrënjët që shkaktuan atë? Më duhet të jap disa përgjigje, për t'ju përgjigjur pyetjes kryesore. Ato përbëjnë boshtin e këtij libri.

Më duhet ta ritheksoj qysh në fillim se Kryengritja e vitit 2001 në Maqedoni edhe mund të shndërrohej në konflikt ndëretnik. Por mbeti në kryengritje midis UCK dhe forcave qeveritare. Me përjashtim të ngjarjeve të Manastirit kur ndaj shqiptarëve u ushtrua gjenocid i pastër nga shtesa ekstremistësh maqedonë, nuk ka pasur raste të tjera të dukshme. Ndërsa ka pasur mentalitet ultranacionalist nga qeveria maqedonase. Historia e luftës, e politikës kërkon medoemos edhe një politikë të drejtë dhe të saktë të vetë kësaj

historie. Që do të thotë se historia e kryengritjes e vitit 2001 duhet shkruar dhe trajtuar jo me mëndësite e vitit 2008, as me mëndësitë e simpative apo antipative të vitit 2008, as me referencat apo preferencat e vitit 2008, as me përdorimin pragmatik të këtij viti kryengritës nga forca të ndryshme politike apo drejtuesve të tyre. As me jehonën e fushatave elektorale apo me qënien në pushtet dhe në opozitë. Në sistemet pluraliste, formulimi i historisë së ngjarjeve mbi bazën e qënies në pushtet e deformon atë duke e kthyer në të kundërtën e saj.

Përgjigja e dytë që më shtyu ta shkruaj këtë libër qëndron në vetë rëndësinë e vitit 2001 për shqiptarët dhe të ngjarjeve që e shoqëruan këtë vit në Maqedoni. Kryengritja e vitit 2001 në Maqedoni ndoshta nuk mund të ngjajë me librat klasike të luftave dhe kryengritjeve të ndryshme. Sentenca e njohur se luftat bëhen për teritore nuk ishte parësore gjatë kësaj kryengritjeje. Mendimet e mëvonshme se duhet të ishte bërë kështu apo ashtu, kanë shumë pak vlerë. Historia dhe analiza e saj nuk bëhen me sikur, por me ngjarjet e ndodhura në kohën për të cilën flitet. Kategoria e vrojtuesve politike të cilët në kohën e zhvillimit të ngjarjeve u shmangën nga qëndra e tyre, syojnë sot për të dalë mbi vetë ngjarjet, për të anatemuar dhe denigruar vetë kryengritjen. Marrëveshja e Prizrenit midis Ali Ahmetit, Arbër Xhaferrit dhe Imer Imerit në 22 maj 2001 tronditi politiken euroamerikane. Përgjigja e tretë që më shtyu ta shpejtoj shkrimin dhe botimin e këtij libri është edhe përpjekja që bëhet për ta rrumbullakosur kryengritjen e vitit 2001 dhe për ta shkruar atë me një mëndësi të ndryshme nga mëndësia shkencore, nga mëndësia historike

apo mëndësia njerëzore. Në sistemet pluraliste, historinë nuk e shkruan pushteti apo edhe OJQ pranë pushtetit. 7 vjet pas, ka një përpjekje në Maqedoni për të gjetur të përbashkëtën e konfliktit tek shqiptarët dhe maqedonasit. Por përveç përpjekjes së mire, ngjarjet e vitit 2001 janë shkruar me mëndësinë e partisë dhe politikës dhe jo të shkaqeve reale. Po e jap këtë interpretim sipas botimit tek LOBI:

Varianti maqedonas: «Periudha e viteve 2000-2001, në Republikën e Maqedonisë karakterizohet me ndryshime të ndërlikuara shoqëro-ekonomike dhe politike si rezultat i tranzicionit.

Shumë kapacitete industriale falimentuan dhe u mbyllën, një pjesë e madhe e popullsisë mbeti pa punë dhe varfëria morri hov. Privatizimi ishte i shoqëruar me parregullshmëri të ndryshme, dobësi të legjislacionit dhe keqpërdorime të rënda. Qeveria aktuale në të cilën participonin edhe shqiptarët nuk mundej ta përballonte më këtë situatë në vend. Partitë politike ishin të formuara në baza etnike.

Rrethanat politike situatën në vend e bënë të pasigurte, më së shumti për shkak se për Maqedoninë ishin vitet e para si shtet i pavarur.»

Varianti shqiptar: «Shkatërrimi i RSFJ-së dhe mëvetësimi i Republikës së Maqedonisë shkaktuan ndryshime të thella politike, shoqërore dhe ekonomike në vend.

Pluralizmi manifestohej me formimin e partive politike të cilat, në vend të atij ideologjik, kishin karakter të fuqishëm etnik. Si rezultat i këtij tranzicioni, një pjesë e madhe e popullsisë mbetet pa punë, kurse varfëria, korrupsioni, kriminaliteti dhe kriza ekonomike marrin përmasa shumë të mëdha.

Ekonomia e shkatërruar, aferat dhe skandalet politike, korrupsioni dhe marrëdhëniet e keqësuar ndëretnike edhe më shumë e destabilizuan vendin.

Duhet të theksohet fakti se me Kushtetutën e vitit 1991, shqiptarët i humbën të drejtat të cilat, formalisht, i gëzonin me Kushtetutën e vitit 1974. Për këto shkaqe Kushtetuta u miratua pa votat e deputetëve shqiptarë në Parlament».

Varianti shqiptaro maqedonas: «Periudha e viteve 2000-2001 karakterizohet me papunësi të madhe (400.000 persona të aftë për punë janë të papunësuar kurse 80.000 familje marrin ndihma sociale) dhe me procesin e papërfunduar të privatizimit i shoqëruar me procedurë për falimentim për shumë ndërmarrje. Vërehet rënie e standardit të jetës.

Jeta politike karakterizohet me parti një etnike, ndërsa Qeveria udhëhiqej nga parti nacionaliste. Qeverisja ishte e centralizuar, kurse sistemi juridik dhe ligjet nuk ishin të përfunduara (nuk ishin miratuar ligjet e nevojshme, ndërsa ato të miratuarat shpesh ndryshonin dhe gjykatat shumë ngadalë vendosin për lëndët).

Edhe pse në Parlament kishte përfaqësues shqiptarë dhe në koalicionin qeveritar kishte

ministra-shqiptarë, në administratë dhe strukturat shtetërore, shqiptarët nuk ishin proporcionalisht të përfaqësuar. Partitë politike të shqiptarëve në Maqedoni publikisht va-zhdojnë të tregojnë pakënaqësinë nga statusi i tyre në jetën politike dhe publike në vend. Tensionimi i marrëdhënieve ndëretnike vjen në shprehje gjatë protestave të shqiptarëve me kërkesë për rritjen e të drejtave kolektive ku ndëshkohen dhe konfrontohen me policinë si dhe gjatë protestave të maqedonasve kundër shtimit të të drejtave të shqiptarëve»

Një analizë e thjeshtë, të çon në konkluzionin se ngjarjet e vitit 2001 janë shkruar me mëndësinë e pushtetit. Konkluzioni i përbashkët se: «Tensionimi i marrëdhënieve ndëretnike vjen në shprehje gjatë protestave të shqiptarëve me kërkesë për rritjen e të drejtave kolektive ku ndëshkohen dhe konfrontohen me policinë si dhe gjatë protestave të maqedonasve kundër shtimit të të drejtave të shqiptarëve», apo : «Jeta politike karakterizohet me parti një etnike, ndërsa Qeveria udhëhiqej nga parti nacionaliste» është i pasaktë. Kryengritja në Maqedoni kishte rrënjë më të thella. Mjafton vetëm një fakt: Politikanët maqedonas dhe shqiptarë kanë harruar një detaj: Kur ata erdhën në pushtet në Maqedoninë e pavarur dhe pluraliste, bënë një amnisti gjysmake, e cila nuk përfshinte një pjesë të politikanëve aktualë të BDI-se. Dhe Maqedonia për arsye nga më të ndryshmet qysh kur u bë shtet i pavarur ka pasur në krye qeveri nacionaliste. Prirjen nacionaliste apo jo nuk ta jep emri i Partisë, por veprimtaria e saj. Në vitet 1991-1998, Maqedonia udhëhiqej nga një parti me emër socialdemokrat. Por kjo nuk e pengoi atë të ishte nacionaliste ndaj shqiptarëve.

Ndërsa përgjigja e katërt ka të bëjë me nevojën që ngjarjet e vitit 2001, të qëndrojnë si Vlera të Universit Moral të kombit shqiptar dhe jo si parzmore apo talisman i disa apo shumë politikanëve të djeshëm dhe të sotëm në Maqedoni, Kosovë e Shqipëri, disa prej të cilëve me kalimin e viteve kanë filluar të bejnë edhe përpjekjen për ta shtrëmbëruar apo modifikuar këtë Vlerë.

Përgjigja e pestë lidhur me pyetjen ka të bëjë me faktin se përkundër strukturave të shtetit maqedon që krijoi edhe formacione terroriste dhe ultranacionaliste, shqiptarët u treguan me të emancipuar dhe më të civilizuar. Gjatë kryengritjes së shqiptarëve në vitin 2001, në Maqedoni u krijuan dhe filluan të vepronin disa organizata si: 1-« Organizata revolucionare maqedonase » e njohur me gjërësisht me emrin « Todor Aleksandrov ». Sipas deklaratës së themeluesve të saj, kjo organizatë kishte rreth 1200 antarë të armatosur me shtrirje në të gjitha qytetet e Maqedonisë Perëndimore.

2-« Lëvizja për clirimin e Maqedonisë ». Kjo organizatë u formua nën slloganin « Atdheu në rrezik ».

3-Organizata “Fronti revolucionar maqedonas” .

Këto tre organizata janë organizatorët dhe ekzekutorët e akteve të dhunshme ndaj shqiptarëve në Shkup dhe veçanërisht në qytetin e Manastirit.

Përgjigja e gjashtë ka të bëjë me faktin që ndërsa maqedonët janë shumë me tepër nacionalistë se sa duhet, shqiptarët u treguan më shumë internacionalistë se sa duhet. Kjo mëndësi shekullore e shqiptarëve u shfaq hapur edhe në kryengritjen e vitit 2001. Ndërsa nga njëra anë, drejtuesit e UCK e konsideronin pushtues pushtetin maqedonas, nga ana tjetër nuk harronin të flisnin për ruajtjen e integritetit të Maqedonisë. Po sjell dy shëmbuj domethënës në favor të tezës së sipërthënë:

I pari ka të bëjë me drejtuesin kryesor të UCK Abaz Xhuka (Ali Ahmeti). Ja se çfarë thotë ai në një shkrim-platformë të botuar në 6 qershor 2001:

«Në asnjë moment, shqiptarët në Maqedoni nuk kanë kërkuar zgjidhjen e problemeve në rishikim të kufijve ose në prishjen e Maqedonisë.

Ne kemi qenë për ruajtjen e Maqedonisë si njësi, ne kemi qenë të përkushtuar për ruajtjen e integritetit territorial dhe të sovranitetit të Maqedonisë, gjithmonë kemi shprehur gatishmëri për

dialog.» (Ali Ahmeti Ja pse I morëm armët, 6 qershor 2001)

I dyti ka të bëjë me, Arbër Xhaferrin ish-lideri i PDSH, një parti me prirje nacionaliste në Maqedoni. Ja se çfarë thotë ai midis të tjerash në një letër drejtuar ish-sekretarit amerikan të shtetit, Pauell :

«Por as unë e as komuniteti shqiptar i Maqedonisë nuk kemi hequr dorë nga vendi ynë

dhe e ardhmja e saj. Ne besojmë që mund të arrihet një marrëveshje për të ndryshuar ligjet dhe trajtimin e shqiptarëve, të na mundësojë të bëhemi qytetarë të plotë dhe të barabartë të Maqedonisë.»

(Arber Xhaferri Letër drejtuar Kolin Pauell 2 korrik 2001)

Pjesë e problemit shqiptar

Ky libër është pjesë e problemit shqiptar. Në libër trajtohen ato ngjarje që tashmë nuk përbëjnë sekret. Tashmë nuk përbën sekret se Arbër Xhaferri u takua me Ali Ahmetin në Tiranë në fundmarsin e vitit 2001 në një Rezidencë qeveritare në prani të ish-kryeministrit të Shqipërisë Ilir Meta dhe të autorit të librit. Ata përcaktuan strategjinë e përbashkët për realizimin e të drejtave të shqiptarëve. Ashtu siç nuk është sekret se në atë takim Ali Ahmeti e quajti Arbër Xhaferri «Vëllai i Madh». Ashtu siç nuk është më sekret se Arbër Xhaferri në fund majit të vitit 2001 pranoi të jepte dorëheqjen nga Kryetar i PDSH dhe të mos braktiste Ali Ahmetin dhe Marrëveshjen e Prizrenit. Tashmë nuk është sekret të pohohet se arsyeja e vërtetë që ish-kryeministri i Kosovës Ramush Haradinaj nuk u ftua në Shqipëri në mars 2001 ishte fakti se ai konsiderohej nga disa drejtues të qeverisë së Shqipërisë si eksportues i kryengritjes nga Kosova në Maqedoni. Tashmë nuk përbën sekret të thuhet se nuk ka qene vetem ish-kryeministri maqedonas Georgievski ai që kërkoi ndarjen e Maqedonisë. Por kanë qënë edhe shqiptarët të cilët e kërkuan dhe planifikuan këtë ndarje si një hap drejt zgjidhjes tërësore të çështjes shqiptare. Ashtu siç nuk është më sekret të thuhet se ata që e penguan këtë ndarje ishin disa politikanë shqiptarë në Tiranë, Tetovë dhe Prishtinë. Tashmë nuk është sekret të thuhet se hartuesi i vërtetë i Marrëveshjes së Ohrit, është ish-ambasadori amerikan Robert Frouik, që në vitin 2001 ishte përfaqësues i OSBE në Shkup. Mos pranimi i Planit Frouik dhe largimi i tij nga Maqedonia si person i padëshirueshëm, nuk kishte të bënte me ndonjë gabim të tij. Në të kundërtën, kishte të bënte me një lëshim që diplomacia e SHBA i bëri asaj të BE. Pasi diplomacia e Brukselit në rastin e kryengritjes së shqiptarëve, hezitoi të pranonte realitetin. Ajo në kulmin e kryengritjes, firmosi me Maqedoninë MSA në Luksemburg.

Tashmë nuk është më sekret të thuhet se edhe shërbimet inteligjente të Shqipërisë dhe Maqedonisë bashkëpunuan me njëri tjetrin për ta penguar ndarjen e Maqedonisë etj.

Tanusha ose fillimi i Kryengritjes

Kryengritja e shqiptarëve filloi në fshatin me emër të bukur Tanushë. Ndërsa maqedonasit e quajne Tanushevc. Ajo filloi ditën e diel, datë 3 mars 2001. Ka qënë një mot i vretur. Kryeministri i Shqipërisë Ilir Meta ndodhej në Varshavë dhe ishte në një takim me presidentin e atëhershëm polak Kvasnjevski kur u njoh me ngjarjen. Kryengritësit shqiptarë kishin vrrarë 3 police maqedonas. Pas dite, do të shkonte në Paris për të referuar në një Akademi Diplomatike. Pasi u njoh me ngjarjen, Meta e vlerësoi atë seriozisht dhe fillimisht kërkoi formulimin e një deklaratë për të bërë të njohur qëndrimin e qeverisë shqiptare. Deklaratën e kemi formuluar sëbashku me ish-zëvendësministrin e jashtëm Pëllumb Xhufi në zyrën time në kryeministri. Jemi konsultuar disa herë me Metën në telefon lidhur me tekstin e saj dhe vetëm në orën 15.50 minuta i është përcjellë me faks TVSH për ta lexuar në lajmet e orës 16.00. Deklarata u prit mirë, më mirë se sa mendohej. Ish-ministri i jashtëm francez Vedrine që u takua me Metën në Paris e vlerësoi si korrekt dhe të matur qëndrimin e qeverisë shqiptare. Në mënyrë të përmbledhur teksti i deklaratës ishte si më poshtë.

Ç'bisedoi Meta me të dërguarin special të Papandreut, Aleks Rondos?

Kryeministri Meta sapo ishte kthyer nga Franca ku kishte marrë pjesë në një Akademi Diplomatike dhe ishte takuar me ministrin e Jashtëm francez, Vedrine. Ministri francez e kishte vlerësuar shumë deklaratën e qeverisë shqiptare lidhur me ngjarjet e ndodhura në fshatin Tanushë në Maqedoni. Mbas një qëndrimi prej dy ditësh në Tiranë, ai do të shkonte përsëri në Madrid në një takim pune me kryeministrin e atëhershëm të Spanjës Aznar. Ishte një tur lobingu politik që Meta e kishte ndërmarrë për integrimin e Shqipërisë.

I kisha kërkuar që në Spanjë të shkoja edhe unë për ta shoqëruar dhe kishte rënë dakord që të isha pjesë e delegacionit.

Darka në Rogner

Gjatë kohës që po i raportoja lidhur me ecurinë e ngjarjeve në Maqedoni, i bie telefoni. Pas telefonatës në gjuhën angleze, më thotë duke ndërprerë bisedën se do ishim për darkë në Hotel Rogner. Ngaqë të nesërmen do niseshim në Spanjë, darka m'u duk e çuditshme dhe e pyeta se cili ishte qëllimi i saj. Me tha se do hanim darkë me këshilltarin kryesor të Jorgo Papandreut, Aleks Rondos, i cili ishte nisur drejt Tiranës me një mesazh. Do ishte një darkë pune.

Për Aleks Rondosin vetëm kisha dëgjuar se ishte nga më të besuarit e Papandreut. Isha përshëndetur më atë vetëm dy herë kalimthi. Herën e parë në Budapest në prill 2000 kur kemi qënë me Fatos Nanon në aktivitetin e Forumit për Problemet Etnike dhe herën e dytë në Athinë në dhjetor 2000, kur isha me Metën përsëri në Forumin për Marrëdhëniet Etnike të Alen Kassof.

U takuam në darkë në një nga sallat e rezervuara të Hotel Rogner. Ndodhej edhe këshilltari diplomatik i Metës. Rondos u fut menjëherë në temë. Ai i foli Metës për shqetësimin e Greqisë lidhur me ngjarjet në Maqedoni dhe veçanërisht UÇK-në e Ali Ahmetit. (Pavarësisht se Ahmeti akoma nuk kishte dalë hapur si përfaqësues politik i UÇK-së, Rondos e dinte kush ishte drejtuesi i saj. Ahmeti këtë do ta bënte në mbremjen e 17 marsit 2001. Por kjo është temë tjetër).

Kërkesat e Rondosit: UÇK të mos prekë pronat e Helenik Petroleum

Nga ana e tij, Meta me shumë qetësi i shpjegoi qëndrimin racional të mbajtur nga qeveria shqiptare ndaj këtyre ngjarjeve dhe pritjen pozitive që i ishte bërë këtij qëndrimi nga kancelaritë perëndimore. Pas këtij shpjegimi, Rondos i foli më hapur. Ai kërkoi që Meta të shfrytëzonte gjithë ndikimin e tij në radhët e UÇK-së dhe të forcave politike në Maqedoni që vatrat e konfliktit të mos preknin pronat e Helenik Petroleum dhe të mos shtrihej konflikti në kufirin greko-maqedonas. (Kishte disa muaj që Meta e kishte kapërcyer ftohtësinë në marrëdhëniet me Greqinë të krijuara pas zgjedhjeve lokale të tetorit 2000 në Himarë). Pasi u mendua disa minuta, Meta kthehet nga unë dhe më thote: "Mos hajde nesër me mua në Madrid, por shko në Tetovë, na duhet t'i ndihmojmë". I thashë se këtë punë mund ta bënim edhe kur të ktheheshim nga Madridi. "Jo, jo, me tha me nxitim, nesër. Bile fol që sonte me ata dhe thuaju të mos na ngatërrojnë. I kemi miqtë tanë". Nuk e zgjata me bisedën. Ndërkaq Rondos shikonte nga ne, por ishte shumë pak i habitur. Më vonë mora vesh se ai i dinte lidhjet e mija me UÇK-në. (Gjithmonë, pranë Metës dhe kryeministrave të tjerë shqiptarë ka pasur njerëz që Athinën e kanë vënë në dijeni në kohën e duhur për ngjarje të rëndësishme të hapsirës shqiptare).

Akoma nuk kishin mbërritur në Tiranë disa nga kryetarët e partive politike shqiptare të Maqedonisë dhe të Kosovës. Ndërsa erdhi para tyre, Aleks Rondos.

Udhëtimi në Maqedoni dhe biseda telefonike me Ali Ahmetin

Të nesërmen, Meta u nis në Madrid i shoqëruar nga këshilltari i tij diplomatik, ndërsa unë në Tetovë. Për të qenë më i sigurt, mora disa masa sigurimi, sidomos pasi të hyja në territorin e Maqedonisë. (Kishte filluar lufta dhe udhëtimi nëpër Maqedoni kishte filluar të bëhej i pasigurtë). I telefonova zëvendëskryetarit të PDSH, Menduh Thaçi me të cilin deri atëherë kishim vetëm njohje dhe respekt reciprok dhe i kërkova që të më dërgonte një makinë policie shoqërimi. (PDSH ishte në qeverinë e drejtuar nga Georgievski dhe zëvendësministri i Brendshëm ishte Refet Elmazi i PDSH, ndërsa ministre e Brendshme ishte akoma Dosta Dimovska). Menduhi me gatishmërinë e tij karakteristike më garantoj për masat e sigurimit dhe njëkohësisht edhe për takimin me Arbër Xhaferrin. Pasi kalova Qafën e Thanës në pjesën e kufirit të Maqedonisë, pavarësisht tensionit që vihej re për shkak të konfliktit që kishte filluar, nuk më penguan. I shoqëruar nga makina e policisë që me kishte dërguar Menduhi, mbërrita i qetë në Tetovë. Kisha tre probleme për të zgjidhur. E para duhej të flisja me Abazin (Aliun) dhe ti thoshja që të kishte kujdes, por edhe të ruhej nga provokimet, që mund ti bënte dikush dhe pastaj t'ia faturonin UÇK. E dyta duhej të takohesha me drejtuesit më të lartë të PDSH dhe ti bindja të vinin në Tiranë në takim me kryeministrin Meta. E treta më duhej të takoja edhe udhëheqjen e PPD për t'u thënë edhe atyre që të vinin në Tiranë në takim me Metën. (Kishim dijeni për mosmarrëveshjet midis dy partive politike shqiptare, por gjykova se situata e krijuar do ma bënte më të lehtë. E fillova me të parën: Kujdes në kufirin me Greqinë?

Pas sistemimit në një hotel që kishte pronar një simpatizant të PDSH, dola për një shëtitje

dhe nga celulari im mora në telefon Abazin (Aliun). I thashë që të kishte kujdes lidhur me Greqinë, me investimet greke në Maqedoni dhe mosshtrirjen e konfliktit në kufirin grekomaqedonas.

Njëkohësisht i thashë që të merret masa edhe për provokacionet që mund të bëheshin nga shërbimet sekrete të disa vendeve të rajonit. Nuk i thashë asgjë se cili e kishte kërkuar një gjë të tillë, por se ishin sugjerime nga ana ime. U kuptuam shumë shpejt me Abazin (Aliun). Dhe Abaz Xhuka nuk gaboi, ai i mori shumë mirë masat. Diplomacia dhe politika greke nuk patën asnjë pretekst të atakonin UCK dhe drejtuesit e saj.

Kapërcim në kohë

Mediat greke : Eshhtë krijuar Ushtria Çlirimtare e Çamërisë

Në datën 30 maj 2001, zëdhënësi i Ministrisë së Jashtme të Greqisë, Panajotis Beglitis, doli në një konferencë për shtyp dhe i bëri thirrje komunitetit ndërkombëtar të dënojë deklaratat ekstremiste të shqiptarëve ndaj Greqisë.

Çfarë kishte ndodhur

Gjatë ditës, një përfaqësues i vetëshpallur kish prezantuar një organizatë rebele shqiptare, të cilën ai e quajti Ushtria Çlirimtare e Çamëve, duke shtuar se baza e kësaj organizate është në veriperëndim të Greqisë. Personi që është identifikuar si Mehmeti është shprehur kështu në një emision radiofonik të transmetuar në Australi. (Sikur nuk kishte me mijra radiostacione në Evropë). Sipas radios, ai përfaqëson Ushtrinë të vetëshpallur Çlirimtare, aktive në Maqedoni. Sipas Beglitis: Imagjinata e sëmurë e disa elementëve terroristë, që përpiqen të paraqesin çështje të paqena, duket se nuk ka kufij. Po kështu edhe reagimi i komunitetit ndërkombëtar ndaj tyre nuk duhet të ketë kufij.

Ali Ahmeti i shkruan Jorgo Papandreu

Dhe një ditë pasi Beglitis bëri akuzën në drejtim të UÇK, Ali Ahmeti bën një veprim të shpejtë dhe të zgjuar. Ai i dergon një letër publike ministrit të Jashtëm grek, Jorgo Papandreu lidhur me çështjen në fjalë.

Në letër thuhet se: “Zotëri i nderuar! Desha t’jua adresoj këtë letër lidhur me një dezinformatë që ka dalë këto ditë në media, sikur gjoja unë, Ali Ahmeti, shefi politik i UÇK-së, kam deklaruar se, së shpejti do të krijohet Ushtria Çlirimtare e Çamërisë. Dëshiroj t’ju siguroj në emrin tim dhe në emër të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare, se një deklaratë e këtillë kurrë nuk është bërë nga ne. Përkundrazi, me këtë rast dëshirojmë t’ju sigurojmë se ne e respektojmë sovranitetin dhe integritetin e shtetit grek, sikundër që e respektojmë edhe integritetin dhe sovranitetin e shtetit maqedonas. Z. ministër, më lejoni edhe njëherë të shpreh respektin dhe mirëkuptimin që kemi për shtetin dhe popullin grek”.

Greqia përgënjeshton pohimet për ekzistencën e UÇÇ

Pergjigja e menjëhershme e UÇK-së ndaj njoftimeve fantazëm lidhur me ekzistencën e UÇÇ, shumë shpejt i dha frytet e saj. Në datën 19 qershor 2001, përfaqësuesi i saj, Dimitris Repas i vlerësoi si të pabaza pohimet e Presidentit jugosllav, Vojislav Koshtunica, që ekstremistët shqiptarë do të aktivizohen në Epir, në veri të Greqisë. Repas, u shpreh se nuk ekziston çështje që ka të bëjë me integritetin e Greqisë, dhe as shenja të UÇÇ-së.

Por Papandreu nervozohet !

Është një fakt se diplomacia greke e ndjeu vehten të mënjanuar nga zgjidhja e krizës në Maqedoni. Një gjë e tillë shkaktoi nervozizëm në radhët e politikës dhe diplomacisë greke. Pa u zgjatur në fakte të shumta të asaj periudhe, po jap vetëm qëndrimin e ishministrit

të jashtëm grek Papandreu në Komisionin e Politikës së Jashtme të Parlamentit grek. Mbledhja e Komisionit të jashtëm është zhvilluar në datën 6 qershor 2001, pasi Aliu në emër të UÇK-së i kishte dëguar letrën dhe pasi ishte verifikuar që deklarata në radion australiane ishte një banalitet i rëndomtë.

Në Mbledhje Papandreu deklaroi se ishte pesimist përse i perkiste rrjedhës së mëtejshme të krizës në Maqedoni. Në seancën e Këshillit të Politikës së Jashtme dhe të Mbrojtjes të Parlamentit grek, Papandreu u bëri thirrje partive greke të mbajnë kontakte me partitë në Maqedoni që në këtë mënyre të mbrojnë sovranitetin, integritetin dhe tërësinë e saj.

Papandreu është angazhuar për mosndryshimin e kufijve dhe ka dënua terrorizmin dhe kontaktet me terroristët, por ka konfirmuar se tani në Ballkan po shtrohet çështja shqiptare, zgjidhjen e së cilës e sheh si shoqëri evropiane, multietnike, duke respektuar të drejtat e pakicave dhe të kufijve stabil, por lehtë të kalueshëm.

Pangallos kundërshton: Më shumë marrdhënie me Shqipërinë

Ish-shëfi i diplomacisë greke, Pangallos ka hedhur poshtë qëndrimin për zgjidhjen evropiane si të mundshme, duke thënë se nuk mund të vlerësojë rezultatin e krizës në Maqedoni. Ai ka rekomanduar që Greqia të ketë “kontakte në të gjitha nivelet, me shfrytëzimin e të gjitha mjeteve” me shqiptarët, meqenëse pozita strategjike e Shqipërisë është shumë më rëndësishme nga pozita strategjike e Maqedonisë. Papandreu në një replikë pjesërisht është pajtuar me qëndrimet e Pangallosit dhe është angazhuar për bisedime në Maqedoni dhe në Ballkan.

Kthim në rrjedhën historike

Dy takimet me PDSH dhe PPD

Ndryshe i mendova këto takime dhe ndryshe më dolën. Takimin me udhëheqjen e PDSH e mendova më të vështirë. Jo thjesht se ajo ishte parti në qeverisje, jo thjesht se unë konsiderohesha si “mik i rebelëve”, por edhe për faktin se mbi ata kishin filluar të binin një sërë akuzash. Ato ishin të pavërteta, por gjithësesi kishin krijuar një lloj tensioni, veçanërisht tek Kryetari i PDSH Arbër Xhaferri dhe zëvendëskryetari Menduh Thaçi. Por në fakt takimi me udhëheqjen e PDSH me doli më i lehtë se sa e prisja. Në takim me pritën të dy, Xhaferri dhe Thaçi në zyrën e Arbërit. Më bënë një ekspozitë shumë të qartë të konfliktit që sapo kishte filluar. Nuk vura re tek ata asnjë shënje mërie, apo pakënaqësie ndaj UCK. Më shumë ishin të preokupuar për zgjidhjen e tij të shpejtë. Pasi u bëra të qartë qëndrimin zyrtar dhe qëndrimin real të qeverisë shqiptare ju thashë edhe për ftesën e kryeministrit Meta për të ardhur në Tiranë dhe për të biseduar lidhur me rrugët për zgjidhjen sa më të mirë të konfliktit. Problemi shtrohej që konflikti të cvilizohej, që ai të dekurajohej, por nga të dy palët. Për habinë time, edhe Arbëri edhe Menduhi e pritën me dashamirësi këtë ftesë dhe me thanë se ishin të gatshëm të vinin në çdo kohë që do ta gjykonte qeveria e Shqipërisë.

Në selinë e PPD

Pasi mora këtë miratim të tyre, u nisa për në selinë e PPD, që ishte afër selisë së PDSH. Aty më priste një befasi e pakëndshme. Ishte mbledhur shumica e Kryesisë Qëndrore. Pasi ju prezantova atyre që nuk më njihnin u parashtrova nevojën e konsultimit me qeverinë shqiptare dhe me partitë e tjera politike shqiptare në rajon. Njëkohësisht I vura në dijeni për miratimin e ftesës nga ana e PDSH. (E pashë që gabova taktikisht, ata kishin kohë që shkonin keq me PDSH, inatin më të madh e kishin me Menduh Thaçin.) Disa prej tyre filluan të shfaqnin rezerva për ftesën për më tepër që unë ju kërkova se duhet të vinin të dy partitë në një takim të përbashkët. Pas disa deklaratave “patriotike” prej disave, sepse një pjesë e PPD kishte filluar të mbante qëndrime radikale, mu desh që tu kujtoja dy prej tyre se cilat kishin qene qëndrimet e tyre ndaj Ahmetit dhe shokëve të tij kur kishin qënë në Zvicër. Kjo ndërhyrje e qetësoi situatën dhe i dha mundësi “Plakut” (Imer Imerit, Abdurrahman Halitit dhe Abdylhadi Veselit që të më falenderonin për ftesën dhe të jepnin miratimin e tyre për të ardhur në takim me kryeministrin Meta sëbashku me PDSH.

Pasi mbarova, në largim e sipër u takova përsëri me Arbërin dhe Menduhin. Edhe ata u ndjenë të lehtësuara. Përsëri me një makinë shoqërimi u nisa drejt kufirit. Rrugës më mori në telefon kryeministri Meta. I thashë që të dy partitë kishin rënë dakord të vinin në Tiranë sëbashku.

Më pyeti se çfarë mund të bënim më shumë se kaq. Ju përgjigja se kur të mbrija në Tiranë do ta mendoja. Pasi kalova Qafën e Thanës e njoftova Aliun për bisedimet dhe i thashë që të ishte i kujdesshëm në deklaratimet ndaj PDSH dhe PPD. Ramë dakord që do të mbanim njëri tjetrin në dijeni.(Akoma nuk i kisha thënë për të ardhur në Tiranë)

Deklarata e përbashkët për shtyp

Nuk e përmenda rastësisht këtë telefonatë. Ishte hedhur hapi i parë politik, që dy partite kryesore politike shqiptare kishin pranuar të vinin në Tiranë për të koordinuar veprimet e tyre. Deri në atë periudhë disa pjesë të tyre e shikonin me armiqtësi njëra tjetrën. Por

duheshin edhe disa hapa të tjerë. Dhe një prej këtyre hapave ishte që opinioni publik shqiptar, rajonal dhe ndërkombëtar të njihej zyrtarisht me unifikimin e qëndrimeve të tyre politike ndaj konfliktit. Pra duhej një deklaratë e përbashkët për shtyp. Por jo midis tyre dhe qeverisë shqiptare, por vetëm midis tyre. Duke pasur parasysh vështirësitë e takimit me PPD dhe PDSH, mora në telefon Arbërin dhe ja thashë si ide dhe a mund të realizohej. Arbëri me pjekurinë e tij të rrallë politike, më thotë: -është një gjë shumë e mirë, por a do të pranojnë ata të PPD-së. E lamë të flisnim përsëri të nesërmen. Deklaratën e hartova pasi mbrrita në Tiranë. Kur gjykova se ishte bërë e pranueshme për të dyja palët ja dhashë kryeministrit Meta.(Meta ishte i kujdesshëm për deklaratat e shtypit.) Por nuk bëri asnjë vrejtitje, vetëm më pyeti i shqetësuar: Do pranojnë të dalin me deklaratë të përbashkët shtypi?

I thashë se me Arbërin kisha rënë dakord, por ngelej problem PPD. Në vazhdim I sugjerova që unë do flisja paraprakisht me Imerin dhe Abdylhadiun dhe ai të fliste me Abdurrahman Halitin me që kishte njëfarë miqësie me atë.

Të tre drejtuesit e PPD ranë parimisht dakord, por vunë si kusht që do ta shikonin ma parë Deklaratën.

Takimi është zhvilluar diku nga ora 17.00 e datës 11 mars 2001 në zyrën e pritjes së kryeministrit. Nga PDSH kishin ardhur Arbër Xhaferri dhe Iliaz Halimi. Nga PPD, Imer Imeri, Abdylhadi Veseli dhe Abdurrahman Haliti që nuk mori pjesë në takim. Në fillim foli Meta. Me saktësi dhe qartësi, ai pozoi se cili do të ishte qëndrimi zyrtar dhe qëndrimi real i Shqipërisë. Por u sugjeroi atyre se edhe ata duhet të kishin një qëndrim zyrtar dhe një qëndrim real. (Në takime të tilla, Meta nuk imponohej asnjëherë. Ai mendimin në shumë raste e kishte të pabukur, por rrallë herë të pasaktë).

U krijua një ambient i ngrohtë, saqë kur erdhi pjesa e Deklaratës së përbashkët, nuk pati ndonjë vështirësi të madhe. U bë vetëm një sugjerim nga Imeri për të shtuar një fjali. Dhe para medias, PDSH dhe PPD dolën me një qëndrim të përbashkët.

Deklarata e Metës

Ata veç kësaj dhanë edhe një konferencë shtypi me Metën e cila të nesërmen në 12 mars 2001 u botua si më poshtë: “Kryeministri Ilir Meta bisedoi të dielën mbi situatën aktuale në Maqedoni me kryetarin e Partisë Demokratike të Shqiptarëve të Maqedonisë, Arbën Xhaferi dhe me kryetarin e Partisë për Prosperitet Demokratik, Ymer Ymeri. Qeveria shqiptare shpreh mbështetje ndaj përpjekjeve që dy partitë e shqiptarëve në Maqedoni po bëjnë për të nxitur dialogun dhe për të marrë pjesë në jetën institucionale të vendit, tha kryeministri Meta gjatë takimit të zhvilluar në selinë e kryemistrit në Tiranë.

Pjesëmarrësit në takim u shprehën kundër zgjidhjes së problemeve me anë të dhunës dhe veprimeve të armatosura. Veprimet e dhunshme janë në kundërshtim me interesat e shqiptarëve dhe me qëndrimet e faktorit politik shqiptar në Maqedoni, u shprehën politikanët në takim. Meta, Xhaferi dhe Ymeri u shprehën për ruajtjen e integritetit dhe sovranitetit të Maqedonisë si një kusht i rëndësishëm për forcimin e mëtejshëm të paqes dhe stabilitetit në rajon. Ata mbështetën zgjidhjen e problemeve të shqiptarëve në Maqedoni, vetëm në mënyrë institucionale dhe me mjete demokratike, ndërsa shprehën dëshirën që qeveria maqedonase, në bashkëpunim me faktorin politik shqiptar do të manifestojë përmbajtje dhe urtësi në zgjidhjen e problemeve të krijuara. Pjesëmarrësit në takim shprehën vlerësime për angazhimin e Bashkimit Evropian dhe SHBA për zgjidhjen e problemeve me rrugë paqësore dhe mjete demokratike”.

Arbër Xhaferri dhe Imer Imeri i qëndruan Marrëveshjes midis tyre

Dhe koha vërtetoi se deri në përfundim të luftës, PDSH dhe PPD e ruajtën këtë qëndrim. Për ta përfunduar këtë pjesë të rëndësishme do përmend vetëm dy detaje. Pas dy muajsh, Imeri pranoi të shkonte sëbashku me Arbërin në Prizren për të firmosur me Aliun Marrëveshjen e famshme që tronditi bashkësinë ndërkombëtare. Ndërsa Arbëri kur do të krijohet qeveria e shpëtimit kombëtar në Maqedoni, refuzoi të dilte në krye të bllokut shqiptar duke kërkuar që PDSH dhe PPD të jenë të barabarta dhe duke hedhur poshtë propozimin e Lupço Georgievskit.

Ky bashkëpunim korrekt midis Xhaferit dhe Imerit do të çonte edhe në pajtueshmerinë e tyre për të marrë pjesë në atë që u quajt qeveria e Koalicionit të gjerë në Maqedoni. Ajo u shpall në 13 maj 2001. Sipas njoftimit për shtyp u tha se: “Me një votë kundër dhe katër

abstenime, deputetët e Parlamentit të Maqedonisë mbrëmë ia dhanë votëbesimin qeverisë së re të unitetit politik. Partitë shqiptare do të drejtojnë katër ministri. Nga radhët e Partisë Demokratike Shqiptare, ministër i ekonomisë është Besnik Fetaj, i Punës dhe Politikës Sociale, si dhe deri më tash është Bedredin Ibrahim, kurse nga Partia për Prosperitet Demokratik, ministër i Drejtësinë është Hixhet Mehmeti dhe ai pushtetit Lokal, Faik Asllani. Nga katër zëvendëskryeministra ndër ta dy janë shqiptarë - Qemal Musliu i PPD-së dhe Xhevdet Nasufi i PDSH-së. Ndërkaq, Parlamenti i Maqedonisë zgjodhi edhe dy nënkryetarë të rinj - krahas Iliaz Halimit të PDSH-së do të jetë edhe Olloman Sulejmani i PPD-së”. Kundër qeverisë së re votoi deputeti dhe kryetari i Partisë Kombëtare Kastriot Haxhirexha

Ilir Meta-Hashim Thaçi: Në qëndër të bisedës situata në Maqedoni

Për të mbërritur te takimi kryesor midis Ali Ahmetit dhe Arbër Xhaferrit duheshin kaluar disa faza.

Faza e parë ishte takimi midis Metës dhe PDK së Hashim Thaçit. Thaçi me një delegacion erdhi në Tiranë dhe pas bisedimeve ata dolën në një Konferencë shtypi. Pas takimit takimit Ilir Meta-Hashim Thaçi (Tiranë, 14 mars 2001) u dha një konferencë e përbashkët për shtyp. Në qender të Konferencës ishte situata në Maqedoni, përqëndrimi i trupave serbe në kufirin Kosovë-Maqedoni, zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë, gjendja në Mitrovicë.

Meta pas takimit: Diskutuam ngjarjet në Rajon

“Diskutuam për qëndrimet tona përse i takon ngjarjeve më të fundit në rajon. Në radhë të parë, unë kam shprehur dhe një herë tjetër kënaqësinë që procesi i krijimit të institucioneve në Kosovë ka shënuar hapa përpara, gjë që konfirmohet edhe një herë me zgjedhjet e fundit lokale atje, të cilat janë dhe zgjedhjet e para të lira dhe demokratike në Kosovë, të cilat ishin dhe një herë tjetër tregues se shqiptarët kanë të gjitha kapacitetet si qytetarë të Kosovës për të krijuar institucione të reja demokratike në mënyrë të qytetëruar. Së dyti, kemi ndarë të njëjtin mendim se mbajtja e zgjedhjeve të përgjithshme do të ishte një tjetër nevojë dhe domosdoshmëri për kompeltimin e gjithë kuadrit institucional të nevojshëm për stabilitetin dhe për të ardhmen evropiane të Kosovës dhe se po kështu procesi i bashkëjetesës dhe integritit të minoriteteve në Kosovë. Është procesi i të ardhmes dhe se në një Kosovë të re demokratike dhe evropiane nuk ka nevojë për enklava, por ka nevojë dhe për bashkëjetesë dhe për integrim, ashtu sikurse unë i kam theksuar dhe një herë zotit Thaçi gjatë këtij takimi qëndrimin e qeverisë shqiptare edhe ndaj qeverisë së re të Beogradit që t’i inkurajojë serbët në Kosovë, dhe veçanërisht serbët në Mitrovicë, që të mos bojkotojnë ndërtimin e institucioneve të reja demokratike atje, të mos përdoren si faktorë tensioni, por perkundrazi të integrohen dhe të marrin pjesë në krijimin e institucioneve të reja demokratike të përbashkëta. Po kështu kemi shprehur kënaqësinë për mendimin të bërë tashmë publik për armëpushimin njëjavor në zonën e Preshevës si një shenjë të vullnetit të shqiptarëve atje për të hyrë në një proces të ri, në një proces politik që do të sjellë afirmimin dhe respektimin e të drejtave të tyre sipas standardeve ndërkombëtare. Ashtu sikurse kemi ndarë të njëjtin shqetësim dhe arsyezim se zhvillimet e fundit në Preshevë janë rrezik i zhvillimeve të mëparshme atje të rezistencës së shqiptarëve ndaj genocidit që regjimi i Miloshevicit ka ushtruar në Kosovë, por edhe në gjithë zonën e Preshevës. Dhe vendimi i djeshëm tregon dhe një herë se shqiptarët, duke kuptuar kontekstin e ri të zhvillimeve, po kështu kanë kuptuar se procesi politik është ai që do të ketë të ardhme për zgjidhjen e problemit atje dhe urojmë që kjo të vazhdojë. Natyrisht që kemi ndarë shqetësimin e përbashkët për zhvillimet e fundit në Maqedoni dhe veçanërisht në veri të Maqedonisë në kufi me Kosovën ku ka pasur disa akte tepër shqetësuese të dhunës dhe të ekstremizmit. Dëshiroj dhe një herë tjetër të theksoj se për Qeverinë shqiptare përdorimi i dhunës për arritjen e qëllimeve politike është, jo vetëm i papranueshëm, por edhe i dënueshëm dhe po kështu Qeveria shqiptare është e mendimit se procesi i demokratizimit të Maqedonisë do të vazhdojë me vete pjesëmarrjen e shqiptarëve si edhe derimë tani

nëpermjet funksionimit më të mirë të institucioneve atje dhe njëkohësisht nëpermjet njohjes së të drejtave të shqiptarëve të Maqedonisë, të cilat ata i kanë kërkuar dhe të cilët u takojnë sipas të gjithë normave ndërkombëtare. Po kështu sovraniteti dhe integriteti i

Maqedonisë janë një domosdoshmëri, jo vetëm për vete stabilitetin e Maqedonisë, por për stabilitetin e gjithë rajonit tonë. Dhe bësojmë se gjithashtu dhe në Maqedoni aktet e dhunës do të izoloohen dhe procesi politik do të ketë përparësi për trajtimin e çështjeve që kanë ngritur subjektet politike shqiptare atje. Po kështu kemi konkluduar se midis Shqipërisë dhe Kosovës janë hedhur hapa të rëndësishëm në bashkepunimin bilateral janë

disa marrëveshje të ndryshme që janë nënshkruar edhe në Tiranë edhe në Prishtinë, veçanërisht në fusha të ndryshme të kulturës, të turizmit etj. Dhe këto marrëdhënie padysim që do t'i çojmë akoma dhe më përpara jo

vetëm në marrëdhëniet reciproke, por edhe në dobi të stabilitetit të rajonit tonë”.

Thaçi: Nuk jam për Maqedoni Federative

Pas takimit edhe Thaçi bëri një deklaratë për shtyp. Ai tha se “dhe për mua ishte kënaqësi që sonte të bashkëbisedoj me kryeministrin e Shqipërisë, zotin Meta, me ftesën e të cilit jemi në një vizitë këtu. Biseduam kryesisht për bashkëpunimin Kosovë – Shqipëri në aspektin politik, ekonomik, kulturor dhe atë të turizmit, biseduam edhe për çështje të tjera, të cilat janë aktuale në Kosovë, sidomos për problemin e Mitrovicës, për mundësinë e tejkalimit të gjendjes së rëndë në Mitrovicë dhe të bllokimit të qytetit. Gjithashtu, për mundësinë që Shqipëria të luajë, ashtu si ka luajtur një rol aktiv në kontaktet me ndërkombëtarët, që të ushtrojë ndikim tek bashkësia ndërkombëtare dhe tek Beogradi për lirimin e të burgosurve shqiptarë politikë që mbahen në burgjet e Serbisë. Në të njëjtën kohë biseduam edhe për zhvillimet në Kosovë, për progresin e bërë për momentin që është duke u hartuar Kushtetuta e përkohshme e Kosovës dhe për fillimin e procesit të parapërgatitjeve për zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë që do të mbahet në tetor të këtij viti. Biseduam edhe për problemin e Preshevës dhe marrëveshja e djeshme për armepushim mes shqiptarëve në Preshevë dhe komunitetit ndërkombëtar tregon se shqiptarët janë të përkushtuar që të gjitha problemet, të cilat janë të hapura dhe janë të trashëguara nga koha e Milosheviçit në këto treva shqiptare, të zgjidhen politikisht në bashkëpunim me komunitetin ndërkombëtar dhe në këtë qasje, forcat politike në Preshevë, Medvegjë dhe Bujanovc do të kenë mbështetjen edhe të faktorit politik shqiptar në Kosovë.

Gjithashtu biseduam rreth problemeve që janë krijuar në Maqedoni. Në kërkojmë dhe kemi mbështetur zgjidhjet politike të problemeve në Republikën e Maqedonisë, kemi mbështetur udhëheqësit politikë shqiptarë atje për zgjidhjen e problemeve në këtë Republike, avancimin e të drejtave të shqiptarëve në Maqedoni. Në kuader të kësaj sidomos kemi këmbëngulur në faktorin politik shqiptar për lirimin e të gjithë të burgosurve politikë që mbahen në burgjet e Maqedonisë gjithashtu edhe në të drejtën e shqiptarëve që të jetë si element shtetformues në Maqedoni dhe në kuadër të kësaj të fillojë dhe ndryshimi i Kushtetutës së Maqedonisë që shteti maqedon të jetë shtet i maqedonasve, shqiptarëve dhe i komuniteteve të tjera. Gjithashtu është biseduar dhe për bashkëpunimin, të cilin duhet ta vazhdojmë dhe kam besim se në të ardhmen janë duke u hapur procese dhe do të hidhen hapa të rëndësishëm të bashkëpunimit mes Kosovës dhe Shqipërisë.

Thaçi iu përgjigj pyetjes “ç'mund të thoni për marrëveshjen mes KFOR-it dhe Ushtrisë Jugosllave për kthimin e kesaj ne Kosovës”. Ai tha se “nuk është nënshkruar asnjë marrëveshje për kthimin e trupave serbe në Kosovë, ndërsa marrëveshja për kthimin e trupave serbe në zonën e sigurisë është një marrëveshje për të cilën ne kemi dalë me qëndrimin tonë se vetëm zgjerimi i zonës së sigurisë krijon stabilitet të qëndrueshëm për arsye se afrimi i ushtrisë që ka ushtruar gjenocid në Kosovë krijon shqetësim tek qytetarët vendas të asaj treve. Problemet janë të krijuara dhe natyrisht ndikojnë edhe në Kosovë dhe në vendet fqinje të Kosovës, por megjithatë ne kemi besim të plotë se ne do të organizojmë zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë këtë vit”.

Pyetje: Si e vlerësoni qëndrimin e politikës kosovare ndaj zhvillimeve në Presheve dhe Maqedoni?

Meta- Të gjithë faktorët politikë shqiptar në Kosovë janë gjithmonë të mirëseardhur në Tiranë, natyrisht që kjo është një çështje që u takon atyre. Por në cdo kohë ata janë të mirëpritur dhe në përgjithësi faktori politik shqiptar në Kosovë ka treguar përmbajtje

përsa i takon zhvillimeve në luginën e Preshevës dhe situatës në Maqedoni, duke kërkuar shmangien e dhunës dhe duke kërkuar hapjen e rrugës të një procesi politik, si i vetmi proces i dëshirueshëm dhe që mund të mbështetet nga të gjithë, pasi cdo rruge tjetër i ka kaluar koha.

Pyetje: Cilat janë marrëdhëniet tuaja me Partinë e re shqiptare?(Kishte vetëm disa ditë që ishte krijuar PDK e drejtuar nga Haxhirexha që mbronte tezën e federalizmit të Maqedonisë)

Thaci-Unë kam bashkëpunim të mirë me të gjithë liderët politikë shqiptarë të Maqedonisë dhe në kuadër të kësaj kam bashkëpunim dhe me kryetarin e partisë së re që është krijuar në Maqedoni, por nuk mbështesim qarqet për federalizimin e Maqedonisë.

Pyetjes se “a ka dorë në ngjarjet në Maqedoni, Ushtria Çlirimtare e Kosovës”, Hashim Thaçi iu përgjigj: “Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka qënë një. Ajo është transformuar në strukturë politike mbrojtëse të sigurisë dhe në kuadër të kësaj ne besojmë bashkëpunimin tonë me forcat politike të shqiptarëve në Maqedoni dhe kam besim se këto forca do të gjejnë gjuhë të përbashkëta në artikullimin e kërkesave të tyre për avancimin e të drejtave të shqiptarëve në kuadër të shtetit të Maqedonisë. Por ne nuk e gjuajmë gurin për të fshehur dorën. Në atë që e kemi bërë publikisht në bashkëpunim me komunitetin ndërkombëtar.

Organizimi i takimit Ahmeti-Xhaferri në Tiranë

Kishte mbetur edhe një hallkë tjetër që duhej të plotësohej. Ndoshta me e rëndësishmja. Duhej që Ali Ahmeti të takohej me Arbër Xhaferri. Politika shqiptare në Maqedoni ishte bashkuar. Por duhej të bashkohej pushka me politikën, për të mos ndodhur vëllavrasja dhe për t’u arritur me sa me pak dhimbje qëllimi i luftës. Nga ana tjetër takimet me PDSH, PPD dhe PDK, etj, kishin krijuar një ambient të përshtatshëm lidhur me konfliktin në Maqedoni. Qeveria shqiptare po merrte nota vlerësimi nga bashkësia ndërkombëtare. Megjithatë ishte një eufori dritëshkurtër. Akoma nuk ishte vendosur lidhja midis UÇK dhe Partive politike shqiptare. Dhe e dyta: akoma nuk dihej se çfarë qëndrimi real dhe jo zyrtar do mbanin aleatet strategjikë të shqiptarëve që ishin amerikanët. Prandaj nuk kishte kohë për eufori dhe tam-tame qëndrimesh konstruktive. Duhej civilizuar kryengritja dhe civilizim në atë periudhë do të thoshte që krahu i luftës të bashkëpunonte me krahun e paqes. Në qënder të krahut të luftës ishte Abazi(Ali Ahmeti) dhe në qënder të krahut të paqes ishte Arbër Xhaferri, partia e të cilit ishte në qeverinë e Maqedonisë.

Imazhi mashtrues i Maqedonisë ndaj shqiptarëve

Ishin dy momente të rëndësishme që nuk të linin të këndëlleshe në eufori. Dhjetë ditë pas shpërthimit të kryengritjes në Tanushë, aktivizimi ndaj asaj që po ndodhte në Maqedoni ishte maksimal. Ishte i tillë nga bashkësia ndërkombëtare dhe jo pa arsye. Deri në atë periudhë bashkësia ndërkombëtare e kishte paraqitur Maqedoninë si modelin e shoqërisë multietnike,ku liritë dhe të drejtat demokratike të të gjitha etnive respektoheshin. Ajo që ndodhi pas Tanushës, në një masë tregonte se edhe bashkësia ndërkombëtare ose nuk e kishte njohur, ose kishte bërë sikur nuk e kishte njohur gjendjen në Maqedoni. U aktivizua Tirana politike jo vetëm për faktin se një konflikt kishte filluar në vendin fqinjë dhe i cili rrezikonte që po të zgjerohej ta përfshinte edhe atë, por edhe për faktin se konflikti ishte nisur nga shqiptarët. Tirana politike ishte në pozitën më të vështirë. Nga një ane ajo nuk mund të mos mbronte liritë dhe të drejtat që u takonin shqiptarëve në Maqedoni, por nga ana tjetër nuk mund të merrte përsipër të mbronte konfliktin që kishte nisur. U aktivizua edhe një pjesë e politikës shqiptare në Kosovë. Disa u aktivizuan për të përgënjeshtuar propagandën maqedone se nuk kishte kryengritje, por një “agresion nga Kosova”. (Por kjo është një temë që do ta trajtojmë me vehte). Ndërsa disa të tjerë u aktivizuan për të dalë në krye të kryengritjes, për tu paraqitur si “pronare” të asaj që nuk i përkiste kërkujt, por veten lirisë si koncept dhe realitet. Këta individë shfrytëzuan edhe faktin që tre javë pas shpërthimit të kryengritjes, UÇK-ja akoma nuk e kishte shpallur liderin e saj politik. Ata morën përsipër para disa përfaqesuesve të bashkësisë ndërkombëtare dhe para Tiranës Politike si ishin në gjendje ta neutralizonin konfliktin, boll të kishin përkrahje !!! Çuditërisht në këtë periudhë doli edhe teza mbi federalizimin e Maqedonisë e proklamuar nga një parti që u shpall gjatë muajit mars 2001. Në këtë

periudhë filluan të botohehin një numur shkrimesh të cilët atakonin deri në “tradhëti” drejtuesit e PDSH-së që ishte në koalicionin qeverisës të kryesuar nga Arbër Xhaferri. (Parantezë numur 1: tre javë pas fillimit të konfliktit ekzistonte një predispozicion për të ashpërsuar marrdhëniet midis UCK dhe PDSH deri edhe në armiqësi. Kjo ishte shumë e rrezikshme. Askush nga pjesëmarrësit në takimin e Tiranës të partive politike shqiptare në Maqedoni nuk e mori përsipër neutralizimin e këtij rreziku të madh. Ata vetëm e konstatuan.)

Si duheshin quajtur Ahmeti dhe shokët e tij që u rebeluan Personalisht në atë periudhë i kam quajtur pa mëdyshje ekstremistë. Nuk jam nisur nga etiketimi por nga realiteti dhe analiza e tij. Pushka nuk është gjë tjetër veçse veprim ekstrem. Është tjetër çështje se ata ishin ekstremistë se ashtu ishin të formuar apo se ishte dikush tjetër që i kishte detyruar të

bëheshin të tillë. Por të bindje bashkësinë ndërkombëtare për të dytën, duhej të pranoje të parën. Personalisht në atë periudhë i kam konsideruar si « rebelë ». Përsëri nuk jam nisur thjesht nga ndonjë etiketim për t'i dënuar. Por realisht Abaz Xhuka (Ali Ahmeti) dhe shokët e tij ishin rebeluar ndaj një pushteti. Është tjetër çështje se rebelimi ishte pjesë e mentalitetit të tyre, pra është tjetër çështje që ata ishin vërtet “rebelë”, apo ishte dikush tjetër që me politikën e tij i kishte detyruar të rebeloheshin ndaj kësaj politike. Por ata nuk ishin terroristë. Ata nuk bënë terror, bënë vetëm luftë. Por jo vetëm kaq, ata bënë luftë, për të qënë qytetarë, për të qënë të lirë. Programi i tyre politik ishte një ndër programet më demokratike që kishte shfaqur ndonjëherë ndonjë lëvizje e armatosur.) Por le të kthehemi tek analiza. Ishte si një ndeshje futbolli. Në fushë ishin skuadrat, ndërsa në shkallët e stadiumit ishin tifozët e çdo skuadre. Nuk kishte arbitër në fillim. «Skuadra» që kishte pushtetin nuk pranoi për disa muaj “arbitër”. Ajo pandehte se me megallomaninë e pushtetit do ta mundëte shpejt «skuadrën» tjetër. Pikërisht në këtë periudhë Arbër Xhaferri nga një anë dënonte dhunën, ndërsa nga ana tjetër përpiqej që qeveria e Maqedonisë të dëgjonte zërin e arsyes. Disa politikanë shqiptarë nga Tirana, Tetova dhe Prishtina që menduan se erdhi koha për të bërë karrierë politike po e akuzonin Xhaferin edhe partinë e tij si «tradhëtare». Individë të tillë fshehur pas nacionalizmit verbal u përpoqën të dilnin në skenë. Të njëjtin rol filluan ta merrnin edhe disa të tjerë të cilët megjithë kishin qënë në pushtet apo pjesë e pushtetit në Maqedoni përkrah Branko Cervenkovskit nga viti 1991 deri në vitin 1998, kishin bërë shumë pak për liritë dhe të drejtat e shqiptarëve, ndërsa Ali Ahmetin dhe shokët e tij i quanin “enveristë të pandreqshëm”. E gjithë kjo tablo plus edhe frustrimin e një pjese të atyre që kishin marrë armët, kishte si rrezik të saj potencial fillimin e vëllavrasjes midis shqiptarëve. Pra çështja shtrohej : Kryengritja ekzistonte. Duhej inkurajuar apo duhej dekurajuar ajo. Duhej ashpërsuar dhuna apo duhej civilizuar kryengritja. Duhej integruar shqiptarët apo duhej dhënë material për tu satanizuar akoma më shumë ata. Duhej mbrojtur programi politik i UÇK-së, apo duhej hedhur edhe ai poshtë bashkë me dhunën? Duheshin ndarë shqiptarët në Maqedoni në “ne” dhe “ata”, apo secili duhet të bënte punën e tij për një qëllim të vetëm?

Për tu dhënë zgjidhje pyetjeve të mësipërme realizohet në Tiranë takimi midis Ahmetit dhe Xhaferit. E bisedova fillimisht me Arbërin mundësinë e një takimi midis tij dhe Ahmetit pa i thënë gjë kryeministrit Meta. Arbëri me mënjësinë dhe atdhetarizmin e tij koherent më tha se do të ishte shumë dakord për një gjë të tillë, por shprehur rezervën se a do të pranonte Abazi (Aliu). Ju përgjigja se do te merresha unë me këtë punë. Pasi mora miratimin e Arbërit, kërkova në telefon Abazin (Aliun). E kam marrë nga telefoni i zyrës në kryeministri me mendimin se edhe po të përgjohesha, ato që do të bisedoja nuk përbënin ndonjë sekret për ata që donin ti dinin. Më doli në telefon dikush tjetër të cilit pasi i dhashë emrin tim i kërkova të më gjente Abazin. (Dikushi që u paraqiti në telefon ishte një nga miqtë e mij të Lucernës me pseudonimin Haxhi Baba ose Musa Demiri. Aliu përdorte një telefon satelitor me prefiks të Zvicrës). Pasi më doli në telefon Abazi, midis të tjerash në esencë i thashë: Po sikur të takohesh me Arbër Xhaferin, si mendon do jetë mirë apo keq? M'u përgjigj se ishte pyetje në përgjithësi apo kishte ndonjë gjë konkrete.

Ja ktheva se është një gjë konkrete për të ndihmuar njëri-tjetrin tani që është luftë dhe

pastaj në paqe le të vendosë vota se kush duhet të fitojë. Rëndësi ka që të mos bëhen në Maqedoni gabimet që u bënë në Kosovë. (Abazi i kapi mesazhin që i dërgova. Ai e dinte edhe miqësinë politike që kisha unë me Arbër Xhaferrin).

-Ku mendon të takohemi, më tha. -Paraprakisht në Tiranë, iu përgjigja, por do të të them pasi të garantoj disa detaje të tjera. Ramë dakord parimisht edhe me Abazin.

Por akoma nuk kisha rënë dakord me kryeministrin Meta, i cili nuk dinte asgjë për këto biseda. (Edhe disa njerëz që kishte ngarkuar ai për tu marrë me këtë çështje akoma nuk kishin mësuar emrin e vërtetë të Abazit. (Ata edhe kur i raportonin, Abazin e quanin Ali Mehmeti dhe jo Ali Ahmeti). E bisedova edhe me atë këtë çështje. Në fillim ju duk e pabesueshme organizimi i një takimi të tillë. Por, pasi i thashë se kisha rënë dakord paraprakisht me Arbërin dhe Abazin, më tha që të prisja sa të më njoftonte ai. (E dija se donte të merrte një miratim tek disa partnerë ndërkombëtarë.). Më thirri të nesërmen dhe më tha që ta organizoja takimin midis tyre dhe të përpiqesha për ti pajtuar. Në atë moment nuk më tha që edhe ai do të vinte në takim. Ramë dakord për vendin ku do të zhvillohej takimi. Por veçanërisht ramë dakord për mënyrën se si do të sillnim Abazin në Shqipëri. I thashë se do të bisedoja vetë me atë, për ti thënë se tek cili kishte më shumë besim për të shkuar dhe për ta sjellë në Tiranë. Fola me Abazin dhe me Arbërin dhe caktuam datën e takimit, që si ditë binte ditë e diel dhe ishte fundmarsi 2001.

Parantezë

Ali Ahmeti shpallet Përfaqësues politik i UÇK-së

Abaz Xhuka (Ali Ahmeti)deri në 16 mars 2001 nuk dihej zyrtarisht që ishte përfaqësuesi kryesor politik i UÇK. Mbas disa takimeve në Tiranë me politikanë nga Kosova dhe përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare, vazhdonte akoma trajtimi i tij dhe i UCK si «kriminelë dhe trafikantë droge». Por filluan edhe përpjekjet për ta marrë dikush tjetër drejtimin e kryengritjes. Në kushte të tilla ishte e pamundur mbështetja dhe ndihma për ata. Prandaj pasi është larguar nga Shqipëria delegacioni i PDK së Thaçit, jam lidhur urgjent me Abazin në telefonin satelitor. Mbase më doli ne telefon Haxhi Baba, i kërkova të më jepte urgjent Abazin. Nuk e kam pyetur as për shëndetin kur më doli në telefon, por vetëm i kam thënë : “Brënda dy-tre ditëve, duhet që opinioni publik ta marrë vesh se përfaqësuesi politik i UÇK quhet Ali Ahmeti me pseudonimin Abaz Xhuka, prandaj dërgo në RTK (Radiotelevizioni i Kosovës) njoftimin se je ti përfaqësues politik i UCKsë”. “Pse duhet ta bëj kaq shpejt” më pyeti në fillim Abazi(Ali Ahmeti)? “Duhet ta bësh i thashë që të të hapin dosjen tënde në Lucernë dhe të shikojnë se ti jeton akoma me kolltukët e falur të Karitasit zviceran dhe nuk je trafikant droge, por idealist fanatic». Por Abaz Xhuka (Ali Ahmeti) nuk bindej kollaj. Ata që e njohin ja dinë këtë cilësi të karakterit të atëhershëm të vitit 2001. Më dha këtë përgjigje, pa ma përmendur emrin: “Po shiqo, më duhet të bisedoj me shokët atje poshtë dhe të konsultohem me ata” (“Shokët” atje poshtë ishin komandantët e njërive të UÇK). Ju përgjigja menjëherë me inat, bile me shumë inat duke ja njohur mirë karakterin e tij: “Këto thuaja ndonjë tjetri Abaz Xhuka, dhe jo mua, ti je edhe komandant edhe komisar edhe shef shtabi, prandaj dil dhe thuaj që je përfaqësues politik i UÇK-së). Ndryshe nuk kam se si të të ndihmoj as ty dhe as shokët e tu”.

Dhe Abaz Xhuka, u tregua vërtet i zgjuar. Në lajmet e orës 19.00, të datës 17 mars 2001, RTK njoftoi se përfaqësuesi politik i UÇK-së ishte Ali Ahmeti, emigrant politik në Zvicër. Të nesërmen, Agjensia e lajmeve Kosovapress dhe shumica e agjensive të lajmeve e dhanë lajmin në formën e mëposhtme :

UÇK emëron përfaqësuesin e vetë politik

«Luftëtarët shqiptarë të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare, të cilët po luftojnë në veriperëndim të Maqedonisë, kanë caktuar përfaqësuesin e vet, që do të zhvillojë negociata me pushtetin maqedonas. Ali Ahmeti, do të jetë përfaqësues i tyre, që do të tentojë të nisin bisedimet politike për zgjidhjen e krizës. Emërtimi i tij u njoftua përmes një komunikate, që u shpërnda në Prishtinë, ndërkaq që këtë e ka publikuar, sot, edhe një e përditshme prishtinase. Komunikata thekson se zgjedhja e Ali Ahmetit, unanimisht u vendos, gjatë një mbledhje të të gjithë komandantëve, që u mbajt në malet e

Maqedonisë. Ali Ahmeti, mësohet se është nga Kërçova”.

“Vëllai i Madh” Xhaferri dhe “Vëllai i Vogël” Ahmeti

Abazi mbritti i pari në Tiranë. Ishte hera e parë që e takoja të veshur me kostum dhe me kravatë. Ishte shumë i tensionuar, pasi para takimit me Xhaferrin u takua me dikë tjetër dhe takimi doli me shumë sukses. Aliu e mbrojti mirë programin politik të tij dhe të shokëve të tij. (Me Abazin kishte ardhur nga Kosova dhe një shok i tij me të cilin kishin punuar gjatë kur ekzistonte akoma LPK. Marrdheniet midis tyre ishin ftohur gjatë luftës në Kosovë deri në akuza fyese ndaj njëri tjetrit. Më vonë i kishin përmirësuar marrdheniet dhe ai e shoqëroi edhe në Tiranë. Por nuk doli në skenë). Pasi lashë orën e takimit shkova të takoja Arbërin i cili sapo kishte mbërritur i shoqëruar qysh nga Qafa e Thanës nga makina policie. I thashë se takimi do të zhvillohej aty ku ishte Arbëri. (Arbëri ndodhej në një nga rezidencat qeveritare në zonën që vazhdon të quhet e Bllokut). Por pas një ore që po bisedonim me Arbërin, me telefonon kryeministri Meta, i cili ndodhej në rezidencën qeveritare në Malin e Dajtit dhe më jep një adresë tjetër takimi midis tyre sepse do të merrte pjesë edhe ai në takim. Rreth orës 19.00 jemi takuar të katërt, Meta, unë, Ahmeti dhe Xhaferri. Në kundërshtim me çfardo parashikim, takimi me Ahmetin që në fillim ishte shumë i ngrohtë. Aliu qysh në fillim e konsideroi Arbërin si vëlla i madh. Më vonë biseduam për detajet e bashkëpunimit midis tyre, për mënyrën se si do të merreshin vesh me njëri tjetrin. (Dhe duhet thënë se për një vit rresht nga mars 2001 deri në mars 2002, Xhaferri dhe Ahmeti janë marrë vesh shumë mirë me njëri tjetrin). Njëkohësisht ramë dakord që takimi nuk do të publikohej dhe do të mbahej sekret. UÇKja akoma nuk konsiderohej si partnere në bisedime.

“Incidenti” nga Kosova dhe “shqetësimi” e Metës

Të nesërmen e takimit edhe Xhaferri edhe Ahmeti u nisën për në vëndet e tyre. Megjithatë në Tiranë sekretin e këtij takimi është ruajtur, në Prishtinë diçka kishte filluar të rridhte. Dhe sot në Tiranë, askush me përjashtim të atyre që duhej ta dinin në mars 2001, nuk e di si dhe ku është bërë takimi. Shteti shqiptar kishte filluar të funksiononte. Ai kishte filluar të kalonte në shtet real. Por disa zëra nga Kosova dhe një gazetë në Kosovë e afërt me PDK shkruajtë për takimin duke përmendur emrin e Metës, Xhaferrit dhe Ahmetit dhe duke shprehur keqardhjen përse nuk kishte marrë pjesë edhe Hashim Thaçi. Sipas gazetës, takimi ishte bërë në Tushemisht afër Pogradecit.

I vënë në dijeni për këtë artikull, kryeministri Meta më merr në telefon dhe më thotë përse ka ndodhur një gjë e tillë. Pa pritje përgjigjen time, me një ton urdhërues më thotë se nuk dua që emri im (i Ilir Metës) të dilte më nëpër gazeta sikur jam takuar me Aliun dhe Arbërin. Edhe pasi i thashë se lajmi ishte botuar në një gazetë afër PDK së Thaçit dhe ishte më shumë xheloz, Meta vazhdonte të ngrinte zërin duke kërkuar që në asnjë gazetë të mos dilte emri i tij. I kënaqur nga sukcesi i takimit midis Xhaferrit dhe Ahmetit, nuk u bezdisa shumë nga toni i zërit të tij.

E rëndësishme ishte se ishte shmangur mundësia e konfliktit ndërshqiptar në Maqedoni, e mërive dhe larjes së hesapeve midis shqiptarëve dhe se ishte vendosur kontakti midis «kallashnikovit dhe politikës», kontakt që ka funksionuar në mënyrë të shkëlqyer për shumë muaj të paktën deri sa u nënshkrua Marrëveshja e Ohrit.

“Agresion” nga jashtë apo konflikt me rrënjë nga brenda

Një nga problemet me të cilat u ndesh politika shqiptare, maqedone, rajonale dhe ajo ndërkombëtare kishte të bënte me shkaqet e konfliktit në Maqedoni. Pas ngjarjeve në Tanushë e deri në fund të majit 2001, politika maqedonase, një pjesë e politikës rajonale dhe ndërkombëtare mbronte tezën se nuk kishte konflikt me rrënjë brenda në Maqedoni, por agresion nga Kosova dhe pjesërisht nga Shqipëria. Hedhja e tezës se ishte një agresion nga jashtë kishte një qëllim të dyfishtë: Të paraqitej Kosova si “Delja e Zezë” e rajonit. E para kishte të bënte me satanizimin e vetë Kosovës dhe klasës së saj politike. Më shumë këtë tezë e mbronin politika serbe dhe lobi proserb në Europë. Edhe ai që konsiderohej si politikani më demokratik në Serbi, ish-kryeministri Zoran Gjingjiç mbronte tezën se luftimet në Maqedoni ishin një agresion nga Kosova mbi Maqedoninë. Në takimin e zhvilluar në Shkup në datën 10 maj 2001 me ish-kryeministrin Georgievski, Gjingjiç pohoi se grupet e armatosura në Maqedoni kanë mbështetje në strukturat politike në Kosovë. Sipas njoftimeve të dhëna nga agjensitë e lajmeve: Georgievski dhe Gjingjiç thanë se vëndet e tyre aktualisht ballafaqohen me një problem thuajse identik atë të

“ekstremizmit shqiptar”, i cili sipas tyre është në lidhje të ngushtë. Gjingjiç ia të kuptohet se të dy vëndet mendojnë të ngrej në nivel të ministrive të brendshme një komision të veçantë të përbashkët i cili do të merrej, sipas tij, me luftimin e “terrorizmit dhe të kriminalitetit rajonal”. Ndërkaq, kryeministri Georgievski lidhur me këtë nënvizoi: “Është i pakontestueshëm konstatimi se problemi me të cilin ballafaqohemi ka të njëjtën rrënjë me qendër në Kosovë dhe na vjen keq që Kosova gjithmonë e më shumë po shndërrohet në një qendër të destabilizimit dhe të përhapjes së terrorizmit në Evropën Juglindore”. Ai shtoi se nga “TMK-ja ekstremistët veprojnë në Serbinë Jugore dhe në Maqedoninë Veriperëndimore”.

Trajkovski edhe pas takimit me Bush, fajëson Kosovën

Në 2 maj 2001 ish-presidenti i Maqedonisë Trajkovski, u prit në takim nga presidenti i SHBA, Bush. Nje ditë më parë, presidenti Bush kishte pritur në takim kryeministrin e Shqipërisë Ilir Meta. Pas takimit, gazetarët i bënë pyetje Trajkovskit: Zoti President, ju gjithmonë keni fajësuar Kosovën për krizën e fundit në Maqedoni. A mos kemi të bëjmë këtu me një formë shfajësimi për problemet e brendshme etnike, të cilat qeveria e Maqedonisë nuk ka arritur t'i zgjidhë dot? Përgjigje e Trajkovskit: “Gjatë këtyre 10 vjetëve Maqedonia ka qënë shembull pozitiv për Ballkanin, shembull për bashkegjatësinë etnike dhe për një strukturë të qartë ligjore që parashikonte pjesëmarrjen e gjithë kombësive në jetën politike dhe publike të vendit. Ky model bashkëpunimi ndëretnik u vlerësua edhe nga komuniteti ndërkombëtar. Por, pikërisht kjo strukturë u godit nga terroristët shqiptarë, nisur nga urrejtja etnike. Dhe me diskutimet e tanishme ne po përpqemi të shërojmë plagët e këtij problemi. Megjithatë, gjithë problemet vijnë nga Kosova, pasi Kosova vazhdon të mbetet qendra e terrorizmit. Komuniteti ndërkombëtar duhet të marrë masa dhe të vendosë rendin dhe shtetin ligjor në Kosovë. Unë do të doja të shihja një politikë më të përgjithshme dhe më urgjente të komunitetit ndërkombëtar për të ardhmen e Kosovës. Ajo duhet të bëhet qendër stabiliteti dhe sigurie në rajon. Mendimi im është se udhëheqja politike e Kosovës është e angazhuar dhe e orientuar drejt vlerave evropiane. Banorët në Kosovë janë kundër terrorizmit. Prandaj besoj se elementët terroristë në Kosovë do të izoloreshin në se komuniteti ndërkombëtar mbante një qëndrim më të prerë ndaj tyre.

Ana Lindt dhe Kris Paten: UÇK të largohet nga Maqedonia

Por edhe një pjesë e politikës dhe diplomacisë europiane mbronte tezën maqedonase se nuk kishte kryengritje, por agresion nga jashtë ndaj Maqedonisë. Ja disa shëmbuj: Në datën 17 maj 2001, Ana Lind, ish-ministre e jashtme suedeze, atëherë kryesuese e radhës së BE-së dhe komisioneri për Politikë të Jashtme Kris Paten u bënë thirrje përfaqësuesve të UÇK-së që të largohen nga Maqedonia. Ata thanë se kjo organizatë ka destabilizuar këtë vënd dhe se veprimet e tyre në masë të madhe janë veprime kriminale. Zyrtarët e lartë evropianë i bënë gjithashtu thirrje qeverisë së Maqedonisë të tregohet e matur në përdorimin e forcës nga ushtria maqedonase. Lind tha se duhet izoluar ekstremistët të cilët po e destabilizojnë vendin, ndërsa ftoi qytetarët e Maqedonisë që ta mbështesin qeverinë e bashkimit kombëtar dhe të forcojnë lidhjet me komunitetin ndërkombëtar. Ajo tha se qeveria e re mes tjerash duhet ta çojë përpara dialogun ndëretnik. Ndërkaq, komisioneri Kris Paten theksoi se qeveria maqedonase ofron përparim dhe jetë më të mirë për të gjithë në Maqedoni, duke shtuar se "ekstremistët ofrojnë tmerr dhe gjakderdhje". Ai e përcolli mesazhin e komunitetit ndërkombëtar duke iu drejtuar përfaqësuesve të UÇK-së të largohen, sepse ata sipas tij nuk kanë asgjë tjetër përveç problemeve që i ofrojnë, nuk kanë qëllime politike, ndërsa demokratët sipas tij në Maqedoni përkrahen nga të gjithë.

Edhe OSBE i thotë UCK të largohet

Në datën 23 maj 2001, shefi i Misionit të OSBE-së në Maqedoni, Karlo Ungaro deklaroi në një intervistë për Dojçe Ëele se e vetmja alternativë për zgjidhjen e krizës maqedonase është largimi i luftëtarve të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare. Sipas tij, komuniteti ndërkombëtar tashmë është kundër angazhimit të grupeve të armatosura të shqiptarëve në bisedimet. Ungaro u shpreh se “për t'i dhënë fund luftimeve, grupet e armatosura shqiptare ta pranojnë ftesën që u është bërë për t'u larguar si dhe për të dorëzuar armët. Për sa kohë që ata do të jenë të pranishëm në fshatra nuk do të ketë alternativa tjera me

përjashtim të aksioneve të armatosura”.

«Agresioni» nga jashtë mbulonte mungesën e lirive brënda Maqedonisë. Politikës maqedonase i interesonte kjo tezë për të mbuluar mungesën e lirive dhe të drejtave të shqiptarëve në Maqedoni. Kjo kishte filluar qysh me hartimin e Kushtetutës së vitit 1991 e cila i ngushtonte më shumë liritë dhe të drejtat e shqiptarëve. Maqedonia ishte i vetmi vënd që pasi shpalli pluralizmin nuk bëri amnisti të plotë për shqiptarët. Politikani më i shquar shqiptar në Maqedoni, Arbër Xhaferri jep këtë deduksion për shkaqet e kryengritjes: “Maqedonasit donin të ishin krah për krah serbëve dhe në vitin 1989 sollën bashkë me serbët ngushtimin e të drejtave kushtetuese të shqiptarëve. Në vitin ‘91 u hartua Kushtetuta demokratike e Maqedonisë që në vetvete ngërthente atë psikologji e mëndësi nacionaliste të viteve ‘80. Në vend që kjo Kushtetutë ta demokratizonte Maqedoninë, ajo në fakt e mori në qafë zhvillimin e këtij shteti. Pra në vitin 1991, u mboll fara e përçarjes etnike mes shqiptarëve dhe maqedonasve. Shqiptarët i humbën të drejtat e trashëguara dhe nuk i fituan të drejtat që ofronte sistemi demokratik. Pra kjo periudhë është me plot gabime që solli konfliktin e vitit 2001. Pas vitit 2001 kemi sërish tendencën që të riciklohen mëndësitë dhe relacionet e vjetra në pushtet”

Georgievski akuzon edhe në vitin 2002

Edhe pas më shumë se një viti pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Ohrit, në 2 gusht 2002, ish-kryeministri maqedonas Ljubčo Georgievski në një fjalim zyrtar akuzoi Shqipërinë dhe Kosovën se kanë dashur të krijojnë Shqipërinë e Madhe. Ja si e njoftoi deklaratën e tij, qeveria maqedonase : «Sfida më e madhe e vendit(Maqedonise) është tendenca për krijimin e Kosovës dhe Shqipërisë së Madhe e përkrahur nga struktura të larta të komunitetit ndërkombëtar. Duke komentuar edhe krizën e vitit 2001 në Maqedoni, Georgievski akuzoi komunitetin ndërkombëtar për përkrahje të terrorizmit. Ai, këto komente i bëri në manifestimin qëndror të festës kombëtare, që njihet si «Dy lindenët», ku këtë vit kremtohet 99 vjetori i kryengritjes popullore që çoi në krijimin e republikës së Krushevës, gjatë sundimit otoman dhe 58 vjetori i mbledhjes së parë të Kuvendit antifashist për çlirimin popullor të Maqedonisë. Kryeministri maqedonas Ljubčo Georgievski, në manifestimin qëndror të asaj që konsiderohet si festa më e madhe kombëtare maqedonase, u ka bërë thirrje gjithë maqedonasve të bashkohen para asaj që ai e quajti sfida më madhe e vendit, krijimi i Kosovës dhe Shqipërisë së Madhe: "Disa struktura të mëdha të komunitetit ndërkombëtar qëndrojnë prapa pavarësisë së Kosovës, prapa teritoreve të pastra etnike, dhe siç thashë edhe pas Kosovës së madhe dhe Shqipërisë së madhe". Duke komentuar krizën e vitit të kaluar, Georgievski tha se "strukturat e mëdha të komunitetit ndërkombëtar kanë zhvilluar politikë joparimore, me standarde të dyfishta ndaj shqiptarëve dhe maqedonasve, dhe kanë përkrahur terrorizmin. Kriza e vitit të kaluar, tha Georgievski, ishte rezultat i koalicioneve të interesave të korporatave të mëdha ndërkombëtare luftarake si dhe pretendimeve territoriale për idetë e Kosovës së Madhe. Georgievski tha se Maqedonia tani do të dijë se si të reagojë: "Kur do të vijë sërish kriza, do të dimë të bashkohemi dhe do të luftojmë ashtu siç presim të gjithë". Në delegacionin zyrtar në Krushevë, ku bënin pjesë antarë të kabinetit, vërehej mungesa e ministrave shqiptarë si dhe përfaqësuesve të partive politike shqiptare.»

Ramush Haradinaj nuk ftohet në Tiranë

Në fazën e parë të kryengritjes së shqiptarëve, politika e Tiranës zyrtare pati disa hezitime lidhur me angazhimin e saj në zgjidhjen e kërkesave të tyre në Maqedoni. Teza mbi «eksportimin e kryengritjes» nga Kosova apo mbi agresionin nga jashtë dhe mbi përzierjen e Shqipërisë, zuri vënd edhe tek një pjesë e politikës zyrtare të Shqipërisë. Kjo u reflektua më hapur në marrdhëniet e Tiranës me faktorin politik në Kosovë. Për tu shfajësuar, për të thënë se ja ne nuk kemi lidhje as me eksportimin dhe as me agresionin nga jashtë, Tirana zyrtare diferencoi bashkëpunimin me faktorin politik në Kosovë. Pas ftesës që ju bë PDK të drejtuar nga Hashim Thaçi për të ardhur në Tiranë, u hezitua dhe nuk u ftua AAK e drejtuar nga nje prej komandantëve kryesorë të UCK Ramush Haradinaj. Ka qënë një ngurim dhe hezitim i panevojshëm në të gjitha planet. Arsyeja e vërtetë: Shfajësim tek maqedonasit apo edhe një pjesë e bashkësisë ndërkombëtare që mbante anën e tyre. Justifikimi: AAK është parti e vogël!!

Edhe sikur Ramush Haradinaj të ishte i përzier në kryengritje, një ardhje e tij në Tiranë

vetëm do të ndihmonte që problemi të zgjidhej më shpejt. Ftesa për të ftuar Ramushin në Tiranë nga ata që njihnin peshën dhe rolin e tij, megjithëse e përsëritur, nuk u pranua. Por nuk u lejua as debati mbi dobinë apo dëmin e ftesës. U ndoq rruga e “tabusë”. Ishte një rrugë dritëshkurtër nga ana e Tiranës zyrtare. Ndërkohë që Haradinaj kishte shumë miqësi me ata që drejtonin “rebelët”, vecanerisht me Abaz Xhukën. (Ali Ahmetin). Mjafton të kujtoj se shefi i shtabit të përgjithshëm të UCK, Gëzim Ostreni kishte qënë zëvendës komandant i TMK, ashtu si disa nga komandantët e UCK në Maqedoni kishin qënë luftëtarë nën komandën e Haradinajt dhe kishin luftuar nën komandën e tij në Rrafshin e Dugagjinit.

Tirana dhe institucionet e saj të specializuara, megjithëse kishin kaluar dy vjet nga Kryengritja e Kosovës, akoma nuk kishin njohur apo nuk kishin analizuar specifikën e këtyre kryengritjeve.

Tirana zyrtare nuk i priti dy delegacionet e ardhur nga Presheva dhe Tetova Pas takimeve me PDK; PDSH; dhe PPD, institucionet e shtetit shqiptar nuk pritën më kërkesë nga hapsira shqiptare. Midis periudhës Mars-Prill 2001 erdhën në Tiranë dy delegacione partish nga Maqedonia dhe Lugina e Preshevës për tu takuar me Kryeministrin e Shqipërisë Meta. Njëri ishte delegacioni i PDK së Maqedonisë dhe kryesohej nga Xhevat Ademi, sekretar i përgjithshëm i Partisë. Ishte një parti e sapo krijuar dhe që kishte hedhur tezën e federalizmit të Maqedonisë. Dhe tjetri ishte përfaqësuesi politik i UÇPMB në Luginën e Preshevës Jonuz Musliu, aktualisht Kryetari i Partisë Lëvizja për Progres Demokratik. Kryeministri Meta nuk i priti, por nuk i priti askush tjetër nga qeveria shqiptare. I prita vetëm unë në zyrën time dhe kam mbajtur me ata një qëndrim distancues, që ishte qëndrim i gabuar. Të njëjtin qëndrim kam mbajtur në fillim edhe ndaj Emrush Xhemajlit, Kryetar i LPK dhe një nga miqtë e mi më të afërt. I ndodhur brenda trysnisë së propagandës së «eksportimit të konfliktit» i kam kërkuar Emrushit të mos përzihej në një gjë të tillë. E megjithëse ai ngulte këmbë me të drejtë se kryengritja i ka rrënjët brenda Maqedonisë dhe unë isha dakord me atë sepse e njihja shumë mirë situatën, i kërkoja në fillim të rrinte mënjatë dhe të mos përzihej. Ishte një bisedë shumë e tensionuar sepse ishte një bisedë false. Të dy mendonim njësoj, por unë kisha marrë rolin e moderatorit.

Akuzat ndaj Shqipërisë për «eksportim kryengritje»

Trysnia nga bashkësia ndërkombëtare ndaj rolit të Shqipërisë kishte të bënte edhe me akuzat që vinin nga politika dhe propaganda e Maqedonisë. Në disa raste, Georgievski kishte atakuar hapur Shqipërinë se po ndihmon ekstremistët, po i përkrah dhe stërvit ata. Ndërsa, realiteti tregonte të kundërtën: Qeveria e Shqipërisë si e kam thënë edhe më lart zyrtarisht ka qënë e para që dënoi dhunën dhe ekstremizmin në Maqedoni. Udhëheqësit e Shqipërisë dënuan me forcë dhunën dhe ekstremizmin e bashkëkombësve të tyre dhe mbështetën sovranitetin e shtetit maqedonas. Mbështetja e Tiranës ishte kaq e padyshimtë, sa që jo vetëm udhëheqësit e Bashkimit Evropian dhe të NATO-s e vlerësuan atë pozitivisht, por edhe kryeministri i Maqedonisë Georgievski, presidenti Trajkovski dhe ministri i Jashtëm Kerim, publikisht falënderuan qeverinë shqiptare për këtë përkrahje nga ana e saj. Megjithatë kur je i çoroditur, atë që thua sot e mohon nesër. Në kohën që konflikti në Tetovë u vendos përkohësisht nën kontroll dhe filloi dialogu politik ndëretnik midis qeverisë maqedonase dhe partive politike shqiptare, nga Shkupi zyrtar u nisën në adresë të Tiranës zyrtare disa akuza për lejim të ardhjes nga Shqipëria të grupeve të armatosura të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare, që vepronte në Maqedoni. Akuzën e bëri ish-ministri i Brendëshëm, Lube Boshkovski i cili më 4 prill deklaroi se një grup prej 50 personash të armatosur dhe të veshur me uniformën e UÇK-së kanë hyrë nga Shqipëria në Maqedoni në zonën e qytetit të Dibrës, kanë kontaktuar njerëz me qëllim rekrutimin dhe mobilizimin e tyre dhe pastaj janë larguar po për në Shqipëri. Mediat maqedonase e amplifikuan edhe më tej akuzën, duke pretenduar se në Shqipëri janë ngritur 14 kampe të stërvitjeve ushtarake për 4500 ushtarë të asaj që quhet UÇK. Krahas kësaj u bë e ditur për dislokime të reja të forcave ushtarake dhe të njesive speciale maqedonase në kufirin me Shqipërinë. Por qeveria e Shqipërisë dhe institucionet e saj, i përgënjeshtroan menjëherë dhe i hodhën poshtë akuzat si për kampet e stërvitjes, ashtu edhe për kalime nga grupe të armatosura të kufirit midis dy vendeve. Por çoroditja e

Shkupit zyrtar shkonte edhe më tej. Më 12 prill 2001, kryeministri i Maqedonisë Lupco Georgievski i kërkonte ndihmë qeverisë shqiptare të ndërhynte pranë partive politike shqiptare në Maqedoni për të pranuar krijimin e një qeverie koalicioni me bazë të gjerë me dy partitë kryesore maqedonase. Ndërsa, po ketë ditë zëdhënësi i qeverisë maqedonase akuzonte Shqiperinë për defektet në regjistrimin e popullsisë në muajin prill që, sipas tij, pengonte gjetjen e numurit të saktë të pjesëtarëve të pakicës maqedonase në Shqipëri. Të njëjtën akuzë, por disa muaj më vonë, kur ishte nënshkruar edhe Marrëveshja e Ohrit, do ta bënte në Tiranë ish-ministri i Mbrojtjes i Maqedonisë, Buçkovski. Ai në prani të ish-ministrit të mbrojtjes së Shqipërisë deklaroi se në veri të Shqipërisë në Kukës dhe Tropojë ka pasur dhe ka kampe që stërvitnin rebelët shqiptarë që luftuan në Maqedoni.

Tirana kërkon plotësimin e lirive dhe të drejtave të shqiptarëve Megjithatë Tirana dhe Shkupi kishin qëndrime diametralisht të kundërta për vlerësimin e rrënjëve të kryengritjes së fundit në Maqedoni. Ndërsa udhëheqja maqedonase ka këmbëgullur gjatë gjithë krizës se ajo që ndodhi në kodrat rreth Tetoves ishte një agresion armatosur i ardhur nga Kosova, udhëheqja e Shqipërisë ka këmbëgullur në vlerësimin se kriza është rezultat i zhvillimeve të brendëshme dhe i problemeve të akumuluar dhe të pazgjydhura drejt nga qeveritë maqedonase në raportet e tyre ndëretnike. Përballë këtyre akuzave, Qeveria Shqiptare mori disa masa. Ajo i kërkoi zyrtarisht NATO-s që të dërgonte misionë në ndihmë për të kontrolluar dhe monitoruar kufirin midis Shqipërisë dhe Maqedonisë, kërkesë e cila u pranua nga Aleanca Atlantike. Përveç kësaj ministri i rendit, ministri i mbrojtjes dhe kryetari i shërbimit informativ kombëtar shqiptar, të tre bashkë me 12 prill 2001 zhvilluan një takim me atashetë ushtarakë të akredituar në Shqipëri për të siguruar komunitetin ndërkombëtar për masat e forta të kontrollit që ka marrë qeveria shqiptare, e cila në përforcim të forcave të policisë kufitare dërgoi në prefekturën e Dibrës mbi 100 forca komando të ushtrisë.

Takimi Milo-Kerim në Peshkopi

Për të treguar se Shqipëria nuk është përzier në konfliktin në Maqedoni, në datën 10 mars 2001 ftohet në Shqipëri ish-ministri i Jashtëm i Maqedonisë Sergjan Kerim. Ai takohet me ish-ministrin Milo në Peshkopi dhe japin këtë deklaratë për shtyp:

«Milo: Qeveria shqiptare respekton sovranitetin dhe teresinë territoriale të Maqedonisë. Denojmë cdo shfaqje të ekstremizmit në dëm të stabilitetit të Maqedonisë dhe kur keto i perkasin nacionalitetit shqiptar, por nuk duhet të inkriminohen të gjithë shqiptarët në Maqedoni, Kosovë dhe Serbinë Jugore, nga disa elementë ekstremistë. Shqipëria si kryesuese e Procesit të Bashkëpunimit të vendeve të Europës Juglindore, konsideron si detyrë të saj të shqetësohet dhe bashkëpunojë me vendet anëtare të Procesit për të përballuar krizat. Sipas Milos takimi u zhvillua në Peshkopi për të dëshmuar një mesazh që duhet të kuptohet në dy anët e kufirit. Jemi dy vende dhe dy popuj miq dhe kështu do të vazhdojmë edhe në të ardhmen. Vija e kufirit që kemi është dhe duhet të jetë vijë e bashkëpunimit dhe miqësisë dhe jo vijë ndarjeje. Po bëjmë përpjekje që këtë vijë ta bëjmë sa më të komunikueshme dhe të kalueshme që, nëmenyrë graduale, të kapërcejmë çdo lloj pengese.

Shkaqet e hezimitit të bashkësisë ndërkombëtare

Tezën mbi eksportimin e kryengritjes nga jashtë disa segmente të bashkësisë ndërkombëtare e kanë mbajtur edhe kur u bë e qartë për të gjithë se rrënjët ishin brenda dhe Maqedonia kishte nevojë për reformacion dhe demokraci reale në vënd të demokracisë selektive. Ky hezitim kishte një arsye: Deri në fillimin e kryengritjes së marsit 2001, Maqedonia trajtohej si oazë paqeje dhe demokracie në Ballkan. Duke u mjaftuar se aty nuk ndodhi luftë siç ndodhi në vëndet e tjera të ish-Jugosllavisë, kjo u quajt e mjaftueshme për bashkësinë ndërkombëtare. Ndërsa shkeljet e lirive dhe të drejtave të shqiptarëve, deri në vrasje shqiptarësh konsideroheshin si pasojë e ekstremizmit shqiptar. Këto segmente e kishin të vështirë të pranonin se kishin gabuar. Vetëm pas Haraçines, u bindën edhe të fundit segmente të politikës ndërkombëtare se në Maqedoni duheshin ndryshuar shumë gjëra, duke filluar që nga Kushtetuta.

Arkitekti i "paqes" Robert Frouik

Marrëveshja e Ohrit në Maqedoni nuk është gjë tjetër veçse projekti në letër i së ardhmes

së shoqërisë dhe shtetit të Maqedonisë. Në hartimin e kësaj Marrëveshjeje historike, dhanë kontributin e tyre bashkësisht ndërkombëtare dhe forcat politike në Maqedoni. Politikanë si Leotar, Pardju, Solana, Xhaferri, Cervenkovski, Ahmeti, Georgievski, Imeri, Trajkovski, Feit, Meta etj, etj, janë ata që sot flasin se si e realizuan apo si ndikuan në këtë Marrëveshje të së ardhmes së Maqedonisë. Por ndodhemi brenda historisë së politikës. Ajo duhet shkruar, analizuar dhe kujtuar me vërtetësinë e kohës kur kanë rrjedhur ngjarjet dhe jo me kujtime “partizanësh” të pas “30 nëntorit 1944” të cilët për të bërë historinë e tyre, detyrohen të neutralizojnë historibërësit e vërtetë.

Roli i Robert Frouik në zgjidhjen e krizës

Duke qënë se e njoh shumë mirë historinë politike të Maqedonisë së vitit 2001 sepse kam qënë pjesëmarrës aktiv i saj, më duhet të pohoj disa të vërteta të lëna pas dorë deri më tani nga shumë syresh që flasin për këtë konflikt dhe për daljen nga ai. Nuk mohoj rolin e asnjë politikani apo diplomati të huaj në daljen me sukses nga kriza. Por, më duhet të pohoj për hir të së vërtetës se një ndër arkitektët e civilizimit të saj ishte Ambasadori amerikan Robert Frouik, përfaqësues i posaçëm i OSBE-së në Maqedoni. Pa frikë tani pas 7 vjetësh analiza më çon në konkluzionin se Vizionari, i cili hodhi themelet e Marrëveshjes së Ohrit, jo në muajin qershor 2001, as në Korrik 2001, as në gusht 2001, por një muaj pas fillimit të kryengritjes, pra në fundmarsin dhe fillimprillin 2001, nuk ka qënë askush nga të sipërpërmendurit. Ka qënë dikush tjetër. Dhe ky dikush tjetër quhet Robert Frouik, ambasadori i OSBE-së në Maqedoni, ish-ambasador i përkohshëm i Ambasadës Amerikane në Shqipëri në vitin 1998.

Nëqoftëse kryengritja në Maqedoni nuk mori përmasat e një përlëshje të përgjakshme ndëretnike, nëqoftëse Brukseli dhe Uashingtoni vlerësuan seriozisht qysh në fillim përmasat e asaj që filloi të ndodhte në Maqedoni në muajin Mars 2001, kjo lidhet më shumë me rolin e Robert Frouikut. Për zgjidhjen e krizës në Maqedoni filloi të flitet seriozisht në muajin maj 2001. Por çfarë ndodhi nga marsi deri në Maj, kjo lihet në harresë. Me dashje apo pa dashje, ata harrojnë analizën e fillesave të kryengritjes, analizën e asaj që u quajt Marrëveshja e Prizrenit dhe analizën e asaj që u quajt “Plani Frouik i Paqes”. Po e argumentoj me disa shembuj që lidhen me rolin e ambasadorit Frouik dhe të një funksionari tjetër amerikan.

“Paçim Fat”

-26 Mars 2001, Kryetari dhe nënkryetari i PDSH-së Xhaferri dhe Thaçi takohen me përfaqësuesin e posaçëm të OSBE-së në Maqedoni, Frouik dhe i kërkojnë civilizim të konfliktit duke plotësuar kërkesat e zvarritura lidhur me të drejtat e shqiptarëve. Takimi midis tyre zhvillohet në pajtueshmëri të plotë të mendimeve dhe pikpamjeve.

-31 Mars 2001, Ish-presidenti Trajkovski nuk pranon ndërmjetësimin e BE. Ai deklaroi se ndaj ekstremistëve shqiptarë nuk do të ketë kurrfarë koncesionesh. Deklarata është bërë në gazetën e britanike “Dejli Telegraf”. Trajkovski theksoi se nxitimi për zgjidhje të ngutshme të problemit në vend do të ishte shumë e rrezikshme dhe se në vend të kësaj ai dëshiron një debat të madh, në të cilin do të merrnin pjesë qytetarët e zakonshëm, liderët politikë dhe udhëheqësit fetarë. Trajkovski hodhi poshtë mundësinë që në bisedimet e përfaqësuesve shqiptarë dhe maqedonas të ndërmjetësojë Bashkimi Evropian, duke thënë se Maqedonia vetë duhet të zgjidhë problemin e saj.

Ndërsa po në këtë datë kryetari i Lidhjes opozitare social-demokrate në Maqedoni, Branko Cervenkovski duke folur për krizën në Maqedoni si dhe për paralajmërimin e mundshëm të negociatave maqedono-shqiptare me ndërmjetësimin ndërkombëtar, ka thënë se nuk duhen negociata dhe as ndryshime kushtetuese. Në vend të kësaj ai ka ofruar

krijimin e një qeverie të koalicionit, e cila do të përbëhej nga të gjitha partitë kryesore politike ku do të hapeshin të gjitha çështjet e diskutueshme. Cervenkovski tha gjithashtu se nuk vjen në konsideratë as federalizimi dhe as konfederalizimi i Maqedonisë, por as ndryshimi i karakterit unitar të vendit.

Sugjerimet e Frouik për Ahmetin

Ndërsa në 9 prill 2001 Ambasadori amerikan Robert Frouik u shpreh në Tiranë se nënshkrimi i Marrëveshjeje mes Maqedonisë dhe BE-së përbën një angazhim të Shkupit zyrtar për të konkretizuar ato nisma që aktualisht kanë mbetur në letër. Vetëm dialogu

mund të evitojë shpërthimin e një dhune të re në Maqedoni, theksoi Frouik. (Në takimin e zhvilluar me Frouik ku merrnin pjesë ish-ambasadori amerikan Limpleht, kryeministri Meta, kam qënë edhe unë i pranishëm. Gjatë darkës, Frouik ishte shumë i kthjellët lidhur me nevojën e dialogut me kryengritësit. Gjatë tërë bisedës, ai nuk i quajti asnjëherë ekstremistë. Ai kërkoi të dinte detaje mbi karakterin e drejtuesve të tyre dhe veçanërisht të Ali Ahmetit. Mbasi i foli se si e kisha njohur Ahmetin në Lucernë të Zvicrës dhe i thashë se ai është një idealist fanatik, ai u shpreh: Interesant, këtë mendim e kam dëgjuar për Ahmetin edhe nga Arbër Xhaferri. Por, vazhdoi Frouik, ata (Kryengritësit) duhet të kenë parasysh se ne nuk mund t'i pranojmë hapur si palë në bisedime, prandaj është shumë e nevojshme një marrëveshje e tyre me partitë politike legale shqiptare në Maqedoni. Atë natë, nuk më shkonte ndër mend se ky njeri i mënçur dhe mik i ngushtë i shqiptarëve kishte në kokë idenë e Marrëveshjes së Prizrenit. E kisha konsideruar të mjaftueshëm takimin midis Ahmetit dhe Xhaferrit në Tiranë, pavarësisht heshtjes së thellë që mbahej rreth tij. Me gjithë heshtjen, ai takimi po i jepte rezultatet, Xhaferri komunikonte me Ahmetin dhe kjo nuk ishte pak po të mendojmë se ishte fillimi i prillit 2001 kur të gjithë ishin kundër rebelëve të UÇK-së dhe kur ata ishin tërhequr nga rrethinat e Tetovës. Për më tepër as nuk më shkonte ndër mend se më vonë këto ide do të kristalizoheshin në Planin “Frouik” në të cilin mora pjesë edhe unë me sugjerime, redaktime dhe shtojca. Ajo që mendova atë natë duke pritur pyetjet e tij dhe komentet që bënte mendova se UÇK-ja e kishte fituar luftën. Tre javë më parë një tjetër funksionar amerikan i rëndësishëm në Shqipëri, pasi kishte dëgjuar shpiegimet lidhur me qëllimet e luftës dhe aleatët e UÇK-së, lëshoi një shprehje: “Paçim Fat”. Nuk tha “paçi fat ju”, as “paç fat ti”, por “Ne”, pra e konsideroi edhe vehten pjesë «tonën». Mund të them që pas darkës, pasi përcolla kryeministrin Meta në rezidencën qeveritare ku ai banonte, nuk shkova në shtëpi, por në zyrë dhe kam folur në telefon me Abazin (Aliun). Pa i treguar detaje, i kam thënë të jetë i qetë se lufta e tij dhe shokëve të tij po gjente gjithmonë e më shumë përkrahje ndërkombëtare veçanërisht përtej oqeanit).

Një muaj e gjysëm pas këtij takimi, Frouik u detyrua të largohej nga Maqedonia si person i padëshiruar. Para se të jap arsyet reale të largimit të ambasadorit Frouik, po jap shkurtimisht njoftimet e agjensive të lajmeve lidhur me largimin e tij nga Maqedonia: 1- Në datën 17 maj 2001, Frouik jep një intervistë në “Zërin e Amerikës” ku thotë se: Krijimi i koalicionit 4-partiak, thotë zoti Frouik, krijon një rrugëdalje për zgjidhjen e krizës në Maqedoni. Ai theksoi punën e madhe që ka bërë komuniteti ndërkombëtar për të bindur palët e përfshira për nevojën e një zgjidhjeje të tillë. Përfaqësuesit ndërkombëtarë, qofshin nga Shtetet e Bashkuara, vendet kryesore të Evropës Perëndimore, OSBE-së, shpjegon zëdhënësi i OSBE-së për Maqedoninë, zhvilluan kontakte të shumta me Partinë për Prosperitet Demokratik, e cila, në pritje të stabilizimit të gjendjes nuk po angazhohej në gjetjen e një rrugëdaljeje. “Mendoj se si rrjedhojë e këtyre kontakteve ata e kuptuan se është në interes të shqiptarëve të Maqedonisë, që ata përfaqësojnë, të bien dakort për një qeveri koalicioni, e cila do të jetë në gjendje të marrë vendime lidhur me reforma që duhen zbatuar, sesa të vazhdonin ta kundërshtonin këtë proces, në një kohë që UÇK-ja vazhdonte luftimet me ushtrinë maqedonase, gjë që nuk mund të kishte rezultate të mira”, tha zoti Frouik. Ai vuri në dukje se të gjitha palët e përfshira në këtë çështje e kuptojnë nevojën e gjetjes së një rrugëdaljeje për të gjitha çështjet që shqiptarët kanë ngritur, përfshirë edhe çështjen e kushtetutës. Ai shpreh optimizëm lidhur me gjasat për ndryshime, por, ai paralajmëron se do të duhet kohë për të arritur në atë pikë.

Ata që larguan ambasadorin e përkohëshëm të SHBA-së Frouik shtuan viktimat Një tjetër çështje që duhet trajtuar pa vonesë, thekson zëdhënësi i OSBE-së për Maqedoninë, është ndalimi i veprimeve të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare: “Pas bisedimeve të 4 majit me Naton, Bashkimin Evropian dhe OSBE-në, unë, tha zoti Frouick, fillova të ushtroj trysni për tërheqjen e UÇK-së. Gjatë javës së kaluar ka pasur diskutime intensive lidhur me alternativat për t'u dhënë fund luftimeve dhe për të mundësuar tërheqjen e UÇK-së. Trajtimi i aspektit ushtarak të krizës ka qënë shumë i rëndësishëm, dhe është zhvilluar paralel me punën e zotit Solana në aspektin politik për organizimin e këtij koalicioni qeveritar. Këto dy aspekte janë jetike në rikthimin e

qëndrueshmërisë në vend si dhe për krijimin e një baze mbi të cilën të zhvillohet një dialog politik i efektshëm”.

Mitreva e konsideron Frouikun si person të padëshirueshëm

1-18 maj 2001: Ambasadori Frouik deklaroi në një konferencë shtypi se tani “nuk jemi duke folur për negociata apo për ndërmjetësime, por për lehtësime dhe besoj se unë do të mund të marrë pjesë në ato lehtësime për të përcjellë mesazhet e përfaqësuesve legjitimë të shqiptarëve”. (Por, Frouik nuk u lejua të merrte pjesë në ato që ai i quante lehtësime ndaj UÇK-së)

2-22 maj 2001 Arbër Xhaferri dhe Imer Imeri udhëtojnë për në Prizren dhe sëbashku me Ahmetin firmosin një marrëveshje historike. Marrëveshja kundërshtohet ashpërsisht, por Imeri dhe veçanërisht Xhaferri nuk pranojnë të heqin dorë nga ajo

3–24 maj 2001: Agjencitë e huaja të lajmeve kanë njoftuar se takimi i liderëve të dy partive politike shqiptare të PDSH-së dhe PPD-së Arbër Xhaferri dhe Ymer Ymeri me përfaqësuesin politik të UÇK-së Ali Ahmeti në Prizren është mbajtur me iniciativën e të dërguarit të posaçëm të OSBE-së për Ballkanin, amerikanit Robert Frouik, i cili ka përvojë të gjatë në Ballkan. Agjencia e lajmeve Rojter u shpreh se Frouik pritet të largohet nga Maqedonia pas këtij hapi i cili u kritikua prej qeverisë dhe komunitetit ndërkombëtar. Burimet diplomatike thanë se iniciativa e Frouikut ishte tepër e dëmshme dhe kërcënon unitetin e një koalicioni të madh qeveritare në Maqedoni. Ndërkohë, sipas njoftimeve të fundit të agjencive të lajmeve Misioni i OSBE-së në Maqedoni pas problemit që pati me të dërguarin e posaçëm të OSBE-së, Robert Frouik siguroi edhe njëherë se vazhdon të mbështesë pozitat e bashkësisë ndërkombëtare që ka në lidhje me bisedimet në Maqedoni. Sipas deklaratës së Misionit të OSBE-së në Maqedoni, shqiptarët e armatosur nuk mund të konsiderohen si partnerë të bisedimeve sepse ata nuk kanë asnjë

lloj statusi ligjor, deklaroi Misioni i OSBE-së në Shkup.

4-25 maj 2001: «I dërguari special i OSBE-së, Robert Frouik është larguar dje nga Maqedonia për shkak të rolit të tij të supozuar në arritjen e një marrëveshjeje për paqe në Maqedoni mes liderëve politikë shqiptarë dhe kryengritësve. Vetë Robert Frouik i kishte refuzuar t'i komentojë pohimet e diplomatëve dhe zyrtarëve se kishte ndërmjetësuar në këtë marrëveshje dhe nga Shkupi ka udhëtuar në Bukuresht që t'i raportojë zyrtarisht ministrit të jashtëm të Rumanisë, kryesuese aktuale e OSBE-së. Një zyrtar i qeverisë në Shkup që nuk ka dashur të identifikohet ka deklaruar se të deleguarit special në rajon i ka thënë se shërbimi i tij nuk nevojitet më në Maqedoni.»

5-26 maj: Ministrja e Jashtëm e Maqedonisë, Mitreva ka deklaruar se Frouik ka shkelur statusin e diplomatit dhe nuk është më person i dëshirueshëm në Maqedoni.

7-31 maj 2001: Arbër Xhaferri, kryetar i Partisë Demokratike Shqiptare të Maqedonisë anëtare e koalicionit qeveritar ka deklaruar se kriza në vend nuk mund të zgjidhet pa bisedime më kryengritësit e UÇK-së, citon agjencia Asosiated Press. “Paqja në Maqedoni nuk varet vetëm nga ne, por gjithashtu edhe nga UÇK-ja”, ka thënë Xhaferri për të shtuar se duhet krijuar një kanal komunikimi me ta.

8-31 maj 2001: Presidenti amerikan Xhorxh Bush cakton ambasadorin Xhejms Pardju në rolin e këshilltarit të tij special të zgjidhjen e krizës në Maqedoni. Robert Frouik ishte më i kthjellët se të tjerët lidhur me qëndrimin që duhej mbajtur ndaj UÇK-së. E gjithë ajo që ndodhi pas largimit të Frouik nga Maqedonia ngjante si një kronikë ngjarjesh të paralajmeruara. Të paralajmeruar në veprimtarinë konkrete të ambasadorit Frouik si në kontakte bilaterale apo multilaterale, aq edhe në deklarime zyrtare. Kjo ka disa arsye që lidhen me kthjelltësinë e Frouik dhe njohjen shumë të mirë të problemeve rajonale.

Paradoksi i kryengritjes së UÇK-së: Armë për demokraci

-E para: Duke studjuar programin politik të Ali Ahmetit dhe të UÇK-së, i cili ishte më i moderuar se ai i çdo partie politike shqiptare në Maqedoni, Frouik kuptoi i pari “paradoksin” e Kryengritjes së shqiptarëve. Kontradiktën midis “kallashnikovit” dhe një programi politik që në kushte normale mund dhe duhej të realizohej pa armë. Pra, ai kuptoi se ata që drejtonin UÇK-në nuk ishin një grusht trafikantësh apo kriminelësh, po një grusht idealistësh fanatikë, që armët i kishin marrë nga halli dhe jo nga dëshira, sepse ata e kishin të ndaluar të hynin në Maqedoni, sepse kishin qënë të ndjekur dhe të dënuar

nga Jugosllavia e Titos, por nuk ishin amnistuar as në vitin 1991 nga qeveria e Kiro Gligorovit dhe Branko Cervenkovskit dhe as në vitin 1998 kur erdhi në pushtet Lupço Georgievski. Kësisoj ai ishte i pari që ra dakord me nevojën e amnistisë për luftëtarët e UÇK-së. (Në vazhdim do të jap disa detaje se si edhe ish-sekretari i përgjithshëm i NATO-s Robertson, ra dakord me një gjë të tillë)

Frouik: Ali Ahmeti, duhet të zgjedhesh paqen me drejtësi

-E dyta: Frouik ishte i pari që formuloi planin e paqes dhe te armëpushimit duke i hapur rrugë bisedimeve me UCK-në. Të gjithë ata te cilët kanë qënë në dijeni të fillësës dhe vazhdimit të kryengritjes në Maqedoni si Arbër Xhaferri, Veton Surroi, Menduh Thaci, Ali Ahmeti, Gëzim Ostreni, Ilir Meta, Agim Çeku, Ramush Haradinaj, etj., e dinë fare mire se embrioni i asaj që u quajt "Marrëveshja e Ohrit", aneksi ushtarak i saj që kishte të bënte me çmilitarizimin e UÇK-së, mbi integrimin e saj në jetën politike, sociale dhe ekonomike të vendit, mbi nevojën e amnistisë etj, u formulua në Shkup gjatë fundprillit dhe fillimin e majit 2001 nga ambasadori Frouik me ndihmën e disa të tjerëve nga Tirana, Tetova dhe Prishtina.

Kjo u bë e qartë nga vetë Frouik në datën 18 maj 2001 në një konferencë me gazetarë në Shkup. Në këtë Konferencë ai bën të qartë skeletin e Planit të daljes nga Kriza. Ky skelet u përdor më vonë nga Trajkovski, Badinter, Pardju dhe Leotar në formulimin e marrëveshjes së Ohrit.

Ja se çfarë tha Frouik

"Kam qenë i angazhuar në konsultime intensive gjatë kësaj jave me liderin e PDSH-së, Arbën Xhaferi, me liderin e PPD-së, Imer Imeri, me liderët e partive kosovare Rugova, Thaçi dhe Haradinaj, por gjithashtu edhe me gjeneralin Çeku dhe kryeministrin e Shqipërisë, Meta, me synim për të ndalur luftën e armatosur.

Të gjithë më thanë se pajtohen me këtë pikësynim. Koalicioni i ri qeveritar bashkë me shqiptarët etnik me ndikim të fuqishëm dhe paprecedent duhet patjetër t'i japë rast intensifikimit të dialogut politik me reforma si synim i tij. Jam thellë i bindur se shumica e popullatës së IRJM-së duan t'i japin fund armiqësive të fundit të armatosura dhe të zgjidhin problemet e brendshme në mënyrë paqësore. Kryetari Trajkovski këtë javë ka treguar leadership për lëvdëratë duke folur për mundësinë që qytetarët të mbahen bashkë dhe t'u shmangen luftimeve të tipit ndërëtnik, ndodhi të cilat në vendet e ish-Jugosllavisë shkaktuan tragjedi të mëdha. Komuniteti ndërëkombëtar është bashkuar fuqishëm dhe i japin mbështetje jashtëzakonisht të unifikuar dialogut politik të koalicionit të ri qeveritar. OSBE-ja duke punuar për së afërmi me BE-në dhe me NATO-n është e bindur se ky dialog me të vërtetë mund të arrihet me format e nevojshme të forcimit të bashkimit të vendit dhe krijimin e një ardhmërie më të mirë për të gjithë. Ky është një rast i artë dhe nuk guxon të lëshohet. Megjithatë udhëheqësit e UÇK-së e bëjnë të pamundur këtë kërkim të paqes me drejtësi, ata flasin për mbështetjen e reformave politike, por me këmbëngulësi refuzojnë të tërhiqen nga konfrontimi i armatosur. Më lejoni të përcjell një porosi deri te Ali Ahmeti: UÇK-ja duhet të zgjedhë tani në këtë moment kthyes në mes të rrugës drejt paqes me drejtësi ose të rrugës drejt eskalimit të luftës. Vetëm duke zgjedhur paqen dhe duke shkuar drejt caqeve nëpërmjet dialogut politik mund të hapen dyert e progresit. UÇK duhet t'i lëshojë armët, ata të cilët janë nga Kosova të tërhiqen, të kthehen prapa, kurse të gjithë qytetarët e Maqedonisë që nuk kanë kryer ndonjë kriminalitet besoj se do të mund të integrohen në procese dhe në bazë të bisedave që i kam zhvilluar me politikanët, mund të them se do të ketë amnisti për të njëjtit.

Pas një akti të tillë mund të fillojë procesi i integritit të atyre qytetarëve në sistem. Unë, nuk kam pasur kontakt të drejtpërdrejt me Ali Ahmetin apo UÇK-në, mirëpo të gjitha bisedat që i kam zhvilluar me përfaqësuesit politikë të shqiptarëve, qofshin nga Tirana, Maqedonia apo edhe Kosova japin sinjale se së pari duhet t'i mundësohet Qeverisë së re të tregojë se çfarë mund të bëjë, e kjo do të jetë e përcjellur me ndërprerje të zjarrit.

Pas kësaj pason lëshimi i armëve dhe tërheqja e tyre në Kosovë. Kuptohet këtu duhet kyçur edhe faktori ndërëkombëtar, i cili popullatës lokale do t'i ndihmojë. Kurse në ato vende siç është rasti i Kumanovës, policia në radhët e veta do të ketë përfaqësues edhe të shqiptarëve. Sa i përket Ali Ahmetit, inkuadrimit të tij në dialogun politik, duhet të vendosin përfaqësuesit legjitim të këtij shteti, mirëpo unë nuk besoj se një njeri i cili

është i ndjekur të mund të kyçet në një proces të atillë. Nuk flasim as për negociata e as për bisedime, flasim për lehtësime dhe besoj se unë do ta kem rolin e lehtësuesit. Mirëpo këto janë vetëm ide për të cilat ende nuk është marë qëndrim konkret. Pas mbarimit të luftës në Kosovë u paraqitën organizata të cilët vepronin pa ndonjë strukturë komanduese. Besoj se Ali Ahmeti është ai që do të mund të ndikoj që të lëshohen armët. Mendoj, se axhenda e propozuar është e kapshme për të gjithë qytetarët e Maqedonisë". Një ditë pas Konferencës së shtypit të Robert Frouik, Ali Ahmeti ju dërgon një letër publike Anan, Robertson, Prodi dhe Xhoana ku sqaron pse i kemi marrë armët. Ndërsa, tre ditë më vonë Arbër Xhaferri dhe Imer Imeri do të udhëtonin për në Prizren për të nënshkruar Marrëveshjen me Ali Ahmetin.

Domosdoshmëria e takimit Xhaferri-Imeri-Ahmeti

Frouik i parapriu Marrëveshjes së Prizrenit midis Ahmetit, Xhaferrit dhe Imerit.

Marrëveshja e Prizrenit nuk u prit aspak mirë as nga politika e Maqedonisë dhe as nga ajo Perëndimore. U krijua ideja dhe u propagandua se Xhaferri dhe Imeri kapitulluan para Ali Ahmetit. Por ishte e kundërta që Ali Ahmeti pranoi rolin e faktorit politik legal shqiptar në zgjidhjen e konfliktit. Pra ishte fitore e moderacionit mbi rrugën e konfliktit. Nuk ishte ashpërsimi i konfliktit, por civilizimi i tij. Dhe një ndër inisatorët e kësaj Marrëveshjeje ishte vizionari Frouik. Ndërsa zhurma që u bë pas kësaj marrëveshjeje nuk ishte gjë tjetër veçse moskuptimi i realitetit që ekzistonte në Maqedoni në atë periudhë, apo edhe xhelozia ndaj Frouikut apo edhe rivaliteti midis SHBA dhe BE. Bashkimi Evropian deri në atë periudhë duke pasur si përfaqësues të saj ambasadorin anglez Dikinson nuk donte të pranonte realitetin e Maqedonisë, prandaj u treguar edhe më e ashper ndaj ambasadorit Frouik dhe planit të tij.

Ambasadori Frouik u largua si i padëshirueshëm nga Maqedonia. Por aty mbeti Plani i tij. Pas disa ditësh do të dilte përfaqësuesi politik i NATO-s, Hans Jorg Ajf, që do të pranonte se ishte takuar me UÇK-në, pra atë që kishte kërkuar Frouik. Më vonë do të dilte ish-Presidenti Trajkovski me një Platformë që u mbështet edhe nga konstitucionalisti francez Robert Badinter. Dhe pastaj do të ishte përfaqësuesi i NATO-s Piter Fejt që do të nënshkruante me UÇK-në, marrëveshjen e çmilitarizimit të saj. Dhe në fund do të ishte formulimi dhe nënshkrimi i Marrëveshjes së Ohrit që do ti jepte fund konfliktit në Maqedoni. Por të gjitha këto në embrion dhe skelet u formuluan nga Ambasadori Amerikan, Robert Frouik.

Dëbohet Frouik për lidhje me rebelët, NATO takohet me Ali Ahmetin

Zyra e shtypit e NATO-s në Shkup në datën 28 maj 2001 deklaroi se ambasadori i NATO-s, Hans Jorg Ajf konfirmoi takimin e tij në Prizren me liderin politik të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare Ali Ahmetin. Takimi ishte realizuar në datën 16 maj, gjashtë ditë para se të nënshkruhej Marrëveshja e Prizrenit dhe dy ditë para se Frouik të dilte në Konferencë shtypi. Një ditë më vonë ambasadori jep një intervistë të gjatë në Dojçe Éelle. Ai u intervistuar nga Adelheid Feilcke-Tiemann

Zoti ambasador, dje u bë i njohur lajmi, që ju jeni takuar me përfaqësues të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare që para iniciativës së ambasadorit Froëick. A ka të vërtetë në këtë lajm?

Takimi im me Ali Ahmetin, njeriun që paraqitet si përfaqësues politik i UÇK-së nuk ka të bëjë fare me atë që u ndërmorr nga Bob Froëick. Është detyra ime që të shpjegoj këtu politikën e NATO-s dhe kjo vlen para së gjithash në ato raste ku është e nevojshme dhe e rëndësishme që të shmangen iluzione eventuale, të cilat ekzistojnë në forma të ndryshme përsa i përket politikës së NATO-s.

Konkretisht, cili ishte mesazhi që ju i dhatë zotit Ahmeti?

Unë i thashë atij se UÇK-ja duhet të heqë dorë nga përdorimi i armëve dhe të ndalojë gjakderdhjen. Natoja do të mbështesë vetëm dialogun paqësor, të përfaqësuesve legjitimë demokratikë të vendit dhe se ajo nuk do ta njohë UÇK-në si partnere bisedimesh. Biseda konsistoi në përcjelljen e këtij mesazhi nga unë.

Këtij pozicioni i mbeteni edhe tani?

Ky pozicion nuk ka nevojë për përtëritje, në momentet e tanishme të paktën, jo.

A e mbështesni ju idenë e përfshirjes së UÇK-së në bisedime, siç e kërkonte deklarata e nënshkruar midis partive politike shqiptare dhe UÇK-së?

Unë nuk e konsideroj të drejtë këtë, nuk e konsideroj as të nevojshme dhe kjo nuk është politika e NATO-s.

Cili është roli i NATO-s në aspektin e garantimit të paqes në Maqedoni?

Ju e dini që detyra parësore e NATO-s është në Kosovë. Në Maqedoni ajo ka vendosur trupa, të cilat ofrojnë mbështetje logjistike për trupat e Kosovës. Natyrisht, ne kemi marrëdhënie shumë të ngushta me Maqedoninë dhe duhet ta shohim rajonin si një të tërë. Në kuadrin e misionit tonë në Kosovë, për të krijuar një mjedis të sigurt, ne mbrojmë edhe kontrollojmë edhe kufirin mes Kosovës dhe Maqedonisë. Është një pjesë e mirë e kufirit në Maqedoninë Veriore dhe këtu ne i kemi forcuar shumë kontrollet tona. Pyetja që shtrohet tani është nëse mund të kontribuohet më tepër për zgjidhjen e konfliktit të iniciuar nga UÇK-ja. Ka mundësira, për të cilat në duhet të flasim me palën maqedonase. A bëhet fjalë këtu edhe për ndihmë në armë për Maqedoninë? Ka njerëz që thonë se ushtria maqedonase i mbaroi municionet e saj që ditën e parë të luftimeve në Tetovë.... Këtu nuk bëhet fjalë për ndihmë me armë, por bëhet fjalë nëse mund të arrihet një marrëveshje për të ngritur, siç kishim në Serbi një ground safety zonë, një zonë sigurie si në Serbi, që tani u kthye nën kontrollin e Serbisë. Pra, nëse mund të përdoret edhe në Maqedoni ky shembull. Atje NATO-ja u tregua e gatshme të pranonte për një periudhë të caktuar njerëz të UÇPMB-së nëse i dorëzonin armët dhe deri në nxjerrjen e amnistisë. Duhet menduar nëse ne mund të ofrojmë një ndihmë përkatëse, përse i përket Maqedonisë, që do të konsistonte në atë, që njerëzit e përfshirë në veprimet luftarake, njerëz të UÇK-së ose civilë të prekur, pra që këta njerëz të lihen të hyjnë në Kosovë, ku ata të dorëzojnë armët.

Ju përmendet fjalën amnisti, njerëzit duhet të integrohen disi në jetë, nëse ata shkojnë në Kosovë, kjo nuk do të ndihmonte në plan afatgjatë....

Jo, kjo nuk do të ndihmonte, të gjithë ata që janë shtetas maqedonas mund të ktheheshin në çdo kohë këtu. Si p.sh. njerëzit e fshatrave të Tetovës, që kthehen sapo gjendja është qetësuar. Për aq kohë sa janë shtetas maqedonas, ata duhet ta bëjnë këtë në çdo kohë. Është shtruar propozimi për ta bërë Maqedoninë protektorat ndërkombëtar, ç'mund të na thoni për këtë?

Unë e kam të qartë se çfarë mund të përfytyrojnë intelektualët, por nga ana politike, kjo nuk është relevante. Bashkësia ndërkombëtare është përfaqësuar fort këtu, dhe e shoh veten si

mbështetje. As që diskutohet që këtu të ngrihet diçka si në Kosovë, kjo nuk është e nevojshme. Ne nuk jemi protektorë, do të ishte shumë e gabuar nëse do të përpiqeshim ta bënim këtë.

Zoti ambasador, cila është këshilla juaj për njerëzit e rajonit në këtë situatë?

Ata duhet të drejtohen tek të tjerët, ata nuk duhet të tërhiqen brenda në vetë. Ata duhet të shohin se si mund t'i kapërcejnë paragjykimet. Kjo është shumë e rëndësishme se në këto kohë, mosbesimi është shumë i madh. Nuk duhet të vijë puna deri aty, sa njerëzve të grupit të popullatës tjetër, që më parë i ke quajtur shokë, tani t'u bësh bisht.

Të fshehtat e Marrëveshjes së Prizrenit

Çfarë përmbante dokumenti i firmosur nga Ahmeti, Xhaferri dhe Imeri

Marrëveshja e Prizrenit e realizuar në 22 maj 2001 midis Arbër Xhaferrit, Imer Imerit dhe Ali Ahmetit ka qenë një ndër veprimet më të pjekura dhe më të mençura të politikës shqiptare në Tetovë, Prishtinë dhe Tiranë. Qeveria shqiptare dhe institucionet e saj e morën vesh këtë marrëveshje vetëm pasi u bë zhurma rreth saj. Kishte disa arsye për këtë. Shqipëria ndodhej në prag të zgjedhjeve të 24 qershorit. Kryeministri Meta kishte qenë në Amerikë dhe ishte takuar papritur edhe me Presidentin Bush. (Dosja Maqedoni ka qenë shkaku kryesor i takimit, pavarësisht spekulimeve me lobin grekoamerikan). Kisha dijeni për një takim të ardhshëm midis Ahmetit, Xhaferrit dhe Imerit, veçanërisht pasi Frouik doli në Konferencë shtypi në Shkup. Në datën 22 maj 2001 më mori në telefon Arbër Xhaferri dhe me tha se kishte kaluar Hanin e Elezit që është pika e kalimit midis Kosovës dhe Maqedonisë. Njëkohësisht më tha se po shkonin tek vendi (Tek Ali Ahmeti). Për shkak të përgjimit të telefonave për gjëra shumë të rëndësishme nuk flisnim hapur. Nuk e

njoftova kryeministrin Meta në atë moment. Prita sa të nënshkruhej Marrëveshja dhe e njoftova vonë në darkë. (Në atë periudhë kishte filluar edhe lufta politike brenda PS lidhur me postin e kryeministrit në rast fitoreje të PS. Me insistimin e Nanos kishte shpallur kandidaturën për kryeministër edhe Arben Malaj). Grindjet midis Metës dhe Nanos krijonin vështirësi për PSSH. Por mua më krijonin lehtësi për t'u marrë më shumë me Maqedoninë. Meta me pyeti se çfarë do të thotë një gjë e tillë dhe unë i thashë për ta qetësuar dhe për të mos e zgjatur se për këtë ka dijeni edhe Robert Frouik. Nuk foli më. Ai paraprakisht kishte rënë dakord me Frouik për unifikimin e faktorit shqiptar në Maqedoni.

Më poshtë do të flas për zhurmën e madhe që u bë rreth kësaj marrëveshjeje. Por në fillim po bëj të ditur se çfarë përmbante marrëveshja e firmosur nga Ahmeti, Xhaferri dhe Imeri.

Konsensus për rrugën e daljes nga kriza

Deklaratë për procesin paqësor e reformues në Republikën e Maqedonisë e nënshkruar nga Arben Xhaferi, Ali Ahmeti dhe Ymer Ymeri. Tre liderët shqiptarë të Maqedonisë - i Partisë Demokratike Shqiptare, i Prosperitetit Demokratik dhe përfaqësuesi politik i UÇK-së, nënshkruan të martën, diku në Prizren, një Deklaratë lidhur me procesin paqësor e reformues në Republikën e Maqedonisë.

Teksti i saj: «Liderët shqiptarë të Maqedonisë, të vetëdijshëm për momentin historik nëpër të cilin po kalon Republika e Maqedonisë, dakordohen për veprim të përbashkët mbi pikat e një konsensusi të gjerë kombëtar dhe shoqëror, i cili duhet ta reformojë Republikën e Maqedonisë në mënyrë që të jetë shtet demokratik i të gjithë qytetarëve dhe i të gjithë bashkësive kombëtare. Konsensusi i arritur në mes liderëve shqiptarë mbështetet mbi këto pozicione parimore:

- njohjen e faktit se reformat për të cilat angazhohen shqiptarët kanë qëllim ruajtjen e integritetit dhe karakterit multi-etnik të Maqedonisë,
- njohjen se nuk ka zgjidhje "etnike territoriale" për problemet në Republikën e Maqedonisë dhe se çdo përpjekje për të "copëtuar etnikisht" territoret u sjell dëm vetë qytetarëve të Maqedonisë dhe paqes në rajon;
- njohjen se nuk ka zgjidhje ushtarake për problemet në RM;
- njohjen se procesi i transformimit të RM duhet të shkojë vetëm drejt integriteteve euroatlantike;
- njohjen se zgjidhja do të gjendet brenda një procesi vendor politik me lehtësimin e SHBA-ve dhe BE-së.

Në bazë të këtyre parimeve, liderët shqiptarë të Maqedonisë janë të vendosur që të marrin pjesë në procesin e dialogut reformist, duke i trajtuar këto çështje: amandamentet në Kushtetutën e Maqedonisë; përdorimi i papenguar i gjuhës shqipe, si njëri prej gjuhëve zyrtare të Maqedonisë; përfaqësimi përpjesëtimor etnik në institucionet e shtetit; zgjerimi i kompetencave të pushtetit komunal; sekularizimi i plotë i Kushtetutës, d.m.th. shtetit, vendosja e demokracisë koncensuale në çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat kombëtare,

d.m.th. kufizimi i procesit të mbivotimit në fushat që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me të drejtat etnike, e drejta për komunikim të lirë e të papenguar në hapësirën kulturore shqiptare. Gjithashtu branda këtij debati janë masat për transformimin e jetës së anëtarëve të UÇK-së në forma të ndryshme profesionale civile, duke përfshirë edhe ato brenda institucioneve qeveritare. Brenda këtij debati, një vëmendje e veçantë do të jetë mbi: rehabilitimin dhe resocializimin e plotë të gjithë pjesëtarëve të UÇK-së; rindërtimin e fshatrave dhe ekonomive familjare të shkatërruara gjatë luftimeve si dhe përkujdesjen ndaj viktimave të luftës (individët e luftës, familjet e të vrarëve, bonjakët etj.); kryerjen e shërbimit ushtarak në ARM brenda komunës së lindjes. Në dialog, i cili do të zhvillohet brenda tryezës së rrumbullakët të liderëve të koalicionit të tashëm qeveritar, duke u kryesuar nga kryetari i Republikës e me lehtësim të SHBA-ve dhe BE-së, do të krijohet forma koncensuale e pjesëmarrjes së faktorit politik shqiptar»,
Prizren me 22 maj 2001.

Firmosur nga Arben Xhaferi, kryetar i PDSH-së, Ali Ahmeti, përfaqësues politik i UÇK-së dhe Ymer Ymeri, kryetar i PPD-së.

Megjithse prisja nga çasti në çast se kur do të fillonte rrebeshi politik kundër Marrëveshjes së Prizrenit që e vuri në vështirësi të madhe bashkësinë ndërkombetare, nuk e mendoja se ai do të ishte i përmasave që pasuan. (Në atë periudhë ishte krijuar edhe qeveria e koalicionit të gjerë në Maqedoni dhe dy kryetarë partish pjesëmarrës në koalicion firmosnin me Ali Ahmetin një marrëveshje politike). Por para se të jap në mënyrë kronologjike furtunën politiko-diplomatike që pasoi nënshkrimin e Marrëveshjes së Prizrenit, po bëj një parantezë. (Takimi i Prizrenit është zhvilluar vetëm tre ditë pasi Ambasadori i OSBE në Maqedoni, Robert Frouik bëri të ditur Planin e tij të Paqes me UÇK-në. (Për disa ditë rresht, kishim shkëmbyer mendime nëpërmjet faksit me Arbër Xhaferrin për hartimin e këtij Plani. (Arbëri me dërgonte në gjuhen shqipe se çfarë përmbante plani, unë bëja sugjerimet e mija dhe ja ktheja përsëri me faks. Ai ja përktente anglisht Froëickut dhe në këtë mënyrë vazhduam për disa orë deri sa teksti mori formë të plotë).

Deklarata me e egër ishte ajo e BE-së e dhënë nëpërmjet ish-ambasadorit britanik Dikinson në Shkup me titull:

E ashtuquajtura UÇK të harrojë se mund të ketë përkrahje ndërkombëtare.

“Kjo është deklaratë e dhënë nga kryesia e Unionit Evropian në Shkup, në interes të shteteve anëtare dhe Komisionit të BE-së. Do të merrni deklaratë të ngjashme nga një numër i shteteve, duke përfshirë edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Nëse dikush ka ndonjë iluzion se e ashtuquajtura UÇK ka përkrahjen ndërkombëtare kudo, le ta harrojë atë. Konsiderojmë, thuhet më tej, se marrëveshja e përbashkët ndërmjet përfaqësuesve të PPD-së, PDSH-së dhe të ashtuquajturës UÇK, është totalisht e papranueshme. Siç është bërë e qartë nga Bashkimi Evropian dhe shteteve anëtare të saj, nuk ka vend në tavolinën e bisedimeve për të ashtuquajturën UÇK ose për përfaqësuesit e saj politik. Kjo është një demokraci parlamentare. Të gjithë qytetarët janë të përfaqësuar nga përfaqësuesit e zgjedhur në mënyrë legjitime. Janë ata të cilët duhet të bisedojnë, edhe atë në interes të votuesve të tyre, e jo në interes të ekstremistëve të armatosur. Nëse njerëzit e dhunës kanë veto mbi atë se çfarë përfaqësuesit legjitim janë të lejuar të dakordohen, atëherë ajo është krejtësisht e papranueshme. E dyta, platforma e përfshirë në dokument përmban disa elemente, të cilat vetvetiu janë të papranueshme për komunitetin ndërkombëtar. Partitë politike janë dakorduar në një agjendë për dialog. Kjo përfshin shtet qytetar e jo të ndërtuar në bazë të të drejta kolektive. Kjo është mënyra evropiane. Dhe fundamentalja është se nuk ka premtim nga e ashtuquajtura UÇK për tërheqje të menjëhershme dhe çarmatim. Kjo është ajo që është e nevojshme që të mirëmbahet paqja në këtë shtet. Po të mos tërhiqen dhe të mos kthehen për ta penguar paqen në këtë shtet, komuniteti ndërkombëtar mund vetëm të konkludojë se ata nuk janë të interesuar në progres politik. Na lejoni që të ashtuquajturës UÇK t’ia përsërisim edhe njëherë: Nuk ka vend përju në tavolinën e bisedimeve. Nëse ndonjëherë keni pasur dyshim rreth porosive të komunitetit ndërkombëtar, nuk duhet të keni më tani. Dhe porosia fundamentale është e thjeshtë: « Shkoni tani »

Kishte më shumë diplomaci dhe finesë deklarata e ambasadës së SHBA. Ajo nuk ishte deklaratë me vehte, por mbështeste atë që ishte thënë nga BE. Ndërsa, po kjo deklaratë, përdori për herë të parë termin kryengritës në vend të termave, rebelë apo ekstremistë. Ja deklarata e ambasadës së SHBA:

Mbështetet qëndrimi i BE, ndërsa UÇK quhet grup kryengritës

«Në emër të Qeverisë amerikane i shprehim përkrahje të plotë të deklaratës së Kryesisë së Unionit Evropian në Shkup, dhe edhe një herë hedhim poshtë çfarëdo tentimi që të inkuadrohet e ashtuquajtura UÇK në procesin negociator. E papranueshme është deklarata e përbashkët të përfaqësuesve të PPD-së, PDSH-së dhe të ashtuquajturës UÇK, si dhe çdo tentim që ky grup kryengritës të kyçet në strukturat shtetërore. Këshillojmë PPD-në dhe PDSH-në të heqin dorë nga ky dokument dhe të tregojnë angazhim të sinqertë në dialogun legjitim politik që po zhvillohet. Edhe më tej i përkrahim aksionet e Qeverisë maqedonase për zgjedhjen e krizës. Apelojmë te të gjithë qytetarët e Maqedonisë të tregojnë përmbajtje dhe kategorikisht ta hedhin poshtë përdorimin e forcës dhe dhunës për arritjen e qëllimeve politike. Dhunës dhe grupeve të dhunës nuk duhet t’u bëhet kurrfarë lëshimi”

Thelbi I Marrëveshjes së Prizrenit

Marrëveshja e Prizrenit e arritur me firmat e Ali Ahmetit, Arbër Xhaferrit dhe Imer Imerit me ndihmën e vizionarit Frouik dhe e kundërshtuar në fillim nga bashkësia ndërkombëtare, nuk ishte gjë tjetër veçse ndërtimi i politikës ndërshqiptare mbi vizionet e së ardhmes dhe jo mbi kujtimet e së shkuarës. është kjo arsyeja që presionit të madh të ushtruar mbi Arbër Xhaferrin për të dorëhequr firmën e tij nga kjo Marrëveshje, ai ju përgjigj se «unë jam gati të jap dorëheqjen nga posti i kryetarit të partisë, por asesi të dorëheq firmën nga Prizreni». Prizreni nuk ishte pajtimi dhe rehabilitimi i luftës, por shumë më tepër. Prizreni politik ishte rehabilitimi i vlerave europiane dhe demokratike, ishte civilizimi i konfliktit, ishte filizi i asaj që do vinte më pas, që do quhej Marrëveshje e Ohrit dhe akoma më shumë parathënia e asaj që është sot, arritja në menyrë demokratike e ish-UÇK-së ose Bashkimit Demokratik për Integrim. Pas luftës dhe në fillim të paqes, në Bashkimin Demokratik të Ali Ahmetit, u antarsuan shumë të tjerë, disa prej të cilëve figura të njohura në Maqedoni. Në 15 Shtator 2002 në pjesën shqiptare fitoi “Prizreni politik”. Dhe në këtë fitore vlerat demokratike europiane të Arbër Xhaferrit kanë pjesën e tyre të pafshirshme dot nga kurrkush, veçanërisht nga ata që pasi janë të pazotë të përballojnë luftën apo problemet e saj, kanë si aftësi të shkruajnë kujtimet e saj sipas interesit të tyre.

Buçkovski: Përfaqësues si Ahmetit duhet të jenë jashtë loje

Për nënshkrimin e marrëveshjes së Prizrenit reagoi edhe ish-ministri i Mbrojtjes dhe më vonë kryeministër i Maqedonisë dhe partner i Ali Ahmetit, Vllado Buçkovski: Në deklaratën që bëri pas mbledhjes së Këshillit të Sigurimit të Maqedonisë, ku nuk kishte asnjë shqiptar, ai u shpreh se: «Është mjaft e papranueshme përmbajtja e dokumentit. Kjo është një gjë, ndërsa tjetër është ajo se thuhet parimi që tanimë e promovoi bashkësia ndërkombëtare, se me terroristët as nuk bisedohet, as nuk negocohet. Në vend që të izoloheh terroristët, u bë e kundërta, erdhi deri te izolimi politik i përfaqësuesve legjitim të shqiptarëve. Bashkësia ndërkombëtare gjithashtu është e hutuar. Për këtë arsye edhe përfaqësuesit e saj marrin pjesë në mbledhje, që ta konfirmojnë qëndrimin që e dëgjuam disa javë më parë, se me terroristët nuk guxon kush të bisedojë. Ky është moment i ri dhe mendoj se duhet të kthehemi në pozitën fillestare dhe të përtërihet dialogu me përfaqësuesit legjitimë të shqiptarëve. E ashtuquajtura UÇK dhe përfaqësuesit politik të tipit të Ali Ahmetit duhen të jetë jashtë lojës. Liderët politik duhet të distancohen nga Ahmeti, ndërsa shqiptarët nga terroristet

Takimi midis Ahmetit, Xhaferrit dhe Imerit është mbajtur me ndërmjetësimin e OSBE-së Agjencitë e huaja të lajmeve I bënë shumë jehonë Marrëveshjes së Prizrenit. Ato njoftuan se takimi i liderëve të dy partive politike shqiptare të PDSH-së dhe PPD-së Arbër Xhaferrit dhe Ymer Ymeri me përfaqësuesin politik të UÇK-së Ali Ahmeti në Prizren është mbajtur me iniciativën e të dërguarit të posaçëm të OSBE-së për Ballkanin, amerikanit Robert Frouik, i cili ka përvojë të gjatë në Ballkan. Agjencia e lajmeve Rojter në 23 maj 2001, njofton se Frouik pritet të largohet nga Maqedonia pas këtij hapi i cili u kritikua prej qeverisë dhe komunitetit ndërkombëtar. Burimet diplomatike thanë se iniciativa e Frouikut ishte tepër e dëmshme dhe kërcënon unitetin e një koalicioni të madh qeveritare në Maqedoni. Ndërkohë sipas njoftimeve të fundit të agjencive të lajmeve Misioni i OSBE-së në Maqedoni pas problemit që pati me të dërguarin e posaçëm të OSBE-së, Robert Frouik siguroi edhe njëherë se vazhdon të mbështesë pozitën e bashkësisë ndërkombëtare që ka në lidhje me bisedimet në Maqedoni.

Edhe Gjermania e hedh poshtë Marrëveshjen e Prizrenit

Ministria e Jashtme gjermane e ka shprehur dje shqetësimin për gjallërimin e luftimeve në Maqedoni që nisi sërisht në rrethinën e Tetovës. Ministri i jashtëm gjerman, Joscha Fisher deklaroi se e dënon në mënyrën më të ashpër përdorimin e dhunës, siç tha, prej "ekstremistëve etnikë shqiptarë".

“Ne hedhim poshtë marrëveshjen e datës 22 maj ndërmjet partive të moderuara shqiptare të Maqedonisë: PDSH-së dhe PPD-së dhe të ashtuquajturës UÇK. Kjo marrëveshje është në kundërshtim me detyrimet e bashkësisë ndërkombëtare. Përdorimi i dhunës si mjet për të arritur qëllimet politike sikurse praktikohet prej UÇK-së, nuk është i pranueshëm. Prandaj UÇK-ja nuk mund të pranohet si partner i barabartë në procesin politik”, thuhet

në deklaratën e ministrit gjerman të punëve të jashtme Joshka Fisher. Në këtë deklaratë përsëritet mëtej mbështetja e qeverisë gjermane për integritetin territorial të Maqedonisë dhe për qeverinë e legjitimuar demokratike në këtë vend. Në të kërkohet vazhdimi i shpejt dhe me synim i dialogut politik të shoqëruar nga përfaqësuesi i lartë i Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë të Bashkimit Evropian, Javier Solana. Trajkovski kërkon që Xhaferri dhe Imeri të distancohen nga marrëveshja e Prizrenit Presidenti maqedonas Boris Trajkovski ka kërkuar nga liderët e partive politike shqiptare që të distancohen nga marrëveshja që kanë arritur me liderët e kryengritësve shqiptarë, duke thënë se po të mos e bëjnë këtë, do të jetë e pamundur të punohet së bashku. Politikanë shqiptarë kanë thënë se është ofensiva e armatës maqedonase ajo që mund të rrezikojë prishjen e koalicionit. Ndërkaq zyrtarë të lartë perëndimor në Shkup janë thëlluar në bisedime për të shpëtuar qeverinë e koalicionit të gjerë të Maqedonisë, duke u bërë presion partive politike shqiptare që të revokojnë marrëveshjen. BE-ja, NATO-ja dhe SHBA-të iu bashkuan qeverisë së Maqedonisë në refuzimin e marrëveshjes të arritur midis politikanëve shqiptarë anëtarë të koalicionit qeveritarë dhe liderë të kryengritësve shqiptarë.

Arbër Xhaferri: Unë jap doreheqje nga Partia, por jo nga Prizreni
Ne vajtëm fizikisht tek Ali Ahmeti, ndërsa ai erdhi politikisht te ne, prandaj nuk e dorëheq firmën që kam vënë mbi Marrëveshjen e Prizrenit. Unë jam gati të jap dorëheqjen nga Kryetar i partisë, por kurrsesi nga Prizreni...

(Nga deklarata e Arbër Xhaferrit dy ditë pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Prizrenit, kur ambasadori amerikan Ajnik, ambasadori anglez Dikinson dhe Presidenti Trajkovski i kërkuar të anulonte firmën) Arbëri i kishte seriozisht dhënien e dorëheqjes nga posti i kryetarit të PDSH. Disa herë kishim folur në telefon për këtë çështje dhe ishte shumë i vendosur. Këtë vendosmëri të Xhaferrit e kuptoi më mirë dhe me shpejt Solana. (Ka qenë ditë e premte kur Arbëri me njoftoi në telefon se me anë të një telefonate, Solana i kishte kërkuar ta shtynte dorëheqjen deri ditën e hënë, kur ai (Solana) do të mbërrinte në Shkup).

Marrëveshja e Prizrenit është një deklaratë për paqe dhe bashkëjetesë ndëretnike
Në datën 25 maj, Arbër Xhaferri në një intervistë në Dojçe Velle u shpreh se në thelb, Marrëveshja e Prizrenit ishte një deklaratë paqeje. Ja teksti i intervistës:

Z.Xhaferi, ju keni zhvilluar një takim me presidentin maqedonas Trajkovski, pas këmbimit të disa replikave të ashpra në media. A mund t'i thoni DË-se se përse u bisedua në takimin me Trajkovskin?

Para se të takohesha me të, unë kisha një takim me kryeministrin bullgar Ivan Kostov, kurse pastaj me kërkesë të Zotit Trajkovski unë zhvillova një bisedë të gjatë edhe me të. Natyrisht që temë bisede ishte situata më e re dhe deklarata që kemi nënshkruar me përfaqësuesin e UÇK-së, Z.Ali Ahmetin. Unë edhe në këto dy takime u përpoqa që të shpjegoj se kjo është një deklaratë e fuqishme për paqe, një aleancë po aq e fuqishme mes

njerëzve që parapëlqejnë paqen. Interpretimet që kjo është shpallje e luftës janë interpretime që në vete ngërthejnë një mesazh për luftë. Në këtë deklaratë në esencë janë përfshirë të gjitha çështjet që janë esenciale në Maqedoni dhe zbardhet fryma e mesazhit të paqes. Ne, natyrisht që nuk do të heqim dorë nga kjo deklaratë sepse nëpërmjet te saj arrijmë një mundësi që të vendoset paqa përfundimtare në Maqedoni. Refuzimi i pranimit të këtij interpretimi në esencë ngërthen opsione të tjera që janë luftarake.

Z.Xhaferi si e shpjegoni faktin që komuniteti ndërkombëtar ju drejtoi kritika për firmosjen e marrëveshjes së Prizrenit?

Nuk jemi kritikuar ashtu siç u shfaq në opinionin maqedonas. Kemi pasur bisedime lidhur me legalizimin e UÇK-së pra dhe të vetë Z. Ali Ahmeti. Mirëpo në mes është një keqkuptim i thëllë. Paqa nuk ka nevojë të arrihet mes meje, Z. Ymeri apo Z. Trajkovski, pasi që ne nuk jemi palë ndërluftuese. Faktori kryesor i paqes është Z. Ali Ahmeti. Nënshkrimi i tij i dhënë në këtë deklaratë është një përcaktim i fuqishëm për paqe dhe refuzimi i pranimit të nënshkrimit të tij nga pala maqedonase është apel për vazhdimin e luftës.

Xhaferi a jeni optimist lidhur me zhvillimin e mëtejëm të ngjarjeve në Maqedoni?

Nuk jam gjithaq optimist se këtu kemi të bëjmë me shumë çështje. Ka marrezi, ka infantilizëm, ka dëshira sekrete për vazhdim të luftës dhe për koklavitje të përgjithshme të gjërave në Ballkan. Ne si shqiptarë jemi të pafuqishëm që t'i shërojmë të gjitha këto plagë që u hapën për shkaqe të ndryshme. Por, për një gjë jam i sigurt: Të gjithë ne që nënshkruma këtë deklaratë do të vazhdojmë të ndërtojmë paqen në Maqedoni, por edhe të avancojmë pozitën e shqiptarëve në sistem. Sepse kosideroj që e para varet nga e dyta. OSBE ndryshon qëndrim ndaj Marreveshjes se Prizrenit

31 maj 2001

Presidenti i Asamblesë Parlamentare të OSBE-së, Adrian Severin shprehet se duhet gjetur një zgjidhje për t'iu krijuar mundësinë kryengritësve shqiptarë në Maqedoni të kalojnë nga lufta e armatosur në alternativën civile. Severin foli dje për gjendjen në Ballkan edhe para Komisionit të Punëve të Jashtme të Parlamentit Evropian në Bruksel. Ai theksoi se zhvillimet e fundit në Ballkan, sidomos ato në Maqedoni ishin në qendër të bisedimeve që ai zhvilloi në këtë institucion të BE-së.

Ai foli për rëndësinë e zgjedhjeve të ardhshme në Kosovë, për problematiken e marrëdhënieve ndërmjet Malit të Zi dhe Serbisë, si dhe për rolin e OSBE-së në vëzhgimin e zgjedhjeve të ardhshme në vendet ballkanike. Pjesën kryesor të fjalës së tij, Severin ia kushtoi krizës në Maqedoni. Kryetari i Asamblesë Parlamentare të OSBE-së nuk deshi të komentonte deklaratat e ambasadorit amerikan të OSBE-së, Frovik, por megjithatë pohoi se kryengritësit shqiptarë duhet të kalojnë nga lufta e armatosur në alternativën civile. Ai theksoi para Komisionit të Jashtëm të Parlamentit Evropian në Bruksel se zgjidhja e krizës maqedonase duhet të gjendet me anë të bisedimeve e jo me anë të konfliktit.

NATO dhe BE i kërkojnë Maqedonisë të plotësojë të drejtat e shqiptarëve

31 Maj 2001

NATO-ja dhe ministrat e jashtëm të Bashkimit Evropian kanë bërë të qartë në takimin e Budapestit se qeveria maqedonase duhet të plotësojë tashmë premtimet që i ka bërë shqiptarëve për realizimin e të drejtave të tyre legjitime në këtë vend. Marrëveshja e ndërmjetësuar nga Javier Solana refuzon një dokument të nënshkruar nga të dy partitë kryesore shqiptare me udhëheqjen e kryengritësve shqiptarë të UÇK-s. Por, z. Solana thekson se ndoshta duhet të vazhdonte që qeveria maqedonase të ekzistonte si parakusht për paqe akoma kishte shumë punë për të bërë. Situata nuk do të jetë e lehtë. Është humbur kohë në këto ditët e fundit, por mendoj se do të rimburesohet koha e humbur. Mendoj se po ecim në një drejtim më të mirë, duke filluar nga ky moment. Nuk dua të them se problemi është zgjidhur sepse ai nuk është zgjidhur ende, - citohet të ketë thënë z. Solana. Ai i bëri këto komente në një takim të papritur që përfshinte si NATO-n ashtu edhe ministrat e BE-së për të dëshmuar se sa afër këta dy orgnizma ndërkombëtarë janë për këtë çështje dhe këta organizma do të ushtrojnë presion mbi qeverinë e Maqedonisë për të realizuar çfarë është premtuar për reformat në këtë vend.

Arbër Xhaferri shprehet se nuk ka paqe pa biseduar me përfaqësuesit e UÇK-së

31 maj 2001

Arbër Xhaferri, kryetar i Partisë Demokratike Shqiptare të Maqedonisë anëtare e koalicionit qeveritar ka deklaruar se kriza në vend nuk mund të zgjidhet pa bisedime me kryengritësit e UÇK-së, citon agjencia Asoshieted Press. «Paqja në Maqedoni nuk varet vetëm nga ne, por gjithashtu edhe nga UÇK-ja», ka thënë Xhaferri për të shtuar se duhet krijuar një kanal komunikimi me ta.

Meta: Amnisti për luftëtarët e UÇK-së

Problemi i amnistisë së UÇK-së ka qenë një ndër temat e biseduara më shumë me ish-kryeministrin

Meta. Këmbëngulja ka qenë që ai si kryeministër i Shqipërisë në kontaktet me bashkësinë ndërkombëtare duhet të prezantonte faktin se Maqedonia e vetëquajtur pluraliste nuk ishte plotësisht e tillë përballë shqiptarëve. Ajo nuk kishte bërë amnisti ndaj Ali Ahmetit, Bardhyl Mahmutit, Musa Demirit, Musa Xhaferrit etj të dënuar me ligjet e ish-Jugosllavisë.

Çfarë do të bëhej me luftëtarët e UÇK

I paraqita në fund të muajit prill ish-kryeministrit Meta qëndrimin si më poshtë :

Maqedonia duhet që fillimisht të bëjë një amnisti të trefishtë. Me termin e trefishtë kisha parasysh që :

1- Qeveria e Maqedonisë duhet të bënte amnisti për Ali Ahmetin dhe shokët e tij që ishin të dënuar nga ligjet e Jugosllavisë së Titos. (Në fakt ndodhi e kundërta. Deri në fund të qershorit 2001, qeveria e Maqedonisë dërgonte fletëarresti ndërkombëtar ndaj Ahmetit dhe ankohej përse Zvicra ishte më liberale se Gjermania ??)

2- Maqedonia duhet të bënte amnisti për luftëtarët e UÇK-së që kishin luftuar në Kosovë gjatë viteve 98-99. Për shkak të sigurimit të mbështetjes ndërkombëtare, Krahu politik i UÇK-së nuk lejoi të hapte front luftimesh në Maqedoni, sa kohë që zhvilloheshin luftime në Kosovë. Për këtë shkak me qindra luftëtarë të UÇK-së në Kosovë ishin nga Maqedonia. Lexuesit i mjaftojnë dy syresh : Trimi legjendar, Ismet Jashari i quajtur Komandant Kumanova që u vra si trimat në Kosovë ishte nga Maqedonia. I tillë ishte edhe Gëzim Ostreni nga Dibra e Madhe që arriti deri në zëvendëskomandant i TMK. Pas luftës së Kosovës, kjo shtresë disa mijëshe, u end rrugëve pa asnjë mbështetje, sepse qeveria e Maqedonisë i dënonte me ligjet e saj. Dhe kjo shtresë kishte nevojë për amnisti. -Dhe e treta : Ishte shtresa e shqiptarëve të Maqedonisë, të cilët pas fillimit të luftimeve, veçanërisht pas muajit mars 2001 u rreshtuan në radhët e UÇK-së. Edhe kjo shtresë kishte nevojë për amnisti. Këto ishin arsytet që amnistia duhet të ishte e trefishtë.

Ilir Meta u bind për një gjë të tillë. Por ai kërkonte me çdo kusht një mbështetje ndërkombëtare që ta pozonte këtë problem. Ishte një hezitim i kuptueshëm. Dhe e gjeti atë. Meta e ngriti domosdoshmërinë e amnistisë së trefishtë ndaj shqiptarëve në takimin me lordin Robertson, ish- sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s.

Takimi me Robertsonin dhe kërkesa zyrtare e amnistisë për UÇK-në

Për amnistinë e UÇK-së, është diskutuar në takimin e datës 16 maj 2001 midis Metës me ish-sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s, Xhorxh Robertson. Meta propozoi një amnisti për luftëtarët shqiptarë të UÇK-së, ndërkohë që u bëri thirrje këtyre të fundit që të dorëzojnë armët dhe të lirojnë pengjet. “Problemet zgjidhen me dialog dhe jo me armë”, - tha në fund të takimit me Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s, lordin Robertson. Sipas asaj që u transmetua të nesërmen nga agjensitë e lajmeve, Meta është shprehur optimist për tejkalimin e krizës pas krijimit të qeverisë së re në Maqedoni, duke përsëritur këtë qeveri si dhe pjesëmarrjen aty të dy partive të shqiptarëve. Por ishte shumë e vështirë për t’u bindur Robertsoni. Ai nuk pranonte apriori në fillim që një shtet pluralist të mos kishte bërë amnisti për ish- të dënuarit politikë. Do të duhej që ai, pas ekspozesë së Metës, të merrte konfirmimin nga Brukseli që pastaj të binte dakord me Metën për nevojën e amnistisë. Intervista e mëposhtme e bën shumë të qartë se sa të panjohur me realitetin e Maqedonisë ishin NATO-ja dhe BE-ja. Ja intervista:

Robertson: Nesër do të shkoj në Tiranë

Cilat janë angazhimet e NATO-s për ta ndihmuar Maqedoninë në tejkalimin e krizës në të cilën gjendet?

Robertson: Dëshiroj të theksoj se një kohë shumë e madhe e jona është harxhuar për situatën e shtetit tuaj. Unë dy herë brenda disa javëve kam qenë në Shkup së bashku me Solanën, po ashtu kam qenë edhe dy herë më parë dhe ne ndjehemi të fortë për sigurinë dhe mbrojtjen e shtetit tuaj. Unë jam përcaktuar që të siguroj se janë të shkatërruara institucionet e saj demokratike nga ana e atyre që përdorin dhunën në vend të rrugëve demokratike. Unë kam biseduar me Solanën dhe nga prapavija kemi ndihmuar formimin e “koalicionit të madh”, ne ishim aty thjesht për të lehtësuar gjërat dhe për të ndihmuar, e jo për të diktuar apo për të detyruar politikanët. Atë që bëmë ne ishte ajo që bashkësia ndërkombëtare kishte bërë për Maqedoninë, dhe ndoshta të përkujtohen njerëzit se sa shteti i tyre është duke iu afruar humnerës, me vrasjen e trupave në veri të shtetit, të cilat ishin të përcjellura me sulmet etnike mbi shitoret e tregtarëve shqiptarë, e këto me më shumë vrasje të tjera, që filloi të duket se e tërë Maqedonia do të hyjë në, siç mund të them, veprimet tradicionale ballkanike që udhëheqin në tmerret e vrasjeve dhe shkatërrimeve, të cilat i kemi parë edhe në pjesët tjera të këtij rajoni. Pra, unë kam qenë në Shkup për disa raste të ndryshme dhe ju sigurisht më njihni mirë, pra nuk më njihni vetëm nga ekranet televizive, por më keni takuar edhe personalisht. Unë ndiej një simpati ndaj shtetit tuaj dhe për atë se çka ka bërë shteti juaj për NATO-n dhe sigurinë më të

gjerë të Ballkanit. Pra, duke u bazuar në gjithë këtë unë përpiqem të bashkoj shtetin kundër forcave që janë duke e shkatërruar demokracinë. Unë jam i sigurt se jemi duke lëvizur para me ndihmën e NATO-s dhe Unionit Evropian që të sigurohemi se Maqedonia do ta zërë vendin e saj në mesin e familjes së shteteve demokratike, ku edhe meriton të jetë.

Në fillim të krizës në Maqedoni ju patët deklaruar se nuk jeni për ndarjen e Maqedonisë, apo federalizimin e saj. A i keni qëndrimet e njëjta edhe tani?

Robertson: Unë nuk e kam ndryshuar qëndrimin tim, por struktura e shtetit, Kushtetuta e shtetit dhe politika e qeverisë në shtet është çështje e popullit të vetë shtetit dhe jo për organizatat e jashtme. Ne mund të ofrojmë këshilla, por nuk kemi përgjegjësi për vendimet që janë marrë. Por, atë që mund ta bëjmë, atë që unë e bëj është e njëjta se shteti duhet të bashkohet, ankesat e të gjitha komuniteteve duhet të shqyrtohen, nuk duhet

të lejohet ato të acarohen, dhe se, "koalicioni i gjerë" që tash u miratua duhet të jetë i fortë dhe optimist. Rruga e vetme nëpërmjet së cilës Maqedonia do të mbijetojë si shtet është që qytetarët e saj të jenë të bashkuar. Unë kuptoj se realitetet e tmerrshme të Ballkanit mund po ashtu të marrin hov, por, vendimet se çfarë qeverie dëshirojmë të kemi dhe çfarë strukture duhet ajo të ketë është çështje e popullit të vet.

Populli maqedonas dëshiron të besojë se KFOR-i është duke siguruar kufirin Kosovë-Maqedoni. A mund të na tregoni konkretisht se cilat janë masat që ndërmerren në këtë drejtim?

Robertson: Një gjë e tillë është duke ndodhur. Trupa plotësues janë duke e siguruar kufirin. Tani kemi një sigurim më agresiv të kufirit. Ne jemi duke dërguar pajisje plotësuese teknike në këtë rajon që do të na mundësojnë një vëzhgim më të mirë të aktiviteteve që ndodhin në këtë kufi. Por, natyrisht, ka kufizime, të cilat medoemos ekzistojnë, madje edhe VG dhe teknikat të cilat nuk do të ishin të pranuar, dhe NATO nuk arriti sukses ta mbyllë plotësisht kufirin me Kosovën, për shkak se Kosova ka vende malore, pyje dhe për këtë shkak është një ndër kufijtë më të vështirë në botë për t'u kontrolluar. Është shumë rëndë madje edhe për njerëzit lokalë të këtij rajoni të dinë se ku është kufiri. Pra, mendoj se nuk duhet të ushqejmë fantazinë tonë se mund të krijosh një kufi të pakalueshëm në këtë vend, por ne energjikisht jemi duke e patrulluar kufirin, njerëzit janë duke u kontrolluar, ata që zihen me armë arrestohen, dhe kështu do të vazhdojmë të veprojmë. Kjo është një nga obligimet tona dhe ne këtë obligim e marrim shumë me seriozitet.

Komuniteti ndërkombëtar kërkon që pala maqedonase të jetë e kujdesshme në përdorimin e forcës?

Robertson: Unë bëj thirrje për përmbajtje, për shkak se përmbajtja është një teknikë e mençur ushtarake. Ndonjëherë një reagim i tepruar mund të japë si rezultat të kundërtën e asaj që ti e ke dëshiruar. Por, e di se këta njerëz kanë qenë provokues. Të hënën e kaluar, shumë qartë kam theksuar se këta njerëz janë kriminelë, ata janë duke i vrarë njerëzit që thjesht janë duke i shërbyer shtetit. Ata nuk kanë merituar mbështetje dhe, nëse njerëzit janë duke u dhënë mbështetje, atëherë ata duhet të ndalen dhe të mos vazhdojnë t'i mbështesin ata. Nëse sulmet vazhdojnë, atëherë ata thjesht e theksojnë faktin se kërkojnë të sjellin dhunë dhe çrregullim në shtetin që duhet të mbahet së bashku. E kjo nuk është demokraci dhe ka qenë shembull për Ballkanin vite me radhë. Por, duhet të kemi një përgjigje të përmbajtur ushtarake ndaj sulmeve ushtarake, mirëpo këto duhet të jenë të shoqëruara me një proces të reformave politike, që do të thotë se shoqëria maqedonase do

t'i përfshijë të gjithë popujt e ndryshëm që e përbëjnë shtetin. Pa përpjekje politike, aksionet ushtarake nuk do të mund të kenë sukses.

Problem për aksionet luftarake të forcave të sigurimit të Maqedonisë paraqet edhe popullata civile, e cila nuk pranon t'i braktisë shtëpitë e veta. Si të reagohet në këtë rast?

Robertson: Natyrisht se është problem dhe çdo herë kjo do të jetë problem. Njerëzit nuk dëshirojnë t'i braktisin shtëpitë e veta, të cilat mund të jenë të plaçkitura apo të shkatëruara, dhe prandaj preferojnë të qëndrojnë në shtëpitë e tyre, por megjithatë shpresoj se tani ata do të dëgjojnë qeverinë e tyre, meqë tani kjo qeveri flet me zërin e 90

për qind të popullatës në Maqedoni. Por kjo është një situatë e komplikuar. Disa njerëz thonë se dëshirojnë të qëndrojnë, e disa të tjerë ndjehen se janë të detyruar të qëndrojnë. Por, ajo që është kryesore është që njerëzit të distancojnë veten nga ata që e kanë importuar dhunën në Maqedoni, dhe të mbështesin politikanët, të cilët tash janë duke e mbështetur "koalicionin e gjerë". Ky është momenti që njerëzit e shtetit të qëndrojnë me qeverinë e tërë shtetit.

Për shkak se shumica e luftëtarëve të UÇK-së janë banorë të Maqedonisë, e mendoni se qeveria e re duhet të propozojë amnistimin e të gjithë luftëtarëve të UÇK-së, e pastaj ata t'i inkuadrojë në shoqëri, me qëllim që ata të motivohen për t'i lënë armët dhe për t'i dhënë përparësi dialogut për zgjidhjen e kërkesave të shqiptarëve në Maqedoni?

Robertson: Ata duhet të kërkojnë prej tyre t'i ulin armët, të çarmatosen dhe disa prej tyre të largohen. Kjo është çështje për qeverinë e Maqedonisë. Natyrisht, disa prej tyre janë vendas, e papranueshme është kur kanë veshur uniformën dhe kanë përdorur armët kundër qeverisë së shtetit të tyre amë. Pra, hapi i parë është që ata të ulin armët poshtë, të hedhin poshtë uniformën, dhe të vazhdojnë me ndërtimin e demokracisë multietnike që është realiteti i Maqedonisë.

Në një situatë të këtillë, si do të arrihej largimi i këtyre ekstremistëve apo grupeve të armatosura nga Maqedonia?

Robertson: Ne i thërrasim njësitë e armatosura shqiptare, ndërsa unë e thërras të ashtuquajturën UÇK, për të cilën mendoj se nuk mund të jetë Ushtri Çlirimtare Kombëtare në një shtet ku ka demokraci. Kemi kundërshtim të termave, por, se do të ketë lidhje në mes tyre kjo është e qartë. Por, nëse jemi të qartë dhe jemi të bindur për demokraci dhe institucione demokratike dhe se nuk do të jemi të shtyrë nga ata që preferojnë dhunën, atëherë kjo do të nxjerrë në shesh një mesazh të qartë. Unë nesër do të shkoj në Tiranë me disa ambasadorë-ministra të Evropës Perëndimore, ku do të jap një mesazh se njerëzit në Shqipëri duhet po ashtu të përdorin ndikimin e tyre që kanë, për t'i ndaluar njerëzit të përdorin plumbat në vend të fjalëve. Për shkak se sa më shumë ndodh kjo, Maqedonia aq më tepër hyn në humnerë, e kjo do të ketë ndikim edhe në Shqipëri dhe aq më tepër bota thjesht fillon të ndjehet e lodhur duke mbështetur ata që mbështesin dhunën për të ecur para.

Këto ditë në selinë e NATO-s do të arrijë një delegacion i Qeverisë së re të Maqedonisë. Cili është qëllimi i kësaj vizite?

Robertson: Qeveritarët maqedonas do të vijnë tek unë të premtën si pjesë e aksionit të anëtarësimit, proces që shpie eventualisht në anëtarësim, dhe kjo është një nga arsytet kryesore të kësaj vizite. E dyta është anëtarësimi në Unionin Evropian. Maqedonia është shteti i parë ballkanik, të cilit i është mundësuar nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje, pra shteti i parë në Ballkan që ka arritur këtë. Para së gjithash njerëzit duhet të shikojnë përpara drejt ardhmërisë. Shihni Kroacinë apo Slloveninë, këto janë dy shtete që kanë lënë prapa të kaluarën, nacionalizmin, ato janë shndërruar në shoqëri gjithëpërfshirëse dhe shoqëri demokratike dhe vetëm shikoni shkallën e prosperitetit të tyre si dhe rrugën e zhvillimit të ekonomisë së tyre. Nëse e shihni Slloveninë ajo është e pakrahueshme me ditët kur ajo ishte pjesë e Jugosllavisë. Pra, mendoj se koalicioni i gjerë është një fenomen i mrekullueshëm. Ajo më parë ishte e bllokuar në vete. Me elementet sllavë në shoqëri dhe elementët shqiptarë në shoqëri, gjithë të bashkuar në qeverinë e një shteti, mendoj se njerëzit duhet të jenë optimistë për atë se çka duhet të thotë kjo. Nuk është kjo vetëm një akt i sjelljes së gjithë politikanëve në tryezën e njëjtë, por për ecje përpara duhet t'i veçohet kujdes prosperitetit të shtetit. Keni dëgjuar në Bruksel se ky është një shtet multietnik me shumë mosmarrëveshje të mëdha dhe tensione në të, por, po ashtu është shumë prosperues, për shkak se i del në krye tërë kësaj, i dalin në krye ashtu që të gjithë njerëzit të ndjehen se janë pjesë e shtetit të tyre. Nëse ec nëpër Bruksel dhe sheh Belgjikën, do të shohësh njërin nga shtetet më të suksesshëm në Evropë, dhe Maqedonia mund të jetë ashtu. Ky është synimi themelor i demokracisë multietnike, ajo se çka dëshirojnë njerëzit për interesa të përbashkëta, madje edhe nëse janë të komuniteteve të ndryshme dhe kanë dallime tradicionale. Kjo është e mundur dhe, nëse ata janë mjaft optimistë ata kanë bazë për ta arritur këtë. Dhe unë me të vërtetë i përgëzoj ata që u bashkuan, duke i eliminuar të gjitha rivalitetet politike, dhe duke thënë se, nëse nuk

ndalemi, do të shkojmë drejt një katastrofe botërore, dhe ne nuk do ta bëjmë këtë. Pra, mesazhi optimist ekziston, ka pengesa të ndryshme, por vetëm duhet të hidhet një shikim në Bosnjë dhe Kosovë që të vëresh se çka të pret, por po ashtu njerëzit duhet të shikojnë edhe shtetet tjera, për shembull edhe shteti im është multietnik. Skotlandezët dhe anglezët vite me radhë kanë përjetuar luftëra të përgjakshme, e tani janë pjesë e një shteti. Po ashtu edhe Belgjika është një shembull, mirëpo ka edhe shembuj tjerë. Pra, shpresoj se Maqedonia do të jetë edhe një shembull ku njerëzit do ta gjejnë ardhmërinë.

Jehona e kërkesës së Metës në Maqedoni

Kërkesa për amnisti të luftëtarëve të UÇK-së nga ana e kryeministrit të Shqipërisë në prani të Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, pati jehonë të madhe në Maqedoni.

Qëndrimi i partive politike shqiptare në qeverinë e koalicionit të gjerë ishte për një amnistim të përgjithshëm të luftëtarëve shqiptarë, ndërsa partitë politike maqedonase u shprehën për një amnisti parciale.

PDSH: "Parimisht ne i mbështesim propozimet e këtilla si nga ana e kryeministrit shqiptar, Ilir Meta, por edhe nga liderët tjerë partiakë, u shpreh nënkryetari i PDSH-së, Iljaz Halimi. Ai bëri të ditur se amnistimi si një nga metodat për dalje nga kriza, është theksuar edhe në non paper-in e PDSH-së. Në këtë dokument kërkohet një amnistim i përgjithshëm, jo vetëm i luftëtarëve të UÇK-së, por edhe i të tjerëve, të cilët për çështje ideore kanë pësuar nga sistemi i mëparshëm 50 - vjeçar,- tha Halimi, duke shtuar se nuk mjafton vetëm amnistimi i tyre për qetësimin e situatës, sepse sipas tij, ky është vetëm një segment i asaj që kërkohet. Ai tha se për qetësimin e situatës duhet që sa më shpejt të plotësohen edhe kërkesat e shqiptarëve, të cilat, siç theksoi Halimi, mund të zgjidhen vetëm nëpërmjet institucioneve të sistemit, dialogut dhe negociatave të cilat duhet t'i zhvillojnë partitë politike. "Duhet që urgjentisht të bisedohet për ndryshimin e Kushtetutës, e cila është konstatuar se është gjenerator kryesor i krizës politike në Maqedoni",- theksoi Halimi.

Halimi: Edhe në Planin Frouik flitet për amnisti të UÇK-së

Ai bëri të ditur se çështja e amnistimit është theksuar edhe në planin e hartuar nga i dërguari i OSBE-së në Maqedoni, Robert Frovik, të cilin ai ua ka dorëzuar kompetentëve këtu në Maqedoni, si një udhërrëfim për tejkalimin e situatës. "Puna e Qeverisë është që edhe këtë çështje ta trajtojë, të marrë qëndrime serioze dhe në bashkëpunim me faktorin e jashtëm të krijojë mekanizma, që nëse arrihet deri te ndërprerja e luftimeve, të parashihet edhe amnistimi",- shtoi Halimi.

PPD : Nënkryetari i PPD-së, Aziz Pollozhani, bëri të ditur se pas zgjidhjes së çështjeve të hapura, amnistimi i shqiptarëve që morën pjesë në luftë kundër forcave qeveritare, ka qenë një kërkesë të cilën PPD-ja e ka shtruar si parakusht për hyrje në Qeveri. "Ne jemi këmbëngulës për risocializimin dhe integrimin në shoqëri të djemve që u detyruan të marrin armët",- shton Pollozhani. Sipas tij, zgjidhja e konfliktit, edhe nga aspekti teorik, gjithmonë bëhet edhe me amnistimin e personave, që për realizimin e idealeve të tyre kanë ndjekur një rrugë tjetër nga ajo institucionale. Pollozhani, duke shprehur mendimin e tij, tha se fillimi i mendimit nga të gjitha strukturat relevante politike për një hap drejt amnistimit, do të kontribuonte shumë në tejkalimin e krizës në Maqedoni."Kjo çështje, në mënyrë implicite është e përfshirë tanimë edhe në axhendën e bisedimeve, por që të vendoset kjo pikë në mënyrë eksplicite është kërkuar dhe ende kërkohet nga ana jonë. Mendoj se kjo është një çështje politike, shoqërore, por pse jo edhe humanitare, e cila nuk mund të mos gjejë mbështetje edhe te faktori ndërkombëtar",- tha ai.

LSDM e Cervenkovskit : Sekretari i përgjithshëm i LSDM-së, Gjorgji Spasov, njoftoi se kjo çështje nuk është shqyrtuar deri më tash në nivel partiak, mirëpo ai ishte i mendimit se në thelb nuk duhen të amnistohen njerëz kundër të cilëve nuk është ngritur aktakuzë dhe nuk janë gjykuar me një procedurë të rregullt. "Amnistimi është akt i cili mund të bëhet vetëm mbi persona, të cilët tanimë janë akuzuar. Marrja e një hapi të këtillë mund të jetë vetëm akt i një vullneti politik, ku nënkuptohet vetëm të mos ngrihen aktakuza që kanë të bëjnë me grupime për vepra armiqësore, në realitet grupime për rrëzimin e sistemit me mjete të dhunës. Mendoj se në kuadër të situatave të këtilla të krijuara në disa shtete është e mundur që të ngrihen aktakuza dhe të gjykohen vetëm ata persona për të cilët do të mund të dëshmohej se kanë marrë pjesë në mënyrë direkte në organizimin e

aksioneve terroriste",- tha Spasov. "Edhe pse kjo çështje nuk është e pranishme në axhendën e bisedimeve të kryetarit Trajkovski, ajo vetvetiu do të duhet të futet në axhendë për realizimin e procesit të pacifikimit të përgjithshëm,- deklaroi Spasov. Zëdhënësi i VMRO-DPMNE-së, Igor Gievski: "Mund të ketë amnistim vetëm për ata persona, të cilët kanë qëlluar në vendbanime në rajonet e krizës dhe janë rekrutuar me dhunë nga terroristët. Ata të cilët vullnetarisht kanë marrë armë në dorë që të zgjidhin disa probleme, aksionet e të cilëve kanë qenë të drejtuara kundër forcave të sigurimit të Republikës së Maqedonisë, patjetër duhet të përgjigjen para ligjeve të këtij shteti. Ai bëri të ditur se për këtë nuk do të bisedohet, siç tha ai me terroristët, kurse dorëzimi i armëve sipas tij do të merret parasysh gjatë gjykimit të tyre. Nëse nuk e bëjnë këtë, ose do të dëbohen nga Maqedonia ose do të shkatërrohen tërësisht.

Ndarja që qëndron tek Porta

Përse nuk u nda Maqedonia në vitin 2001

Pas vitit 2005 politikane te ndryshëm shqiptarë si Arber Xhaferri, Ali Ahmeti etj kanë rihapur tezën mbi ndarjen e Maqedonisë në vitin 2001 gjatë kohës që zhvillohej kryengritja shqiptare. Para se të jap gjykimin tim mbi kohën dhe kontekstin kur u hap për herë të parë realisht dhe pastaj zyrtarisht kjo tezë, para se të them përse nuk u nda Maqedonia në vitin 2001, duhet te rikujtojmë se çfarë kanë thënë në mënyrë sintetike, Arbër Xhaferri dhe Ali Ahmeti

Arbër Xhaferri

Arbër Xhaferri në intervistën e tij dhënë TVALSAT shprehet se: «Luftërat zakonisht nisin për territore. Në vënd që zoti Ahmeti të hapte temën e ndarjes së Maqedonisë meqë hyri në luftë, ai kërkon të fajësojë Gjeorgjevskin që paska dashur ai ta ndajë Maqedoninë, dhe se UCK-ja bashkë me armatën maqedonase luftuan mes veti për të ruajtur integritetin territorial të Maqedonisë. Këto janë absurde që nuk i duron as politika. Mendoj se ky prononcim i zotit Ahmeti është në funksion të ndërtimit të imazhit të tij pozitiv, imazhit të një një politikani të moderuar. Ne kemi filluar keto biseda me zotin Gjeorgjevski, kur pritej se do të hapeshin konflikte të tilla. Në vënd të shkatërrimit, të vrasjes së njerëzve ne donim që të parandalonim në mënyrë të civilizuar një tragjedi që do të merrte shumë energji të popullit shqiptar dhe atij maqedonas dhe të faktorit ndërkombëtar".

A kishte një plan konkret në 2001-in për të ndarë Maqedoninë?

Ideja për ndarje kishte edhe dimensionin e alarmit, domethënë ose mbushni mëndjen ose do përfundojmë me ndarje. Dihen territoret ku shqiptarët janë shumicë, territoret ku kanë pasur histori me qindra vjet, kështu që aty nuk mund të kete dilema. Por çështja është ose do ta korrigjojmë konceptin e shtetit që të jete ne shërbim të të gjitha bashkësive etnike ose do të hapim keto tema.»

Ali Ahmeti

Cila ka qënë oferta e Kryeministrit Gjeorgjevski ne 2001-in për të ndarë Maqedoninë në kohën e luftës kur ju ishit drejtues i UCK-së?

«Unë kam pasur ofertë në 2001-in për të ndarë Maqedoninë. Dokumentacioni i kësaj ofertë ka qënë publik dhe është pasqyruar në televizionin shtetëror të kohës. Ai që propozoi në atë kohë ndarjen e Maqedonisë ka qënë kryetari i Akademise së Shkencave. Mua m'u ofrua që pjesa e Likovës, atje ku ne edhe kishim vijat e frontit gjatë kohës së luftës, do i takonte Kosovës. Tetova dhe Gostivari ishte llogaritur t'i kalonin Shqipërisë. Por unë nuk hyra në gracka të tilla.

Ndërsa kompromisi i fshehtë që nuk doli në sipërfaqe ishte që Zajasi, fshati im i lindjes, t'i kalonte Shqipërisë. Dhe kjo ishte pjesë e kompromisit që ata kishin menduar. Mirëpo unë nuk dola në luftë për Zajasin, as shokët e mi në Tetovë nuk dolën për Tetovën dhe kështu me rradhë. Ne dolëm në luftë për çështjen e pazgjidhur kombëtare në Maqedoni dhe që të gëzojmë të drejtat tona që na takojnë brënda këtij vëndi.

Kështu që, të ishte për ta ndarë Maqedoninë, do të ishim pikërisht ne, Ushtria Clirimtare Kombëtare që në vitin 2001 do të prananim ofertën dhe do të vendosnim litarët për të ndarë Maqedoninë. Mirëpo ndarjet kanë dhimbje".

Ne këtë propozim që juve ju u bë në 2001 nga Kryeministri i asaj kohe Gjeorgjevski, për ndarjen e Maqedonisë, a kishte një hartë të vizatuar se si do të bëhej kjo ndarje?

Harta ka qënë në televizionin shtetëror të asaj kohe dhe ka qënë e vizatuar se si do të bëhej

ndarja. Jo i gjithë rrethi i Tetovës dhe i Gostivarit ishte i përfshirë në Shqipëri. Por ajo ka qënë një hartë sa për të hapur debat. Ata kishin menduar edhe kompromis Zajasin dhe Likoven. Por keto kane qene qellime te erreta, shoviniste dhe ekspansioniste. Ne nuk rame ne nje provokacion te tille. Mbrojtem deri ne fund qellimin per te cilin dolem ne lufte dhe jemi te perkushtuar per kete qellim, qe dy popujt te jetojne te lire, te barabarte, pa i rene ne qafe njeri-tjetrit, secili te kultivoje historine dhe vlerat e veta. Po ashtu bashkarisht duhet te cojme perpara proceset dhe te garantojme implementimin e standarteve evropiane, duke pershpejtuar rrugen drejt NATO-s dhe BE-se.»

Cila është e vërteta ?

Jane dy interpretime pas kryengritjes se shqiptareve. Te dyja kane ne qender ndarjen e Maqedonise dhe pozicionet perkatese rreth saj. «Abaz Xhuka-komandanti i UCK» nuk ekziston me dhe ne vend te tij eshte politikani Ali Ahmeti,që është kryetar i BDI. Ndersa vazhdon te ekzistojë politikani Arber Xhaferri i cili edhe ai ka dhene doreheqje nga kryetar i PDSH.

Por cila është e vërteta ? Perse nuk u nda Maqedonia ne vitin 2001? Ishin maqedonet ata qe e hodhen tezen e ndarjes apo edhe shqiptaret kishin ne plan ndarjen e maqedonise. Le te kthehemi ne funddimrin dhe pranveren e vitit 2001.

Tushemisht: atje ku u bisedua për herë të parë për ndarjen e Maqedonisë

Për herë të parë për ndarjen e Maqedonisë është biseduar në Tushemisht në datën 6 prill 2001. Ka qënë dy ditë pas takimit të Arbër Xhaferrit me ish-ministrin e jashtëm anglez Robin Kuk dhe disa ditë pas tërheqjes së UCK nga Kodrat mbi Tetovë. Kjo tërheqje nga pala maqedonase u trajtua si disfata e UCK. Ndërsa nga Xhaferri u trajtua ndryshe. Ja se cili është komenti i agjensive të lajmeve mbi takimin Xhaferri-Kuk : Lideri i Partisë Demokratike të Shqiptarëve, Arben Xhaferi deklaroi se ekstremistët shqiptarë në Maqedoni nuk janë mundur dhe që konfliktet mund të përsëriten, nëse nuk fillon dialogu i frytshëm. «Njerëzit të cilët kanë luftuar kundër forcave maqedonase të sigurisë janë në mesin tonë dhe nuk kanë humbur pa gjurmë», deklaroi Xhaferi në Tetovë, pas takimit me ministrin e Punëve të Jashtme të Britanisë së Madhe, Robin Kuk. Xhaferi tha që nuk e pranon emërtimin «terroristët» për palën shqiptare në konflikt. «Ata kanë qënë të veshur me uniforma ustarake, e kanë pasur linjën e frontit dhe nuk kanë kryer aksione terroriste kundër civilëve», tha Xhaferi. Deklarata e Xhaferit është bërë ne 4 prill 2001.

Dhe dy ditë më pas jam takuar me Arbërin në Tushemisht. (Tushemishti ka qënë vendi ku shumë herë bënim takimet për tu konsultuar lidhur me zhvillimin e ngjarjeve në Maqedoni. Të paktën kështu vazhdoi deri në shtator 2001, deri sa kishte përfunduar Marrëveshja e Ohrit dhe deri sa u hodh ideja e krijimit të Këshillit Koordinues të Partive Politike në Maqedoni).

Gjatë bisedës me Arbërin e cila zgjati më shumë se tre orë, folëm për shumë teza dhe hipoteza për të ardhmen e Maqedonisë dhe të Kosovës. Të dy ishim dakord se UCK-ja nuk kishte pësuar disfata në Tetovë. Ajo ishte në mesin e shqiptarëve të Maqedonisë dhe përsëri do të fillonte luftën.

Papritur Arbëri me tha: -Cili do te ishte mendimi yt nëqoftëse do të të propozonin ndarjen e Maqedonise?

Ishte nje pyetje e beftë, por edhe e patrajtuar në mendjen time deri në atë moment. Kisha pasur vetëm njëherë rastin ta trajtoja këtë çështje, por jo kaq hapur me delegacionin e Partise Demokratike Kombetare te Shqiptareve ne Maqedoni te cilet mbronin tezen e federalizmit te Maqedonise.(Takimi kishte ndodhur pas takimit te Ahmetit dhe Xhaferrit dhe une mbajta nje qendrim distancues ndaj idese se federalizmit te Maqedonise. Në atë takim merrnin pjesë edhe dy deputetë aktualë të BDI, Xhevat Ademi dhe Tahir Hani, askohe, drejtues të PDK)

I ktheva pergjigje duke i thënë: -Do bëjmë diskutim teorik apo ke ndonjë ide konkrete.

(Pyetjen e bëra thjesht rutinore sepse e dija që Arbëri asnjëherë nuk hynte ne diskutime teorike të kota)

Dhe Arbëri mu përgjigj se fjala ishte për ide konkrete të hedhura nga Lupco Georgievski në atë periudhë kryeministër i Maqedonisë dhe PDSH në atë periudhë partnere në koalicionin qeveritar. Ishte Georgievski ai që e kishte propozuar idenë e ndarjes së Maqedonisë në një takim me Arbërin. Folëm gjatë për këtë ide konkrete me Arbërin.

Kemi peshuar avantazhet dhe disavantazhet e idesë së ndarjes. Në fund kemi konkluduar se në momentin kur UCK sapo ishte tërhequr nga Kodrat mbi Tetovë dhe kur këtë tërheqje maqedonasit e trumbetonin si fitore mbi terrorizmin, shqiptarët do të dilnin të humbur po të pranonin idenë e ndarjes së Maqedonisë. Në fund konkludua që për momentin të mos e përhapim si ide sepse ishte në disfavorin tonë.

Me vone ngjarjet rrodhen ndryshe. UCK u rikthye në frontin e luftimeve më me force. Arbëri dhe Imeri firmosën me Aliun Marrëveshjen e Prizrenit, ku një nga pikat e saj ishte pranimi i integritetit të Maqedonisë, ishte larguar Frouik nga Maqedonia, ishte krijuar qeveria e koalicionit të gjërë në Maqedoni, SHBA kishte caktuar Xhejms Pardju të dërguar special në Maqedoni, ndërsa BE kishte caktuar ish-ministrin e mbrojtjes franceze Leotar etj.

«Veçer» boton Planin e ndarjes

Dhe pikërisht në këtë kohë, në datën 30 maj 2001 botohet në gazetën Veçer Planin i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë (ASHAM) për ndarjen e Maqedonisë

Akademia e Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë propozoi ndarjen e Maqedonisë dhe këmbimin e territoreve dhe popullsisë së Maqedonisë dhe Shqipërisë, për t'u gjetur zgjidhja e përhershme e krizës ndëretnike. Në këtë memorandum të ASHAM ishte propozuar shpërngulja me vullnet e shqiptarëve nga rajonet dhe qytetet në Maqedoni për në territorin i cili do t'u lirohej, përkatësisht i cili do t'i bashkohej Shqipërisë. Sipas propozimit Maqedonia do t'ia lëshonte Shqipërisë territorin që prej Tetovë deri në Dibër, me Gostivarin dhe një pjesë të Malit të Sharrit, dhe si kompensim për këtë do të duhej t'i fitonte territoret në rrethinën e Liqenit të Prespës. Ish-kryetari i ASHAM Gjorgji Efremov deklaroi se me këtë ide kanë qenë të informuar edhe disa politikanë maqedonas. Partitë maqedonase dhe shqiptare reagueshan lidhur me këtë propozim, duke e vlerësuar si të papranueshëm deri edhe fashist. Në mbrojtje të planit doli vetëm ish-kryetari i parlamentit të Maqedonisë Stojan Andov.

Ali Ahmeti dhe Arber Xhaferri kanë pjesërisht të drejtë në idetë e tyre lidhur me ndarjen e Maqedonisë. Ata kanë të drejtë kur deklarojnë se ishin shqiptarët, ata që e ruajtën Maqedoninë në vitin 2001. Ky ishte edhe paradoksi i kryengritjes së tyre. Ata ruajtën atë që e konsideronin burimin e të gjithë të këqijave të tyre !! Marrëveshja e Prizrenit e hartuar nga Ahmeti, Xhaferri dhe Imeri dhe e firmosur nga të tre, kishte një nga pikat e saj, ruajtjen e integritetit të Maqedonisë.

Edhe shqiptarët kishin në plan të ndanin Maqedoninë

Deri me sot, është folur më shumë për qëndrimin që mbajtën shqiptarët ndaj tezave të Georgievskit dhe të ASHAM për ndarjen e Maqedonisë. Në këto pozita kanë rënë edhe politikanët shqiptarë në Maqedoni në luftën politike me njeri tjetrin.

Askush prej tyre nuk është marrë me përgjigjen e pyetjes: Po shqiptarët vetë; a kishin ata në plan të ndanin Maqedoninë, a kishin ata në plan të shkëputeshin nga Maqedonia dhe të bashkoheshin me Shqipërinë ose me Kosovën?

Përgjigja është se edhe shqiptarët e kishin në plan ndarjen e Maqedonisë. Edhe ata kishin në plan të bashkoheshin me Shqipërinë. Nuk është fjala vetëm për tekstin e betimit të luftëtarit të UCK, nuk është fjala për programin e PDK së drejtuar nga Haxhirexha që kërkonte federalizmin e Maqedonisë. Me shume se sa kaq. Në gjirin e UCK së drejtuar nga Ahmeti dhe PDSH-së të drejtuar nga Arbër Xhaferri pati rryma të cilët e kishin në plan të realizonin ndarjen e Maqedonisë dhe bashkimin e trojeve shqiptare me Shqipërinë. Por disa nga drejtuesit e tyre u tremben në çastin kur duhet të ishin me të vendosur. Për këtë plan të shqiptarëve kishin dijeni në mënyrë të mjegullt edhe disa shërbime inteligjente. Po jap vetëm një detaj lidhur me këtë çështje:

-Në një nga takimet konsultative të zhvilluar midis shërbimit inteligjent shqiptar dhe atij maqedonas në fund të muajit mars 2001, është diskutuar midis të tjerash edhe për ndarjen e Maqedonisë nga ana e shqiptarëve. Por askush prej tyre nuk ishte në gjendje të gjykonte konkretisht se si do të realizohej ky plan dhe kush ishin drejtuesit kryesorë të tij. Ata asnjëherë nuk i morën vesh emrat e drejtuesve dhe planin konkret të ndarjes.

Planin shqiptar për ndarjen e Maqedonisë ishte menduar të realizohej kur UCK doli në Likovë dhe ishte në pozita të favorshme përballë ushtrisë maqedone dhe faktorit

ndërkombëtar. Ai nuk u realizua pasi disa nga drejtuesit politikë të UCK dhe faktorit politik shqiptar në Maqedoni në momentin e fundit u trëmbën, hezituan dhe u tërhoqën. Por «Litari i ndarjes» ka mbetur jashtë: Mosmarrëveshjet kufitare Kosovë-Maqedoni dhe vecanërisht shkelja e Marrëveshjes së Ohrit përbejne litarin e ndarjes së nesërme të Maqedonisë.

Haraçina dhe fillimi I bisedimeve

Hyrja e trupave të UCK në fshatin Haraçinë përben fillimin e bisedimeve serioze për zgjidhjen e kërkesave të shqiptarëve

Në datën 8 qershor 2001 Njësitë speciale të UCK të drejtuara nga Komandant Hoxha hynë në fshatin me shumice dermuese shqiptare Haraçinë, që ndodhet në periferi të shkupit. Zyrtarisht lajmin e bëri të ditur zëdhënësi i Ministrisë së punëve të brëndshme Stevo Pendarovski që deklaroi se «janë vërejtur në Haraçinë 30 persona me uniforma të UÇK-së. Forcat maqedonase janë në hyrje të fshatit Haraçinë, por jo edhe brenda fshatit. Ndërkaq në datën 9 qershor edhe disa agjensi të huaja njoftuan se Haraçinën e kanë nën kontroll ushtarët e UÇK-së.

Nga Tanusha në Haraçinë

Tanusha ishte fillimi I kryengritjes së shqiptarëve. Haraçina shënoi fillimin serioz të bisedimeve me shqiptarët. Kryengritësit shqiptarë e kryen detyrën e tyre. Politika shqiptare në Maqedoni e mbështetur nga politika shqiptare në Shqipëri dhe Kosovë e kreu përgjysëm detyrën e saj. Ajo e la kryengritjen në gjysëm të rrugës. Kjo politikë përgjatë dhe pas Haraçinës, më shumë mendoi se si të ruante integritetin e Maqedonisë nga shqiptarët, se sa të çonte deri në fund thelbin e kryengritjes së shqiptarëve. Mëdyshja e politikës shqiptare, nuk mund të mos vihej re nga politika maqedonase, e cila pranoi në letër disa të drejta shtesë për shqiptarët, por nuk pranoi asesi, në realitet barazinë e tyre me maqedonasit. Për politikën maqedonase, shqiptarët ishin dhe mbetën «mysafirë». Por mysafirë në shtëpinë e tyre.